

# BLLOKOHET KOMISIONI



Azem Syla jep dorëheqje

Jo vetëm që kurrë nuk është mbledhur, por Komisioni për Verifikimin e Veteranëve, Invalidëve dhe Dëshmorëve të UÇK'së ka mbetur edhe pa kryetar. Deputeti Azem Syla, kreu i këtij organi, thotë se ka dhënë dorëheqje për arsye personale. Për këtë veprim të tij nuk dinë as anëtarët e Komisionit. ■ f8-9



## Nisen për Shkup

Ministria e Infrastrukturës ka hapur procedurat e tenderimit për autostradën e dytë - Prishtinë-Shkup. Këshilltari Lah Nitaj thotë se dhjetëra kompani vendore e ndërkombëtare tashmë veç kanë shprehur interesim. Përzojedhja e kompanisë fituese bëhet brenda këtij viti, kurse ndërtimi nis më 2013. ■ 114-11

# Express

E hënë  
30 korrik 2012

www.gazetaexpress.com

N° 2657 Viti VIII • Kosovë 0.30 € • E përditshme e pavarur kosovare

### Shmangeni Serbinë

Sërish bashkatdhetarët kanë probleme në kufirin me Serbinë. Autoritetet e shtetit serb kanë krijuar radhë të gjata duke mos punuar. Autoritetet kosovare u sugjerojnë mërgimtarëve që të përdorin pikat e tjera kufitare për ardhje ose largim. | FAQE 9

### KOMENT » Delli

Kosova e pavarur i ka vetëm 4 vjet e ca muaj dhe ende ka nevojë për tutori dhe ndërmjetësime si ato të ambasadorit Dell. Shkruan: Shkëlzen Maliqi. | FAQE 2

### OpED Çka ndodhi tash e një vit në Veri të Kosovës?

Po na pret pra një vjeshtë politike në Veri të Kosovës dhe në raportet e Prishtinës dhe Beogradit, ndërsa nuk po shihet që ne jemi të gatshëm për një përbalje të tillë. Shkruan: Blërim Shala | FAQE 3

# TA PRESIM SERBINE

Daniel Serwer thotë se Kryeministri serb, Ivica Dacic ka dhënë disa sinjale të mira në raport me Kosovën, por tani duhet parë veprimet e tij. Megjithatë, normalizimi i raporteve mes dy vendeve, sipas tij, është ende larg. Analisti amerikan në një intervistë për Express pohon se diplomacia kosovare përballë kundërshtarëve po shfaqet e talentuar, edhe pse me resurse të kufizuara. ■ f4-5

FOTO: MALJUNDA HOXHA



Komunikim i plotë për t'ri!



hej!  
Pse po pret?



# Pressing

**Express**

■ Kryeredaktor: **Leonard Kerquki** leonard.kerquki@gazetaexpress.com  
 ■ Politike: **Shpend Limoni** shpend.limoni@gazetaexpress.com ■ Nacionale dhe siguri: **Jeton Musliu** jeton.musliu@gazetaexpress.com  
 ■ Ekonomik: **Arben Hyseni** arben.hyseni@gazetaexpress.com ■ Bota: **Arsim Buxhovi** arsim.buxhovi@gazetaexpress.com  
 ■ Arte: **Faton Raci** faton.raci@gazetaexpress.com ■ Editoriale dhe Shkurt e Shqip: **Arben Idrizi** arben.idrizi@gazetaexpress.com  
 ■ Sport: **Valdet Hasani** valdet.hasani@gazetaexpress.com ■ Fotografia: **Atdhe Mulla** atdhe.mulla@gazetaexpress.com  
 ■ Drejtoresë e marketingut: **Vjollca Musa**, marketing@gazetaexpress.com redaksia: info@gazetaexpress.com tel: 038 76 76 76, fax: 038 76 76 78  
 ■ Drejtor ekzekutiv: **Shpend Jakupi**, shpend.jakupi@gazetaexpress.com Shitypi: Roto Print Center: MediaWorks.

## Fjalët tona

“Dy të tretat e serbëve jetojnë në pjesën jugore të Kosovës dhe janë plotësisht të integruar.”



**HASHIM THAÇI**, Kryeministri i Kosovës, ka reaguar kështu ndaj deklaratave të Presidentit të Serbisë, Tomislav Nikolic, se serbëve në veri iu kanë shtetë gjenocidi nga ana e Prishtinës zyrtare.

“Lirojini pronat shoqërore.”



**AKP**, Agjencia Kosovare e Privatizimit u është drejtuar sërish misioneve të Bashkimit Evropian (EULEX) dhe atij të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) për të liruar pronat shoqërore që kete misionet po i shfrytëzojnë aktualisht. Agjencia konsideron se shfrytëzimi i këtyre pronave nga këto misionet po pengon procesin e privatizimit.

“I kam besuar Dellit, jo Thaçit.”



**ISA MUSTAFA**, Kryetar i LDK-së, i ka bërë këto komente përkitazi me marrëveshjen politike për zgjedhjet e parakohshme mes lidereve të PDK-së, LDK-së dhe AKR-së si dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese për t'ia zgjatur mandatin Presidentes Jahjaga.

**MOTI**
**PRISHTINË**

**Sot**
**Max:** 30 °C

**Min:** 16 °C

**Nesër**
**Max:** 31 °C

**Min:** 17 °C


Shkëlzen

## Maliqi

# Delli



**Kosova e pavarur i ka vetëm 4 vjet e ca muaj, dhe ende ka nevojë për tutori dhe ndërmjetësime si ato të ambasadorit Dell.**

Në pikun e verës polemika që u zhvillua mes Christopher Dellit dhe Veton Surroit, sado e nxehtë, nuk nxori ndonjë doli politike për të qenë.

Për Dellin, i cili po i numëron ditët e fundit të mandatit në Kosovë, praktikisht janë irelevante dhe pa peshë akuzat e Surroit se ambasadori amerikan ka luajtur rol negativ në proceset e zhvilluara pas shpalljes së pavarësisë. Surroi nuk nxori asnjë risi, vetëm i ripërsëriti akuzat që janë dëgjuar më parë. Informatat dhe interpretimet për ambasadorin që dukeshin si pikante, në esencë ishin pohime marginale dhe private se çka dhe si është biseduar në një darkë të gabuar, apo edhe në disa raste tjera kur kanë komunikuar këta dy protagonistë, ku sqarohet se si na qenka prishur “miqësia” mes tyre.

Nga ana tjetër, Surroi u fut në polemikë me kompas të prishur politik, duke huqur edhe adresën edhe kohën e paraqitjes. Në atë darkën e gabuar, që qenka shtruar diku nga fundi i vitit 2010, Surroi ndoshta edhe ka mundur të konsiderohej protagonist, pasi që ambasadori dhe Kryeministri Thaçi, pranuan të bisedojnë mundësinë që Surroi të zgjidhet Kryetar i Kosovës si “kandidat koncesual”. Por, pasi që ky skenar ashiqare tejti i dobët nuk u realizua, madje as si tentativë, ishte vërtet një huqje trashanike e Surroit vendimi që të bëjë publike “kandidimin për president koncesual”, ku ai në çdo variant paraqitej si një humbës i madh.

Humbja e partisë së tij në vitin 2008, si dhe humbja e betejës për t’u bërë “president koncesual” në vitin 2010/2011, e kanë marginalizuar peshën politike të Surroit në një stad praktikisht të papërfillshëm. Kup-tohet, ato kanë një relevancë mediale, si dhe në fushën e luftës së ideve, por që nuk duhet të tejçmohet.

Nuk ka aspak dyshim se SHBA-të kanë luajtur rolin kyç në përkrahjen e projektit dhe jetësimin e pavarësisë së Kosovës. Që nga fillimi i krizës së Jugosllavisë kemi pas fat që interesat gjeostrategjike të SHBA-ve janë përputhur me interesat e lëvizjes çlirimtare të Kosovës, dhe për më shumë edhe interesat e shumicës së vendeve kyçe të botës perëndimore kanë qenë identike ose të ndikuara nga SHBA-të. Amerika dhe Perëndimi andaj janë perceptuar, dhe ende perceptohen, si aleatë dhe miq të Kosovës, sikur jemi të një familjeje. Shpesh kjo miqësi dhe aleancë ka prodhuar një raport të nënshkrimi të plotë: Amerika është vëllai i madh që kujdeset për interesin tonë dhe ne si një shtet i vogël dhe i ri duhet të jemi absolutisht të dëgjueshëm.

Në polemikën me Dellin, Surroi e ka kontestuar këtë tabu, duke bërë dallimin mes Amerikës që eksporton vlerat e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe të tregut të lirë, nga njëra anë, dhe Amerikës që favorizon shpesh pa pardon një sistem të kapitalizmit neoliberal, që nën petkun e liberalizmit, shtrin dominimin dhe eksplotimin ekonomik të firmave amerikane.

Një temë që e ka zbardhur Surroi, por para tij edhe Lëvizja Vetëvendosje e me gjysmë goje edhe LDK-ja dhe ndonjë subjekt tjetër, është roli i SHBA-ve dhe ambasadorit Dell në nënshkrimin e kontratës me firmën Bechtel-Enka për ndërtimin e autostradës Morinë - Merdar, shuma e së cilës nuk është zbardhur dhe supozohet se dëmton buxhetin e Kosovës. Kur SHBA-të dhe BE-ja dërgojnë ndihma me vlerë prej

qindra dhe mijëra dollarë dhe euro (Veton Surroi ka qenë edhe vetë përfitues i madh individual i fondeve amerikane dhe evropiane!), kjo është në rregull, ndërkaq mungesa e transparencës së çmimit të kontratës për autostradën, paraqitet si plaçkë dhe Kosovës. Edhe privatizimi i resurseve publike të Kosovës gjithnjë e më shumë po perceptohet si dorëzim para një imperializmi ekonomik, por edhe politik.

Ky diskurs e vë në dyshim sinqeritetin e idesë së “miqësisë pa interes” mes Amerikës dhe Kosovës. Në këtë kontekst ambasadori Dell perceptohet si eksponent i një strategjie që në afatet e gjata është e rrezikshme për interesat e Kosovës. Çdo intervenim ose ndërmjetësim i Dellit në proceset komplekse të shtetndërtimit të Kosovës, interpretohet vetëm nga aspekti negativ, i një Amerike që shtret si mike e Kosovës, por në të vërtetë në mashtron dh fut në kurthe dhe humbje historike të pariparueshme!

Diabolizimi i ambasadorit Dell ka vazhduar edhe me përhapjen e perceptimit se ai për hir të këtyre interesave meskine neo-liberale dhe në esencë anti-demokratike, i jep përkrahje dhe e mban në pushtet qeverinë aktuale dhe kryeministrin Hashim Thaçi, sepse e ka më lehtë të manipulojë me te, se sa m forcat dhe individët e vetëdijuesur që janë të përkushtuar për mbrojtjen e interesave vitale të Kosovës. Opozita radikale e konsideron Qeverinë e Thaçit si jolegjitime, pasi që ka dalë si rezultat i “vjedhjes industriale” të votave, është totalisht e korruptuar, është servile ndaj të huajve dhe e gatshme që të bëjë çdo lloj kompromisesh, shpesh dhe tradhtish kombëtare.

Kritika radikale jo vetëm e performansës së pushtetit, por edhe e totalit të realitetit të Kosovës, nuk është ndihmesë për stabilizimin dhe zhvillimin e Kosovës. Kjo kritikë i bën gropën vetë procesit të shtetndërtimit, që thjesht nuk mund ta bëjë, as me ndihmën e Amerikës dhe misioneve perëndimore, që shteti absolutisht funksional të lind pënjehëresh si perëndesha Athina, me gjithë pajisjet dhe fuqitë e një hyjneshe të fuqishme, nga koka e Zeusit.

Ndërtimi i demokracisë është proces, dhe duhet të kemi të shpenzohen mandatet edhe kur Qeveritë nuk janë perfekte. Qeveria që nuk na pëlqen ose bën në gabime, mund të ndëshkohet me vota, qoftë në Kuvend, qoftë në zgjedhjet e radhës.

Kur thuhet se zgjedhjet e vitit 2010 kanë qenë me probleme ose jolegjitime, - dhe është e vërtetë se ka pa parregullsi, - duhet të kemi parasysh se ky ka qenë një proces institucionalisht i arnuar dhe në instancën e fundit i pranuar nga të gjithë subjektet politik. Kjo vlen edhe për zgjedhjet e presidentëve, të Pacollit, që u anulua në mënyrë kushtetuese, dhe të Jahjagës, që po trumbetohet se na paska dal nga zarfi i Dellit, por që në të vërtetë, edhe ate e kanë zgjedhur instancat kushtetuese, sipas rregullave. Zarfi ka qenë vetëm propozim ndihmesë e Dellit që të dilet nga qorrsoaku dhe refuzimi i disa kandidatëve të tjerë për president, që nuk u aprovuan nga negociatorët.

Mirë është që vetëdija kritike në Kosovë po rritet, që i bëjmë edhe llogaritë më të thella dhe më afatgjate të miqësisë dhe aleancave politike në kontekste të ndryshme ndërkombëtare, por duhet të kemi parasysh se Kosova e pavarur i ka vetëm 4 vjet e ca muaj, dhe ende ka nevojë për tutori dhe ndërmjetësime si ato të ambasadorit Dell.

» Po na pret pra një vjeshtë politike në Veri të Kosovës dhe në raportet e Prishtinës dhe Beogradit, ndërsa nuk po shihet që ne jemi të gatshëm për një përbalje të tillë.

## Çka ndodhi tash e një vit në Veri të Kosovës?



Blerim Shala

Presidentja dhe Kryeministri i Kosovës, me 25 korrik, 2012, në shënim të përvjetorit të ngjarjeve të njohura të një viti më parë, qëndruan në Portat kufitare 1 dhe 31, ku u takuan me doganierët dhe policët e Kosovës.

Gjatë ditës, Kryeministri Thaçi pati takim me qytetarët e Mitrovicës së Veriut, ku u trajtuan temat e përmirësimit të sigurisë në këtë komunë, të funksionimit të qytetit të Mitrovicës në tërësinë e tij, dhe poashtu u shqyrtuan mundësitë e përmirësimit të gjendjes sociale dhe ekonomike. Në këtë takim u rikonfirmua që zgjedhjet e para lokale në këtë komunë do të mbahen me 28 tetor të këtij viti.

Thaçi dhe Jahjaga poashtu morën pjesë në përrimin e një fabrike të re në Mitrovicën e Veriut, e cila do t'i punësojë 100 veta.

E dini tashmë që asgjë prej këtyre fjalëve të shkruara tashmë, nuk ka të bëjë me të vërtetën. Por, me gjasë, ky do të duhej të ishte lajmi i synuar a i dëshiruar në politikën kosovare, ashtuqë të gjithë ne do të mund të bashkoheshim rreth vlerësimit që gjendja në Veriun e Kosovës tani ka ndryshuar shumë, dhe që çfarë nisi tash e një vit më parë, ka qenë ai topthi i vogël që lëvizti një ortek të madh politik, ekonomik dhe social, që solli integrimin e plotë të Veriut në Republikën e Kosovës.

Mungesa e këtij lajmi, nuk ka shkurajuar autoritetet e vendit që me ngulm të insistojnë në vlerësimet fitimtare në shënim të këtij përvjetori. Fjalët e përdorura në të gjitha ceremonitë e bëra prej qeveritarëve të Kosovës, përplasen keqas me realitetin në Veri, i cili thënë troç, është ende larg atij që do të duhej të ishte. Tejt fjalëve të mëdha, edhe në këto ditë dëgjuam dhe pamë shumë patetikë dhe fare pak gatishmëri për të kuptuar se çfarë duhet bërë në Veri të vendit. Për më shumë, u bënë kolona të tëra zyrtarësh që shkuan në vizitë familjes së pjesëtarit të Njësisë Speciale, Enver Zymberit, u përurua nisja e ngrirjes së lapidarit të tij në Prishtinë, ndërsa ta zëmë, nuk u shfrytëzua ky vit i kaluar që familjes Zymberi t'i ndërtohet një shtëpi e re, dhe që të zihen ata që e vranë atë në pritë, para një viti. Ministria e Punëve të Brendshme doli me një Raport se si është vrarë heroi i Kosovës, gjë të cilën, realisht, është dashur ta bëjë një javë a dhjetë ditë pas 26 korrikut të vitit 2011.

Dhe kështu me radhë.

Po çfarë ka ndërruar në Veri dhe rreth Veriut në dymbëdhjetë muajt e kaluar?

Është e vërtetë që jemi dëshmitarë të kthimit të policëve dhe doganierëve në Portat 1 dhe 31, apo, thënë më saktë, të kthimit të gjendjes që ka qenë në fuqi deri me 19 shkurt, 2008.

Kemi Zyrën e Qeverisë së Kosovës në Veri të Mitrovicës, e cila poashtu mund të klasifikohet si një

hap para në drejtimin e duhur.

Është e saktë që kemi zhvillime pozitive edhe në luftimin e krimit të organizuar, edhe pse andejpari, krimi është organizimi i vetëm i mirëfillt që funksionon, tok me shtetin e Serbisë.

Poashtu, qëndrojnë vlerësimet që idetë apo opsionet për ndarjen territoriale të Kosovës, janë dobësuar ndjeshëm prej korrikut të vitit të shkuar, por ato megjithatë janë ende gjallë. Këtë nuk duhet harruar.

Gjithsesi, dhe kjo mbase është arritja më e madhe e këtyre ngjarjeve, nuk ka më dilemë se kush në fakt i prinë strukturave në Veri të Kosovës: Kemi të bëjmë me shtetin e Serbisë, dhe prania e tij është në kundërshti me të gjitha dokumentet ndërkombëtare rreth Kosovës dhe natyrisht, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Një tjetër rezultat i 25 korrikut (2011), është zgjimi nga gjumi i kryeqendrave perëndimore, që tema e Veriut duhet të adresohet sa më parë, apo që Status Quo nuk mund të qëndrojë më.

Ky pikëshikim pastaj solli dy konkludime rreth KFOR-it, njeri i cili është pozitiv e tjetri doli si problematik për Prishtinën zyrtare.

I pari thotë qartë që KFOR-i nuk mund dot ta përmbyllë detyrën e tij në Kosovë dhe të largohet, para se Veriun e Kosovës të integrohet mirëfilli në rëndin kushtetues të Kosovës.

Po i dyti konkludim, që na përsëritet goxha shpesh prej zyrtarëve më të lartë politik dhe ushtarak të Paktit NATO dhe të KFOR-it është që Veriun është temë politike dhe jo ushtarake, dhe që ai duhet të trajtohet në bisedimet midis Prishtinës dhe Beogradit.

Ju duhet t'i bindi serbët e Veriut që perspektiva e tyre është në Kosovë dhe në zbatimin e Pakos së Presidentit Ahtisaari, bisedimet që do të vijnë në mes jush dhe Beogradit duhet të krijojnë rrethana të reja në marrëdhëniet tuje problematike midis Kosovës dhe Serbisë, e ne do të ju ndihmojmë politikisht dhe ekonomikisht, pos tjerash, edhe duke bërë vazhdueshëm presion mbi Beogradin për zbatimin e të gjitha Marrëveshjeve të arrira në Bruksel (në "dialogun teknik") dhe për shpërbërjen e strukturave të Serbisë në Veri të Kosovës.

Kështu disi mendojnë diplomatët kryesorë perëndimorë që merren me çështjen e Veriut të Kosovës dhe me të ardhmen e afërt e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Po na pret pra një vjeshtë politike në Veri të Kosovës dhe në raportet e Prishtinës dhe Beogradit, ndërsa nuk po shihet që ne jemi të gatshëm për një përbalje të tillë, apo, thuaja e gjithë skena politike e vendit, më shumë preferon të përdorë një mburojë të rrejshme propagandistike dhe kinse patriotike, që kinse andejpari gjithçka do të ecë sipas dëshirave tona.

Si po duket pra, për atë lajmin e dëshiruar, i cili zuri vend në krye të këtij shkrimi, do të presim tutje. Kush e di se çka do të ndodhë në ndërkohë. Por nëse në fund të këtyre zhvillimeve, nuk do ta lexojmë atë lajm, kjo do të ishte një shenjë shumë e keqe për Kosovën.

Bëhu pjesë e programit IPKO Pika!

Mbledh pika dhe shëndrroi në minuta, internet në mobil apo dhurata! Regjistrohu FALAS duke dërguar SMS me tekst "pika" në numrin 123



» Autori është

Nënkrystari i Parë i Aleancës për Ardhmëninë e Kosovës. Kjo kolonë është shkruar enkas për Gazetën "Express"

# Politikë

REDAKTOR: SHPEND LIMONI  
E-MAIL: SHPEND.LIMONI@GAZETAEXPRESS.COM  
TEL: 038 76 76 76 FAX: 038 76 76 78

## Propozimi i Gallucit

Ish-shefi i UNMIK'ut në Mitrovicë, Gerard M. Gallucci ka propozuar se zgjidhja më e mirë mes Kosovës dhe Serbisë do të ishte modeli i zgjidhjes irlandezo-angleze. Ai thotë se historia e Irlandës ka pika interesante të ngjashmëri ndërmjet Kosovës

dhe Serbisë, por ka edhe dallime të theksuara. Sipas Gallucit, marrëveshje të mundshme ndërmjet Serbisë dhe Kosovës do të ishte pranimi i pavarësisë së Kosovës nga Beogradi, por edhe pranimi nga ana e Kosovës që

Veriu të shkëputet nga pavarësia e saj, në mënyrë që të shndërrohet në pjesë të Serbisë. "Mund të jenë të lidhura edhe si dy shtete nën një kurorë të njëjtë, ashtu siç ishin Britania e Madhe dhe Shteti i Lirë Irlandez në vitin 1921", ka thënë Gallucci.

# TA PRESIM SE

**Daniel Serwer thotë se Kryeministri serb, Ivica Dacic ka dhënë disa sinjale të mira në raport me Kosovën, por tani duhet parë veprimet e tij. Megjithatë, normalizimi i raporteve mes dy vendeve, sipas tij, është ende larg. Analisti amerikan në një intervistë për Express pohon se diplomacia kosovare përballë kundërshtarëve po shfaqet e talentuar, edhe pse me resurse të kufizuara.**



FOTO: MAJUNDA HOXHA

### Blerton Ajeti

blerton.ajeti@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 29 KORRIK —

Express: Z. Serwer, disa muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve në Serbi u formua Qeveria e re. Cilat janë gjasat tani për një dialog mes Prishtinës dhe Beogradit, dhe mundësitë për të arritur rezultate?

Serwer: Është ende herët të thuhet. Kryeministri i ri, Ivica Dacic ka thënë disa gjëra të mira: ai do t'i japë prioritet ekonomisë së Serbisë, është duke zvogëluar burokracinë që është e dedikuar për Kosovën, dhe ka thënë se do të implementojë marrëveshjet tashmë të arritura me Prishtinën. Por

nuk mjafton vetëm të dëgjojmë se çfarë thotë qeveria e re, por duhet të shohim çfarë bën.

Express: Të premten kishte sinjale kontradiktore nga Parlamenti serb gjatë betimit të Qeverisë. Kryeministri Dacic tha se ai do të angazhohet të mbaj Kosovën brenda kufijve serbë, por u shfaq i gatshëm të vazhdojë dialogun dhe të implementojë marrëveshjet e arritura.

Serwer: Kushtetuta e Serbisë kërkon që Kosova të mbetet pjesë e Serbisë, kështu që në këtë kuptim, Dacic në fakt nuk ka zgjedhje. Politikanët serbë i kanë krijuar vetes së tyre një pengesë të jashtëzakonshme kur ndryshuan

Kushtetutën më 2006. Vazhdimi i dialogut nuk është qëllim, por mënyrë. Le të shohim nëse ai do të përmbushë premtimin për të implementuar marrëveshjet tashmë të arritura.

Express: Çfarë prisni në fazat e ardhshme sa u përket marrëdhënieve Kosovë-Serbi? A mund të normalizohen ato kur kemi parasysh lidhësinë e ri atje?

Serwer: Unë pres shumë pak, por shpresoj që Serbia do ta pranojë se normalizimi i marrëdhënieve u shkon interesave të saj më të mira. Normalizimi domethënë për mua që Beogradi dhe Prishtina duhet të

kenë përfaqësues në kryeqytetet e tyre dhe të pranojnë integritetin territorial të njëri-tjetrit. Beogradi është ende shumë larg nga kjo. Nuk jam i sigurt që edhe Kosova është e gatshme për këtë.

Express: Si e shihni diplomacinë kosovare karshi asaj serbe?

Serwer: Diplomacia serbe është mirë e etabluar dhe taktikisht ka qenë shumë e mirë: ajo ka ngadalësuar njohjet për Kosovën dhe ka fituar Presidencën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB'së. Ajo ka bindur shumë shtete se një Kosovë e pavarur është kërcënim për paqen dhe sigurinë rajonale.

Por nuk e shoh se çfarë të mire në fakt do të sjellë kjo krejt në fund.

Njohjet janë duke ardhur dhe do të vazhdojnë të vijnë. Presidencja e Asamblesë së Përgjithshme do të përfundojë brenda një viti, kur shpresoj që të shohë Kosovën me mbi 100 njohje.

Serbia humbi rastin e vet në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, kur kërkoi një opinionion këshillues rreth shpalljes së pavarësisë së Kosovës, dhe politikat e saj në Kosovën Veriore kanë krijuar probleme serioze me krimin e organizuar dhe dhunën politike, të cilat tashmë kanë vonuar hapjen e negociatave të Serbisë për anëtarësim në BE.

Ngadalësimi i gjërave nuk i ndihmon Beogradit, nëse këto e dëmtojnë prospektin e Serbisë

## Dinkic: Të hapet Zyra e Prishtinës në Serbi

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave i Serbisë, Mladan Dinkic ka thënë se Qeveria e re e Serbisë duhet të pranojë gjithçka që u premtua më parë ndaj BE'së në lidhje me Kosovën. «Ne duhet të pranojmë

hapjen e zyrave të Serbisë në Prishtinë dhe të Prishtinës në Beograd, nëse këtë premtime ia ka dhënë BE'së qeveria e mëparshme. Ajo që ne kurrë nuk do të pranojmë është njohja e pavarësisë së Kosovës,

si dhe që Prishtinës t'ia japim ulësen në OKB», ka thënë ai për gazetën «Danas». Dinkic tha se qeveria serbe është e gatshme që me Prishtinën të flasë hapur dhe që «në mënyrë efektive t'i

zgjdhë problemet që lidhen me jetët e njerëzve në Kosovë, përkatësisht zhvillimin ekonomik në atë rajon». «Ka pasur shumë vendime të pakuptimta të qeverisë së mëparshme. Pse, për shembull,

u është ndaluar bankave serbe për të hapur degë në Prishtinë? Si Ministër i Financave, i pari do t'i stimulojë bankat serbe që të shkojnë në Prishtinë, në Zagreb, Sarajevë, siç janë aktualisht në Banja Llukë».

# RBINE

për në BE dhe rezultati eventual i Kosovës është i njëjtë.

**Express: Ka pasur kritika se diplomacia e Kosovës nuk është duke funksionuar si duhet. Si e shihni ju këtë?**

**Serwer:** Ju jeni kundër një kundërshtari të fortë dhe me përvojë me lidhje historike në botë dhe mbështetje nga Moska. Aparati diplomatik i Kosovës është ende i ri dhe në ndërtim e sipër – ju jeni pak të njohur në shumë pjesë të botës. Bashkimi Europian është i ndarë sa i përket Kosovës, me pesë anëtare që nuk e kanë njohur atë. Ju shpesh është dashur të vareni në një pjesë të madhe në amerikanët, posaçërisht sa i përket Amerikës Latine dhe Azisë. Ju keni bërë progres të mirë në Afrikë së fundmi. Nuk do ta fitoni secilën betejë. Por në fund, Kosova do të jetë anëtare e OKB'së dhe mirë e pranuar në komunitetin ndërkombëtar. Tashmë veç është në shumë vende.

**Express: A duhet Kosova të ndryshojë diçka sa i përket diplomacisë, në mënyrë që të rrisë numrin e njohjeve, por edhe të përmirësojë imazhin e vet në botë?**

**Serwer:** Kosova duhet të përdorë çdo resurs në dispozicion për të projektuar realitetin e vet jashtë. Gratë e vendit tuaj kanë dëshmuar të jenë një aset posaçërisht i fuqishëm. Arta Dobrosi dhe Majlinda Kelmendi janë duke ju ndihmuar që t'i tregoni botës se Kosova është një shtet kreativ dhe me talente. Vlora Çitaku është duke dëshmuar lidhshmëri në përgatitjen për Bashkimin Europian. Konferenca "Fuqizimi i Grave" të cilën Presidentja Jahjaga do ta udhëheqë në Prishtinë, në fillim të tetorit, është një shembull tjetër i mirë.

Vetë familja ime çuditur kur u them se sa paqësore, të sigurta dhe normale janë vizitat e mia në Prishtinë. Fundi i mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë është një mundësi e shkëlqyeshme për t'i treguar botës se ju është një vend i cili i përmbush obligimet ndërkombëtare dhe

do të vazhdojë ta bëjë atë edhe pasi mbikëqyrja ndërkombëtare të përfundojë zyrtarisht.

Një prej gjërave më të rëndësishme që duhet të bëni është të projekttoni realitetin e Kosovës të njerëzit në Serbi, ku shtypi kurrë nuk ndalon të portretizojë rrethanat këtu si kaotike, të dhunshme dhe jomiqësore për serbët. Ky imazh është i dëmshëm për ju edhe në vendet e tjera.

Të gjitha shtetet në botën demokratike gjykojnë pjesërisht mbi atë se si i trajtojnë minoritetet më të pafavorshme. Amerika ka hendikepuar veten për shumë vite në botë, duke mos i trajtuar minoritetet si duhet brenda vendit.

Të drejtat njerëzore të serbëve, të romëve dhe të qytetarëve të tjerë të Kosovës duhet plotësisht të mbrohen, nëse Kosova dëshiron të shihet si demokraci serioze, e cila meriton njohje ndërkombëtare. Implementimi i Pakos së Ahtisaarit ju ka ndihmuar shumë në këtë aspekt. Vazhdimi i përpjekjeve në këtë drejtim do të vazhdojë të shpiguajë veten.

**Express: Ju jeni në kontakt me zyrtarët kosovarë. A mendoni se ka njëzë kompetentë në diplomacinë e Kosovës?**

**Serwer:** Po, unë besoj se zyrtarët tuaj diplomatikë janë një grup i jashtëzakonshëm, të talentuar, mirë të trajnuar dhe të përkushtuar maksimalisht dhe që punojnë nën lidhshmëri e fuqishme të Enver Hoxhajt. Unë kam nderin që të bashkëpunoj me ta. Resurset me të cilat ata duhet të punojnë janë të kufizuara, dhe kështu duhet që të jenë të mençur dhe kreativë në krijimin e mundësive për të treguar Kosovën jashtë dhe për të ndjekur interesat efektivisht. Ju kurrë nuk do të keni ambasada si ajo amerikane, të cilën e kam drejtuar në Romë 20 vjet më parë, e cila kishte 800 të punësuar. Por disa kosovarë të mirë mund të bëjnë mrekulli, nëse kanë vullnetin të punojnë së bashku dhe të aplikojnë resurset e tyre të kufizuara në mënyrë të fokusuar siç duhet.



**Martti Ahtisaari**  
sërish është gjendur në thumb të kritikave në Serbi, pas deklaratave se ky vend nuk duhet të lejohet të anëtarësohet në BE pa e njohur Kosovën. Aleksandar Vulin, Shef i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, tha se ish-Presidenti i Finlandës po ua shlyen borxhin lobistëve shqiptarë. Por, Borko Stefanovic tha se deklaratat e Ahtisaarit kanë peshë në Europë.

## Ahtisaari çon peshë

**Express**

PRISHTINË, 29 KORRIK – Politikanët në Beograd e kanë pritur keq deklaratën e ish-ndërmjetësit për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, i cili tha se Serbia nuk duhet lejohet të bëhet anëtare e Bashkimit Europian pa e pranuar pavarësinë e Kosovës.

Ish-shëfi i ekipi negociator të Serbisë në dialog me Kosovën, Borislav Stefanovic ka thënë se qëndrimi i Ahtisaarit është personal, por ka potencuar se fjala e ish-Presidentit të Finlandës ka peshë në Europë.

“Në rast se njerëzit si Ahtisaari vendosin për integrimin e Serbisë, ky edhe mund të shndërrohet edhe në kusht formal”, ka thënë Stefanovic, raportojnë mediat serbe.

Sipas tij, i mbetet Qeverisë se re dhe diplomacisë që të tentojnë që t'i shmangen një epilogu të tillë.

“Në pyetje është qëndrimi personal i Ahtisaarit, i njohur për mbështetje të pavarësisë së Kosovës. Ai, megjithatë gëzon mbështetje të madhe në Europë dhe fjala e tij ka peshë, edhe pse nuk është person i cili për atë vendos”, ka theksuar Stefanovic.

Sipas tij, Serbia nga Ahtisaarit nuk ka dëgjuar asgjë të re, por se deklarata konfirmon se paraskena e planit të tij gjithmonë ka qenë që Serbia duhet edhe formalisht ta pranojë pavarësinë. Kurse shefi i Zyrës serbe për Kosovën, Aleksandar Vulin ka deklaruar se deklarata e Ahtisaarit është larje e borxhit ndaj lobistëve shqiptarë, kurse Serbia asgjë s'i ka borxh.

“Serbia është anëtare e OKB'së dhe për këtë do ta respektojë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB'së. Deklarata e tij është shlyerje e borxhit ndaj lobistëve shqiptarë, mirëpo ne atij nuk i kemi borxh”, ka theksuar Vulin.

Ndaj deklaratës së Ahtisaarit, ka reaguar edhe ish-Kryeministri i Serbisë, Vojislav Kostunica, i cili ka thënë se deklarata e Ahtisaarit se Serbia nuk duhet të hyjë në BE derisa nuk e pranon shtetin e Kosovës, duket si kërcënim me pushkë të zbrazët.

Sipas mediave serbe, Kostunica ka vlerësuar se Kushtetuta e Serbisë është e “padepërtueshme” për pavarësinë e Kosovës, dhe as që ekziston mendimi që Kushtetuta mund të ndryshohet, derisa tërësia territoriale e vendit është e cenuar.

Kostunica ka thënë se BE'ja dhe anëtarët e saj gjithashtu përballen me krizë, por është e qartë që BE'ja për qytetarët e Serbisë më nuk ka forcë tërheqëse dhe se politika “BE'ja nuk ka alternativë” ka përfunduar në Serbi.

Ahtisaari ka deklaruar se Serbia nuk duhet të lejohet të hyjë në BE, derisa nuk e njeh Kosovën. Sipas tij, vendet që nuk e kanë njohur Kosovën e kanë trimëruar Serbinë në përpjekjet e saj. Kurse, ai beson se së shpejtë edhe shteti i 100-të do ta njohë Kosovën.

Komentet e ish-Presidentit të Finlandës vijnë pas deklaratave të Presidentit serb, Tomislav Nikolic, i cili me t'u zgjedhur president, kishte thënë se kurrë nuk do ta njohë Kosovën. Të njëjtat deklarata i bëri edhe i saposhpalluri Kryeministër serb, Ivica Dacic, i cili në betimin e tij u zotua ta mbajë Kosovën “nën kujfite serbë”.

Për Ahtisaarin, këto deklarata janë antieuropiane dhe se përballë një Serbie të tillë, Bashkimi Europian nuk guxon të bëjë lëshime.

“Nëse duan në Rusi, le të shkojnë atje. Kurrfarë lëshimesh pe nuk janë të pranueshme, as në BE, as tjetërkund”, ka theksuar Ahtisaari.

## Dell largohet në gusht

Ambasadori amerikan në Kosovë, Christopher Dell pritet ta lërë postin e tij gjatë javës së dytë të muajit gusht të këtij viti. "Ne aktualisht presim që tranzicioni mes dy ambasadorëve të zhvillohet gjatë javës së dytë të

gushtit. Znj. Kelly Degnan, aktualisht zëvendëshefe e misionit, do të jetë e ngarkuara me punë e Ambasadës gjatë tranzicionit", thuhet në përgjigjen e Ambasadës amerikane në Kosovë, për Kosovapress.

Ndërkaq, Tracey Ann Jacobson, e cila tashmë është emëruar ambasadore e SHBA'së në Prishtinë, ka përvojë të gjatë diplomatike. Ajo është zyrtare karriere e Shërbimit të Lartë të Jashtëm dhe momentalisht shërben si Zëvendësre-

jtoreshë e Institutit të Shërbimit të Jashtëm (FSI). Para se t'i bashkohet FSI'së, ka shërbyer si ambasadore e SHBA'së në Takhikistan (2006-2009) dhe ambasadore e SHBA'së në Turkmennistan (2003-2006).



# U BESUAM AMERIKANEVE

Isa Mustafa thotë se marrëveshja me të cilën Atifete Jahjaga u zgjodh Presidente, u bë për shkak të besimit ndaj amerikanëve. Kreu i LDK'së thotë se do të insistojë që marrëveshja të realizohet dhe shefi i ri i shtetit të zgjidhet siç është paraparë. Mustafa pohon se nëse kjo ujdë nuk respektohet, do të humbë besimi te të gjitha palët.

### Express

PRISHTINË, 29 KORRIK —

Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa nuk ndihet i tradhtuar nga Hashim Thaçi, e as nga Behgjet Pacolli, pavarësisht se marrëveshja e arritur me këta të dy në prill të vitit të kaluar nuk po gjen zbatim. Thotë se për marrëveshjen me të cilën Atifete Jahjaga u bë Presidente, i ka besuar Ambasadës së SHBA'së në Prishtinë.

"Nuk i kemi besuar Partisë Demokratike të Kosovës në këtë marrëveshje, ne i kemi besuar Ambasadës amerikane dhe nuk kemi shkuar se na ka ftuar PDK'ja, por që na ka ftuar ambasadori i një shteti mik, të cilin ne i kemi besuar dhe i besojmë. Ne ndihemi të mashtruar nga këto dy subjekte, të cilat kanë qenë aty dhe natyrisht të mospërbajtjes së marrëveshjes edhe nga ndërmjetësuesi i kësaj marrëveshjeje", ka thënë Mustafa në një intervistë për REL, të dielën.

Mustafa ka paralajmëruar se do të ketë pasoja në rast të moszbatimit të marrëveshjes.

"Pasoja do t'i bartë Kosova, në qoftë se ne fillojmë t'i shkelim, fillojmë ta mashtrrojmë njëri-tjetrin dhe fillojmë ta presim njëri-tjetrin në besë të marrëveshjes e tilla, për arsye se më s'do t'i besojmë njëri-tjetrit - s'do t'i besojmë as Presidentes, as Hashim Thaçit, dhe po ashtu nuk do t'u besojmë as faktorëve ndërkombëtarë, në qoftë se ata na thërresin si ndërmjetësues për marrëveshje të ndryshme", ka thënë Lideri i LDK'së.

Implementimi i marrëveshjes



FOTO: PETRIT BRAHMANI

ndërkaq është vënë në pikëpyetje sidomos aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila shpalli se Jahjaga ka mandat të plotë.

Por, njësoj nuk mendon edhe Mustafa. Ai këmbëngul se marrëveshja nuk e prek aktin më të lartë juridik e politik të shtetit dhe se ka forma për realizimin e marrëveshjes në praktikë. "Në asnjë rast, Gjykata Kushtetuese dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk e pengon implementimin e marrëveshjes politike, të

cilën ne e kemi arritur në prillin e vitit të kaluar, sepse ne nuk do ta bënim një marrëveshje të tillë pa kushtet që ne i kemi përcaktuar në marrëveshje".

Mustafa për më tepër u zotua se do të insistojë për zbatimin e marrëveshjes së liderëve.

"Unë do të insistoj në emër të LDK'së që marrëveshja të realizohet, që zgjedhjet për President të bëhen ashtu si i kemi paraparë... Si do të vijë puna deri te zgjedhjet, është punë tjetër", ka

thënë ai. Marrëveshja e liderëve parashihet shkarkimin e Presidentes aktuale, Atifete Jahjaga, gjashtë muaj pasi që reformat kushtetuese dhe zgjedhore të hyjnë në fuqi. Në këtë formë do të mund të shpallehin zgjedhjet e reja. Por, kushtetuesja e cilësoi shkurtimin e mandatit pesëvjeçar të Presidentes si shkelje të të drejtave të saj. Madje, në një nga frazat e vendimit thuhet se populli shpreson që Jahjaga të mbajë mandatin e saj pesëvjeçar.

Më këtë, ndërkaq nuk pajtohet asesi Mustafa. "Është çështje tjetër se si Gjykata Kushtetuese është marrë me disa fusha, të cilat nuk bien nën Gjykatën Kushtetuese, sepse nuk është punë e Kushtetueses të thotë se çka pret populli. Ë gjithë populli i Kosovës e ka ditur se për cilin mandat është zgjedhur Presidentja. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë anketë me popullin, në mënyrë që ajo të dalë tash dhe të flasë në emër të asaj se çfarë pret populli në të ardhmen", ka thënë Mustafa.

I pyetur ndërkaq nëse LDK'ja do të bllokoi reformat në rast të moszbatimit të marrëveshjes, gjë të cilën e kërkon vazhdimisht, Mustafa ka mohuar se partia e tij nuk dëshiron të ketë bllokada, mirëpo ka thënë se deputetët tij do të jenë të lirë të votojnë sipas vullnetit të tyre pasi që marrëveshja politike nuk po zbatohet. "Si do të votojnë deputetët e Kuvendit nga LDK'ja, është çështje e tyre nesër. Unë e them publikisht se unë më, atyre deputetëve nuk do t'u them se është një qëndrim ose një marrëveshje politike që të votoni kështu, por do t'i lëmë që ata të votojnë sipas vullnetit të tyre", ka thënë lideri i LDK'së.

Ndërsa ka mohuar futjen në koalicion qeverisës me PDK'në e Hashim Thaçit.

"Mendoj se mënyra e sjelljes së kësaj qeverie flet se kjo qeveri i ka ditët e numëruara, sepse është shumë vështirë të qeveriset vendi kështu, është një koalicion shumë i brishtë, një qeveri e cila nuk mund të marrë vendime të rëndësishme për Kosovën", ka thënë Mustafa.

**Presidenti i Serbisë, Tomislav Nikolic tha se angazhohet që bisedimet mes Beogradit dhe Prishtinës të jenë më serioze, ku do të përfshiheshin njerëz me përgjegjësi. Nikolic pas një takimi me Ministrin britanik për Europë, ka thënë se dy vendet kanë dallime të mëdha rreth Kosovës.**

## Për negociata serioze

PRISHTINË, 29 KORRIK — Presidenti serb, Tomislav Nikolic dhe Ministri britanik për Europë, David Lidington janë takuar në Londër, ku kanë folur edhe për bisedimet Prishtinë-Beograd. Sipas njoftimeve, në këtë takim është konstatuar se Serbia dhe Britania e Madhe edhe më tutje janë "në dy

pole të largëta" rreth çështjes së Kosovës. "Mendoj se edhe Ministri britanik (Lidington) e ka përkrahur dëshirën time që bisedimet të jenë shumë më serioze se deri më tash, të jenë në nivelin nga i cili njerëzit marrin përgjegjësi", ka thënë Nikolic pas takimit me Ministrin britanik. Nikolic ka thënë se Ministri

britanik e ka parë se ai nuk e ka ndryshuar politikën rreth Kosovës.

"Kjo për mua është e rëndësishme, sepse vërtet nuk e kam ndryshuar politikën. Për fat të keq nuk e ka ndryshuar as ai (Lidington). Edhe më tutje, reformat çështjes së Kosovës jemi në dy pole të largëta", tha Nikolic.



# Nacionale

Redaktor: Jeton Musliu • e-mail: jeton.musliu@gazetaexpress.com  
tel: 038 76 76 76 fax: 038 76 76 78

## Nehati s'është ai që kërkoni

Prizren, 29 korrik- Familjarët e Nehat Halitit nga Prizreni, thonë se djali i tyre nuk ka qenë në Kosovë në kohën kur ai akuzohet nga Serbia se ka kryer krime lufte. I ati i Nehatit nuk shpreson në drejtësinë serbe, ndërsa KMLDNJ, apelon tek mërgimtarët që të shfrytëzojnë

rrugë të tjera për kthim në Kosovë. Në familjen e Nehat Halitit nga Prizreni që u arrestua nga policia kufitare serbe në Subotić, kur po ktheje në Kosovë, ka pllakosur frika se çdo të ndodhë me djalin e tyre. Babai i Nehatit, Nexhat Haliti ka theksuar se Nehati në atë kohë

kur Serbia pretendon se i ndaluar ka kryer krime lufte, keqtrajtim të dy personave gjatë luftës në Kosovë, ai ka qenë në Shqipëri. Pas kësaj që i ndodhi Nehatit, i ati nuk ka shpresë në institucionet serbe, për lirinë e djalit nga arresti.

## Policia

### Arrestohen për pengim

Drenas, 29 korrik- Janë arrestuar dy të dyshuar pasi të njëjtit kishin penguar zyrtarët policor duke i fyer verbalisht gjersa ata ishin duke u marrë me një rast aksident trafiku në të cilin ishte i përfshirë njëri nga të dyshuarit. Të dyshuarit pas inicimit të rastit me vendim të prokurorit janë liruar në procedurë të rregullt.

### Arrestohet në aheng

Prishtinë, 29 korrik- Është arrestuar i dyshuari pasi i njëjti në një aheng familjar (dasme) kishte shtënë me armë zjarri. Në vendin e ngjarjes në cilësi të provave materiale janë gjetur dhe konfiskuar një revolve me gaz, dy gëzhoja 9 mm si dhe një fishek i pashkrepur. Me vendim të prokurorit, i dyshuari pas inicimit të rastit lirohet, rasti vazhdon në procedurë të rregullt.

### Rrokulliset vetura

Prizren, 29 korrik- Vetura me targa vendore të cilën e drejtonte i dyshuari si pasojë e mospërshatjes së shpejtësisë së lëvizjes kushteve të rrugës ka dalë nga rruga dhe është rrokullisur. Si pasojë e aksidentit në fshatin Lez të Prizrenit, lëndime trupore ka pësuar drejtuesi i veturës si dhe pasagjeri në veturë. Të lënduarit janë dërguar në tretman mjekësorë në QKU.

### Tenton të vetëvritet

Malishevë, 29 korrik- Viktima për motive ende të panjohura ka tentuar të vetëvritet duke përdorur sasi të pa kontrolluar të medikamenteve mjekësore. Viktimës i është ofruar tretmani mjekësorë dhe e njëjta sipas raportit mjekësorë është jashtë rrezikut për jetë.

### E sulmon i biri

Leposaviq, 29 korrik- Ankuësja ka raportuar në polici se i biri i saj në gjendje të dehur e kishte sulmuar fizikisht atë si dhe kishte thyer dhe demoluar orëndite shtëplake.

# KRASNIQI AKUZON KRASNIQIN



**Islam Krasniqi nga Shërbimet Teknike në QKU, ka akuzuar rëndë Rrahim Krasniqin, drejtor për Shërbime të Përbashkëta në këtë institucion. Ai ka thënë se drejtori është i përfshirë në disa raste të aferave korruptive. Në një letër tri faqesh dërguar Ministrisë së Shëndetësisë, Qendrës Klinike dhe medieve, Islam Krasniqi i ka përmendur një nga një aferat e mundshme të Rrahim Krasniqit. Ky i fundit nuk ka dashur të flasë.**

#### Nebih Maxhuni

nebih.maxhuni@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 29 KORRIK—

Pak para se ta suspendojnë nga puna, Islam Krasniqi ka vendosur të flasë për keqpërdorimet e mundshme që janë bërë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Ai këtë nuk e ka bërë me herët, por në momentet e fundit, kur atij i kishin shkuar shumë vërejtje me shkrim që i kanë paraprirë suspendimit të tij.

Krasniqi që është shef i Shërbimeve Teknike në QKU në një letër goxha të gjatë dërguar zyrtarëve më të lartë të Ministrisë së Shëndetësisë, atyre të QKU-së dhe medieve, të dielën ka akuzuar Rrahim Krasniqin, drejtor i Shërbimeve të Përbashkëta në QKU.

Krasniqi ka akuzuar Krasniqin se është i përfshirë në aferë korruptive në disa raste kur QKU-ja ka pasur nevojë për furnizime të ndryshme.

Ai në këto letra akuzuese thotë se Krasniqi dyshohet si i përfshirë

në aferë në rastet e kompresorëve të ajrit në Klinikën e Gjinekologjisë, rasti i furnizimit me kompjuter për QKU e, atij për furnim me mish e shumë raste të tjera.

"Rrahim Krasniqi as edhe një herë nuk ndërmer masa të duhura kundër keqpërdorimeve të mundshme, edhe pse lajmërohet me gojë dhe shkrim. Rasti i furnizimit me kompjuter për QKU-në, të cilët nuk kanë ardhur me performanca teknike sipas tenderit, ndërsa çmimi i tyre ka qenë 800 euro për copë", thotë Krasniqi.

Përveç kësaj, ai ka thënë se drejtori Krasniqi dyshohet se është i involvuar edhe në shumë aferë të tjera siç është edhe rasti me realizimin e sigurisë së ekzekutimit nga një kompani siguruese, në vlerë prej 30 mijë eurosh.

"Personalisht kam qenë i këqyr si njohës i kushteve të sigurimit në realizimin e tij. Z. Krasniqi drejtoi punën që qenë i involvuar me një punëtor të kësaj kompanie në përvetësimin e kësaj vlerë dhe derisa nuk ju kemi drejtuar kompanisë me shkrim në formë kërcënuese

nuk ka dashur ta bëjë pagesën, për rastin në fjalë mund të dëshmojë personalisht", ka rrëfyer ai në letrat e dërguar medieve të MSH dhe QKU-së.

Islam Krasniqi nuk është ndaluar me kaq.

Sipas tij, Rrahim Krasniqi nuk merr ndonjë masë për mbeturinat e hekurit me rastin e renovimit të Klinikës Infektive dhe asaj të Kirurgjisë.

Sipas tij, copat e metaleve që janë me kilogramë të tërë, dërgohen në një kompani me izën e Krasniqit.

"Kemi ndaluar një kamion me ndihën e rojave të nderit, i ngarkuar me metal, i kemi thënë se kamioni duhet të rrijë në QKU. Është bërë kështu, të nesërmen Krasniqi me shkrim u ka thënë Rojave të Nderit se bartja e metaleve të demoluara nga këto klinika duhet të vazhdojë, edhe pse ekziston kontrata për shitjen e tyre nga operatori ekonomik që ka ofruar çmim shumë më të volitshëm", tregon ai. Krasniqi thotë se ka qenë i detyruar nga Rrahim Krasniqi

që për 7 mijë euro më shumë të bëjë një kërkesë për mirëmbajtjen dhe servisimin e sterilizatorit të mbetjeve spitalore.

Në Klinikën e Gjinekologjisë dhe Pediatrisë është bërë kërkesë për renovimin e sistemit të 02 dhe testimit të bombolës statike dhe presionit të 02 në vlerë prej 8 mijë eurosh. Ai nuk ka lejuar, por e ka detyruar tjetërkënd ta bëjë përshtirimin në bazë të tenderit dhe kontratës ekzistuese për gazra medicinale, kontratë e cila është ende në fuqi dhe një operator ekonomik në bazë të urdhërësës së Krasniqit ka bërë montimin e pajisjeve në vlerë prej 27 mijë eurosh", rrefen ai.

Islam Krasniqi ka nënvizuar edhe akuzat të tjera në adresë të drejtorit Rrahim Krasniqi.

Gazeta gjatë gjithë të dielës është munduar të kontaktojë me zyrtarë për media të Qendrës Klinike Universitare, por një gjë e tillë ka qenë e pamundur.

Po ashtu, gazeta ka tentuar të marrë një qëndrim edhe nga Rrahim Krasniqi, por ai nuk ka dashur të flasë për këto akuzat.

## Nis ndërtimi i sheshit "Zahir Pajaziti"

Prishtinë, 29 korrik- Kryetari i Prishtinës, Isa Mustafa, bëri përrimin e nisjes së punimeve për ndërtimin e Sheshit "Zahir Pajaziti". Ai ka thënë se ky shesh është shumë i rëndësishëm, pasi që do të krijohen kushte shumë të mira për aktivitetet të ndryshme kulturore, sportive

dhe ekonomike, për qytetarët e kryeqytetit. Kryetari i Komunës së Prishtinës, Isa Mustafa bëri të ditur se ndërtimi i këtij sheshi do të përfundoj brenda këtij viti dhe do të kushtoi 4.7 milion euro, mjete këto të siguruar nga buxheti i komunës. "Parat për sheshin janë siguruar me

ndryshimet dhe plotësimet e buxhetit që kemi bërë në fillim të këtij viti. Është kontraktuar puna. Punët mendoj që do të kryhen në nivel të shtrimit të pllakave dhe sheshi do të jetë i shfrytëzueshëm në fund të këtij viti", tha ai. Mustafa gjithashtu tha se shtatorja e

Dëshmorit të Kombit, Zahir Pajaziti është zhvendosur dhe është duke u ruajtur te ndërtesa e re e Komunës së Prishtinës. Ai tha nëse duhet që të ndërrohet kjo shtatore shpenzimet do t'i bartë Komuna e Prishtinës. Nuk është komuna ajo e cila do të vendos nëse se cila shtatore do të

vihet. Ata që e kanë vendos të vhihet ajo shtatore, mund të vendosin që ajo prapë të vihet dhe ne plotësisht do ta pranojmë. Nëse qytetarët dhe bashkëluftëtarët e tij, mendojnë që duhet të bëhet edhe një konkurs, për një shtatore tjetër, ne do ta bëjmë atë me shpenzime tona.



## Aksident në Pejë

Pejë, 29 korrik- Të dielën rreth orës 11, në rrugën Prishtinë-Pejë, në udhëkryqin për në Vitomiricë - Rozhajë, ka ndodhur një aksident komunikacionin, në të cilin janë përfshirë një autoambulancë dhe tri vetura të tjera. Sipas policisë së Kosovës, e cila ka dal në vendin e ngjarjes, në këtë aksident ka një të lënduar lehtë, ndërsa dëmet materiale janë të konsiderueshme.

## Veterani bëhet me shtëpi

Prishtinë, 29 korrik- Është bërë me shtëpi të re familja 5 anëtarëshe e ish-veteranit të luftës dhe komandantit të Stacionit policor 'Qendra' në Prishtinë, Xhevdet Sinanaj i cili vdiq para dy vjetësh nga një sulm në zemër. Shtëpia e ndërtuar në Isniq të Deçanit është donacion i Shoqatës humanitare "Sali Çekaj" me seli në Zvicër. Shtëpia e re me sipërfaqe 80 metra katror ka kushtuar rreth 15 mijë euro. Vetëm gjatë dy viteve të fundit kjo shoqatë ka ndërtuar 6 shtëpi për familjet me nevojë. Drejtuesit e kësaj shoqate të cilët po qëndrojnë këto ditë për pushime u zotuan se do të vazhdojnë ndihmat për ato familje të cilat edhe 13 vjet pas luftës kanë mbetur pa kulm mbi kokë.

## Tërnava: Kujdesuni për shqiptarët në Damask

Prishtinë 29 korrik- Myftiu i Kosovës, Naim Tërnava ka deklaruar se në Damask jetojnë mbi 10 mijë shqiptarë dhe kush nuk di për jetën dhe fatin e tyre. "Shfrytëzoi rastin që ta theksoj një informacion mjaft të rëndësishëm, me të cilin shumë pak merren mediat tona, por edhe qeveria jonë: sot në Damask gjenden mijëra e mijëra shqiptarë të pambrojtur", ka thënë myftiu Tërnava për "Presheva Jonë". "Në Damask kemi lagjen 'Muhaxheria' e pastaj atë të Arnautëve, të cilat janë të mbushura plot e përplot me shqiptarë të ikur nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia", ka thënë myftiu Tërnava.

»Azem Syla jep dorëheqje

# BLOKOHET I

Jo vetëm që kurrë nuk është mbledhur, por Komisioni për Verifikimin e Veteranëve, Invalidëve dhe Dëshmorëve të UÇK-së ka mbetur edhe pa kryetar. Deputeti Azem Syla, kreu i këtij organi, ka dhënë dorëheqje. Shkaqet e largimit i quan personale. Për këtë veprim të tij nuk dinë as anëtarët e Komisionit.

### Nexhmije Ahmeti

nexhmije.ahmeti@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 29 KORRIK — Azem Syla, deputet i Kuvendit të Kosovës, nuk është më personi që do të vendosë se kush ishte e kush jo, ushtar i UÇK-së.

Ish-komandanti përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk është më kryetar i Komisionit Shtetëror për Verifikimin e Veteranëve, Invalidëve dhe Dëshmorëve të UÇK-së.

Ai ka dhënë dorëheqje nga kjo detyrë ndonëse nuk dihet se prej cilës kohë e ka bërë një veprim të tillë.

Faktin se nuk është më kryetar i këtij Komisioni, e ka bërë të ditur vetë Syla, në një deklaram të shkurtër për Express.

"Kam dhënë dorëheqje. Nuk jam më kryetar i komisionit", tha Syla, duke mos dhënë asnjë arsye përse e ka bërë këtë.

Si kryetar i këtij Komisioni, Syla ishte emëruar nga Qeveria e Kosovës.

"Është çështje personale imja", tha deputeti Syla, kur u pyet përse ka ndërmarrë një veprim të tillë.

Dorëheqja e Sylës nga kjo detyrë vetëm sa e ka shtyrë punën e Komisionit, i cille dhe ashtu është mjaft i vonuar.

Komisioni Qeveritar që ishte formuar në janar të këtij viti, deri



më tani nuk ka bërë asgjë në verifikimin e atyre që ishin në luftë dhe u plagosën.

Ky Komision asnjëherë nuk ka mbajtur as edhe një mbledhje të vetme. Së paku jo zyrtarisht.

Kjo zvarritje i ka shtyrë edhe përfaqësuesit e veteranëve që të jenë të pakënaqur.

Sipas tyre, është faji i udhëheqësit të Komisionit, në këtë rast Azem Sylës, që nuk ky organ nuk ka dalë me shifra për veteranë.

E kjo, kanë sqaruar ata, ka bërë që veteranët të mos futen fare në Ligjin për vlerat e luftës.

Kreu i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Muharrem Xhemajli, i cili është njëri prej anëtarëve të këtij komisioni, akuzoi ditë më parë kreun e Komisionit Azem Sylën, se nuk është i interesuar t'i seleksionojë veteranët.

"Ata që frynë numrin e veteranëve, po e mbajnë peng edhe seleksionimin e tyre", është shprehur më herët për media kreu i veteranëve të UÇK-së.

Me këtë rast, Xhemajli kishte thënë se Azem Syla u ka dhënë kartela edhe atyre që nuk luftuan fare.

Kreu i veteranëve konfirmon se në organizatën e tij zyrtarisht janë 22 mijë veteranë.

I kontaktuar të dielën nga Express, Muharrem Xhemajli tha se durimit të tyre do t'i vijë fundi, nëse deri në shtator, Komisioni për Verifikimin e Veteranëve dhe Komisioni për amendamentimin e Ligjit për Vlerat e Luftës, nuk i kryejnë punët e tyre.

"I kemi paralajmëruar edhe Komisionin për Verifikimin e Veteranëve, Invalidëve dhe Dëshmorëve dhe Komisionin për Amendamentimin e Ligjit



## Shumë lypës

Prishtinë, 29 korrik - Numri i shumtë i fëmijëve të cilët kërkojnë lëmshë është brengë për shoqërinë tonë, thonë qytetarët. Fëmijët arsyetohen se mungesa e kushteve elementare për jetë i detyron ata të zhvillojnë këtë veprimtari. Viteve të

fundit vërehet rritje numrit të personave të cilët tërë ditën e kalojnë në rrugë ose kafene duke kërkuar lëmshë. Njëri nga fëmijët që çdo ditë e ushtron këtë veprimtari tregon arsyen. Ai thotë se po lyp para për bukë. Një situatë e tillë është shqetë-

suese dhe nga ta është vështrë edhe të drekohet, thotë Drita Berisha, banore e Prishtinës. "Me të vërtetë jo një kafe po fare pa pi asgjë, na duket se diçka po na ngulfat frymën në fyt për shkak të soditjes se këtyre fëmijëve nëpër rrugë", thekson ajo.

Ndërsa, të rriturit që kërkojnë lëmshë, jo që kanë frikë nga Policia e Kosovës, por ata kanë një hall tjetër. Kjo veprimtari është e njohur edhe për zyrtarë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. "Kjo është një ndër format që me të

vërtet është shumë shqetësuese kohëve të fundit. Unë e kamë ngritë këtë çështje edhe e them prapë është formë shqetësuese që është duke marrë përmasa të kësaj kategorie", thekson për Blue Sky, Behxhet Gaxhiqi, këshilltar i ministrit.

# KOMISIONI



### Përbërja e Komisionit:

Përbërja e Komisionit që nga formimi ishte kryetar Azem Sylja nga ish-Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së (tash i dorëhequr), Faik Fazliu, përfaqësues i veteranëve nga Zyra e Kryeministrit, Fadil Rracaj nga Ministria e Punës, Jahir Demaku nga Ministria e FSK-së, Sami Lushtaku nga Zona e Drenicës, Sadik Halitjaha nga Zona e Pashtrikut, Shkumbin Demaliaj nga Zona e Dukagjinit, Rrahman Rama nga Zona e Shalës, Çele Gashi nga Zona e Llapit, Shukri Buja nga Zona e Nerodimes, Ahmet Isufi nga Zona e Karadakut, Avdi Rraci nga ish-Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së, Muharrem Xhemajli nga Organizata e Veteranëve të Luftës, Xhavit Jashari nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve, Fadil Shurdhaj nga Shoqata e Invalidëve dhe Rrustem Berisha nga ish-Ministria e Mbrojtjes.

t'i përfundojë listat e veteranëve, invalidëve dhe të dëshmorëve të rënë gjatë luftës së UÇK-së.

Komisioni fillimisht ka pasur për detyrë ta hartojë rregulloren e punës gjë që ende nuk e ka bërë e pastaj t'i përcaktojë kriteret e klasifikimit të këtyre kategorive (dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve).

Pjesëmarrës në Komision janë ish-përfaqësuesit e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së nga të gjitha zonat e UÇK-së, ish-përfaqësuesi i Shtabit të TMK-së, përfaqësuesi i Zyrës për Veteranët e Luftës së UÇK-së, të Zyrës së Kryeministrit si dhe përfaqësuesit e tri Shoqatave të Dala nga Lufta: Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe Organizatat të Veteranëve të Luftës së UÇK-së.

Krijimi i këtij Komisioni ishte parë e arsyeshme pasi që pas luftës në Kosovë listat e atyre që supozohet se kanë qenë pjesë e UÇK-së është dyfishuar sa raportohet të kenë qenë me të vërtetë pjesë e kësaj ushtrie.

për vlerat e Luftës së UÇK-së se do të presim deri në shtator. E nëse nuk fillojnë të punojnë dhe të bëjnë zgjidhje, organizata e veteranëve, në krye me mua, do t'i marrë të gjitha masat për mbrojtjen e interesave, përfshirë këtu protestat, demonstratat dhe format e tjera të shprehjes së pakënaqësisë", tha Xhemajli.

Sa për punën e Komisionit për Verifikim të Veteranëve, organizatat e UÇK-së lirisht mund të reagojnë.

Ky komision tek në shtator do të fillojë punën në terren për verifikim, procedurë e cila pritet

të marrë kohë të gjatë.

Krejt kjo, me një problem shtesë. Me dorëheqjen e Azem Sylës.

Njëri nga anëtarët e këtij Komisioni është edhe Faik Fazliu. Ai të dielën tha për Express se Komisioni do të mblidhet para shtatorit, për ta miratuar rregulloren e tij në mënyrë që në shtator të fillojë punën.

"Në shtator do të fillojmë", tha Fazliu, pa mundur të sqarojë arsyet pse komisioni nuk ka filluar më herët punën.

Sido që të jetë, qëllimi i komisionit është që t'i verifikojë dhe



## Shmangni Serbinë

Sërish bashkatdhetarët kanë probleme në kufirin me Serbinë. Autoritetet e shtetit serb kanë krijuar radhë të gjata duke mos punuar. Autoritetet kosovare u sugjerojnë mërgimtarëve që të përdorin pikat e tjera kufitare për ardhje ose largim.

### Express

Prishtinë, 29 korrik - Diaspora kosovare nuk kërkon koncerte, por lehtësi të ndryshme të cilat do t'ua bënin ardhjen më të lehtë në Kosovë.

Ata kanë probleme në kufijtë e Kosovës, dhe të shumë shteteve të tjera nëse duan të sjellin diçka në atdhe. Ministria e Diasporës ka organizuar mjaft aktivitete e koncerte për mërgimtarët gjatë qëndrimit të tyre në vendlindje.

Por duket se ata nuk janë shumë të kënaqur.

Një pjesë e tyre, të mllafosur me radhët e gjata që po krijohen nëpër pikat kufitare, thonë se më mirë do të ishte që në vend të manifestimeve t'u krijohen lehtësira nëpër pika kufitare dhe t'u hiqen taksat që ata paguajnë me të hyrë në atdhe.

Me këtë problem u përballën shumë mërgimtarë të dielën.

Radhët e gjata në kufirin Kosovë-Serbi dhe anasjelltas, u kanë shkaktuar shumë probleme.

Policia e Kosovës ka njoftuar Departamenti i Policisë Kufitare, saktësisht zyrtarët policore

të pikëkalimit kufitar Merdare, kanë informuar se gjatë 24 orëve të fundit, janë krijuar kolona dhe pritje të gjata si në hyrje për në Republikën e Kosovës ashtu edhe në dalje për në Serbi.

"Pritjet janë duke u bërë me orë të tëra nga të dyja anët, edhe pse nga Kosova për në Serbi, në territorin tonë kolonat janë të gjata diku nga 500-700 metra, mirëpo pritjet janë me orë të tëra, ndërsa në hyrje sipas qytetarëve kolonat janë me kilometra të gjata", kanë sqaruar autoritetet kosovare.

Sipas tyre, në bazë të informacioneve jozyrtare të pranuar nga qytetarët, e gjithë kjo pritje bëhet nga neglizhenca dhe mospuna e autoriteteve serbe.

"Policia e Kosovës u sugjeron të gjithë qytetarëve që të shfrytëzojnë pikëkalimet e tjera kufitare me qëllim të shmanges së pritjeve të gjata në kolona të krijuara në këtë pikëkalim kufitar", thuhet në njoftimin zyrtar, sipas të cilit, në pikëkalimet e tjera kufitare, qarkullimi është duke u zhvilluar normalisht, pa pritje të gjata.

# Ekonomi

Redaktor: Arben Hyseni  
e-mail: arben.hyseni@gazetaexpress.com  
tel: 038 76 76 76 fax: 038 76 76 78

## Varfëria zvogëlohet më 2030

Kolorado, 29 korrik–Varfëria në botë do të reduktohet ndjeshëm prej vitit 2030, ka vlerësuar Këshilli Informativ Kombëtar i SHBA-së, në një raport që është publikuar sot në forumin e sigurisë në Aspen të Colorados. Analiza parashikon rritjen e klasës së mesme në dy mi-

liardë njerëz, të cilët do të kërkojnë më shumë të drejta dhe burime. Kryetari i Këshillit, Christopher Kojm ka vlerësuar se numri i njerëzve që jetojnë me më pak se një dollar në ditë momentalisht është një miliard, por se ky numër do të përgjysmohet në dy dekadat e

ardhshme, nëse vazhdojnë trendet momentale ekonomike dhe demokratike. Kojm thotë se kapacitetet e fuqishme ekonomike të vendeve si India, Indonezia dhe Vietnam, janë bartësit e këtij trendi, i cili do të vazhdojë pavarësisht nga trendet aktualë në ekonominë globale.



FOTO: PETRIT BRAHMANI

## Lirojini pronat

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka kërkuar nga misionet ndërkombëtare, EULEX dhe UNMIK për të liruar pronat shoqërore që këto misione po i shfrytëzojnë aktualisht. Agjencia konsideron se shfrytëzimi i këtyre pronave po pengon procesin e privatizimit.

PRISHTINË, 29 KORRIK —

Prania e EULEX-it dhe UNMIK-ut nuk po duket aq e dobishme për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Shfrytëzimi i pronave shoqërore nga misionet ndërkombëtare ka filluar t'i nxjerrë telashe agjencisë që po udhëheq shitjen e aseteve shtetërore.

Deri më tani, çështjen e uzurpimit Agjencia ua ka lënë ta zgjidhin vetë blerësve në konteste private. Por, tani rastet e ndërmarreve që janë në shfrytëzim nga misionet ndërkombëtare po bëjnë që AKP-ja të mos mund të hedhë në shitje pa probleme ndonjërin prej tyre. Po ashtu, blerësit kanë filluar t'i kërkojnë kushte veçanta AKP-së.

Zëdhënësi i AKP-së, Ili Kaloshi thotë se i janë drejtuar sërish EULEX-it dhe UNMIK-ut për të kërkuar lirimin e disa prej pronave.

“Ne i kemi shkruar EULEX-it për të liruar disa nga pronat që planifikohen të privatizohen. Njëjtë edhe për qiranë e objekteve që shfrytëzohen, por EULEX-i na është përgjigjur se si mision janë në kuadër të rezolutës 2 44 dhe se për këtë duhet të drejtohen në UNMIK. Ne i kemi drejtuar së fundi edhe UNMIK-ut, por nuk kemi marrë përgjigje”, ka thënë Kaloshi për Radio Kosovën.

EULEX-i nuk ka dhënë përgjigje rreth kërkesës së Agjencisë së Privatizimit.

Ndërsa UNMIK –u përmes zëdhënëses Andrea oung ka shpjeguar se për shfrytëzimin e këtyre pronave ka një marrëveshje që nga viti 2006.

“UNMIK-u do të vazhdojë të përdorë atë që misioni e konsideron të nevojshme për vete, siç është rasti me EULEX-in. Në këtë drejtim, të drejtat e vazhdueshme të UNMIK-ut kanë qenë në vazhdimësi të pranuar duke përfshirë një marrëveshje me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në vitin 2006, detyrimet ndaj së cilës vazhdojnë të jenë në vend edhe në AKP”, ka thënë oung për Radio Kosovën.

Por Agjencia Kosova e Privatizimit sipas Kaloshit po kërkon që pronat që planifikohen të hidhen tash e tutje në privatizim, të lirohen. Aktualisht të dyja misionet, EULEX-i dhe UNMIK-u, kanë në shfrytëzim pa qira tri prona në komunën e Prishtinës: N.SH Amortizatorët, NSH Mekanizimi dhe NSH Përparimi. Në Prizren, NSH Farmakosi dhe Njësia e prodhimit (Ndërtesa e Kaltër), në Pejë NSH “Dukagjini-remonti” dhe ndërmarrjen Agrikultura në Gjilan.



FOTO: PETRIT BRAHMANI

## Nisen për

Ministria e Infrastrukturës ka hapur procedurat e tenderimit për autostradën e dytë - Prishtinë-Shkup. Këshilltari Lah Nitaj thotë se dhjetëra kompani vendore e ndërkombëtare tashmë veç kanë shprehur interesim. Përzgjedhja e kompanisë fituese bëhet brenda këtij viti, kurse ndërtimi nis më 2013.

PRISHTINË, 29 KORRIK —

Ende pa u kryer autostrada Vërmicë-Merdar, Qeveria e Kosovës ka nisur procedurat për ndërtimin e një autostrade të dytë.

Ministria e Infrastrukturës ka hapur tashmë procedurat e tenderimit për autostradën Prishtinë-Hani i Elezit.

Në fazën e parë tenderuese, atë të shprehjes se interesit, dhjetëra kompani private vendore dhe ndërkombëtare tashmë veç kanë shprehur interesimin

për ndërtimin e kësaj autostrade, që pritet të nisë në fillim të vitit të ardhshëm.

Lah Nitaj, këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës, thotë se shprehja e interesit do të jetë e hapur deri në javën e parë të muajit gusht dhe shpresohet që gjatë kësaj periudhe të ketë më tepër kompani të interesuara me renome ndërkombëtare.

Por, Nitaj nuk tregon ndonjë periudhë të saktë kohore se kur do të shpallet kompania fituese,

por premtën se kompani fituese do të shpallet ajo që plotëson kushtet, kriteret, parametrat dhe çmimin.

“Pas konsultimeve që kemi pasur me mekanizmat ndërkombëtarë dhe akterët qeveritarë, akordimin me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ankën otërore, ne presim që proceset tenderuese dhe deri tek arrija e kontratës me operatorë të caktuar ekonomikë, të përfundojnë brenda vitit 2012”, ka

## Mirë me borxh

Prishtinë, 29 korrik – Kosova ka nivel mjaft të ulët të borxhit të jashtëm krahasuar me vendet e Eurozonës, vetëm rreth 7 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Zyrtarët e Bankës Qendrore thonë se Kosova është shtet i ri dhe ky borxh mund të rritet

në të ardhmen. Kurse njohësit e çështjeve ekonomike thonë se niveli i borxhit të jashtëm duhet të jetë në përputhje me nivelin e zhvillimit ekonomik. Ndër indikatorët më pozitiv të Kosovës është rritja ekonomike dhe niveli i ulët i borxhit të jas-

tëm. Bedri Zymeri, udhëheqës i Divizionit të Bilancit të Pagesave në BQK, tha për Radio Kosovën se pikërisht borxhi i jashtëm dhe rënia e besimit të bizneseve janë faktorët kyç që po ndikojnë negativisht në ekonominë e vendeve të Eurozonës. Por sipas

tij, Kosova është shtet i ri dhe niveli i borxhit mund të rritet. "Borxhi i jashtëm i Kosovës është i ulët krahasuar me vendet e Eurozonës. Borxhi i jashtëm është rreth 7 për qind ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto, mirëpo duhet ta kemi parasysh

se Kosova është një shtet i ri dhe borxhit shkojnë duke u shtuar në të ardhmen", theksoi Zymeri. Borxhi i jashtëm bruto në fund të tremujorit të parë të këtij viti ka qenë 1.3 miliard euro, përafërsisht rreth 30 për qind e Prodhimit të Brendshëm Bruto.



“kon. i ek. r. kn. n.ërko. ë. r.ë. h. k. r.ë. r. i. r.ë. k. o. r. i. n. o. n. i. n. o. n. r. ë. r. k. o. ë. r. h. n. k. ë. n. o. ë. r. o. r. n. r. i. ë. r. o. n. r. h. r. i. k. r. i. k. o. n. r. ë. o. r. o. r. ë. k. r. k. o. n. o. i. k. ë. ë. ë. r. n. o. n. ë. r. n. i. i. 2012”

ah i a

# Shkup

thënë Nitaj për Radion Europa e Lirë. Ai shton se sipas kësaj dinamike të përcaktuar, planifikohet që në pjesën e parë, me krijimin e rrethanave dhe kushteve të motit, të fillojnë me punimet e para. "Shpresojmë të jetë kuarti i parë i vitit 2013", bën të ditur Nitaj.

Ekspertë të ndërtimit konsiderojnë se ndërtimi i infrastrukturës rrugore viteve të fundit ndikon në bashkëpunimin më të lehtë edhe në aspektin ekonomik me vendet e rajonit.

Megjithatë, Florim Graçevci, profesor në Fakultetin e Ndërtimit dhe të Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës, thotë se autoritetet kompetente duhet të kenë kujdes në përzgjedhjen e kompanisë fituese, pasi nga ajo varet edhe cilësia e autostradës Prishtinë - Hani i Elezit, e quaj-

tur Rruga 6. "Kush do të donte t'i hynte kësaj pune, kompania duhet të përgjigjet për projektimin, hartimin e projektit ose kërkesat që janë në projekt shumë më përpara të specifikuar dhe ato duhet të respektohen në maksimum. Prandaj, kompanitë në këto situata duhet të jenë shumë të kujdesshme në caktimin e çmimit, dhe çmimi duhet të jetë fiks, të mos ketë variacione, të mos të ketë punë dhe aktivitet shtesë, përveç atyre që janë paraparë përmes projektit", konsideron Graçevci.

Ndërkaq, sa i përket asaj se si do të financohet ndërtimi i kësaj autostrade dhe sa do të kushtojë, këshilltari Nitaj thotë se autoritetet kompetente vendore janë në kontakte të vazhdueshme me institucione të ndryshme

financiare ndërkombëtare që të gjejnë mënyra për financimin e autostradës së dytë në vend.

"Janë shumë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm që të kenë parasysh interesin e Kosovës, interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe të mos rrezikojnë në asnjë moment parametrat financiarë të vendit", thekson Nitaj.

Ndryshe, projekti për realizimin e autostradës Prishtinë-Shkup është prezantuar në vitin 2010. Sipas projektit të prezantuar, autostrada do të ndërtohet në një trase tërësisht të re, me gjatësi prej 55 kilometrash. Autostrada do të ketë dy tunele, ndërsa më i gjati do të jetë ai i Kaçanikut, me 2.2 kilometra.

Shpejtësia maksimale në autostradë, sipas projektit, do të jetë 20 kilometra në orë.

## Express ekonomi

### Shkëmbim

Valuta	\$	€	£
\$			
€			
£			

### Lajme

#### Mendojnë për investitorët

Prishtinë, 29 korrik – Agjencia për Promovim të Investimeve synon t'i stimulojë investitorët përmes pushimit të taksave për një periudhë të caktuar. Një raport për këtë tashmë i është dërguar Ministrisë së Financave dhe shumë shpejt pritet një takim për këtë çështje. Rënia e investimeve vitet e fundit ka bërë që Agjencia për Promovim të Investimeve të mendojë për mënyrat e stimulimit të investitorëve. Kryeshefi i Agjencisë, Valdrin Lluka dëshiron të përfitojë nga përvojat e mira të rajonit. Ai



thotë se në Maqedoni ka stimulumet direkte financiare nga ana e shtetit në investimet private në masën deri në 100 për qind, kurse në Serbi ka stimulumet për investitorë deri në 9 mijë euro për një vend pune.

#### Ndryshohet Ligji i punës



Prishtinë, 29 korrik – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka

filluar parapërgatitjet për identifikimin e të gjitha dispozitave të Ligjit të punës, të cilat do të ndryshohen dhe plotësohen. Ndryshimet në këtë ligj kanë ardhur pas reagimeve të përfaqësuesve të biznesit se ky ligj është i paqartë dhe i vështirë për ta zbatuar në Kosovë. Pushimet e gjata mjekësore, pushimi i lehonisë, ditë të shumta pushimi gjatë festave, cilësohen se janë vetëm disa nga arsyet kryesore që punëdhënësit nuk arrijnë ta zbatojnë Ligjin e punës.

#### Bashkë për Eurozonën

Berlin, 29 korrik – Gjermania dhe Franca janë të vendosura të bëjnë gjithë ka për të mbrojtur Eurozonën, deklaruan dje kancelarja gjermane, Angela Merkel dhe presidenti francez, François Hollande në një komunikatë të përbashkët për shtyp. Dy liderët e Bashkimit Evropian kanë rikonfirmuar se ruajtja e monedhës së përbashkët është një prioritet i bllokut të 2 vendeve. Deklarata mbështetëse e Merkelit dhe Hollandit ndihmoi gjithashtu për të



rritur, për qind vlerën e euros në këmbimin me dollarin gjatë ditës. Në tregjet ndërkombëtare një euro u shkëmbye me 1.22 dollar.

# Bota

REDAKTOR: ARSIM BUXHOVI  
E-MAIL: ARSIM.BUXHOVI@GAZETAEXPRESS.COM  
TEL: 038 76 76 76 FAX: 038 76 76 78

## Informata të reja për sulmin kundër anijes USS Cole

11 muaj para sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 kundër Shteteve të Bashkuara, persona vetëvrasës të Al-Qaidës sulmuan një anije të forcave amerikane të marinës, që ishte ankoruar në portin e Adenit në Jemen, duke vrarë 17 marinarë dhe plagosur dhjetëra të tjerë. Në një libër të ri, komandanti i anijes thotë se përgjigja e Amerikës ndaj këtij

sulmi ka qenë shumë e dobët, me gjithë se incidenti mund të shihej si një sinjal paralajmërues për sulmet e ardhshme. Më 12 tetor 2000, anija USS Cole, e drejtuar nga komandanti Kirk Lippold, ishte duke u furnizuar me karburant gjatë një ndalesë rutinë në portin e Adenit. Komandanti i cili tani është në pension ka shkruar një libër me titull, Al Qaida's

Attack on the USS Cole. Libri përshkruan në hollësi dëmet që janë shkaktuar nga shpërthimi, përgjigjen heroike të ekuipazhit për të shpëtuar anijen nga mbytja, dhe gjetjen e trupave të marinarëve të vrarë. Lippold është kritik për faktin se Shtetet e Bashkuara nuk u përgjigjën ushtarakisht ndaj sulmit kundër USS Cole.

## Obama me plan për të sulmuar Iranin?



Këshilltari për siguri kombëtare i presidentit të SHBA-së, Barack Obama, ka informuar kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu, rreth planit të mundshëm për të sulmuar Iranin. Tom Donilon theksoi se kjo do të ndodhë, nëse dështojnë përpjekjet diplomatike për të ndaluar ambicjet bërthamore të Iranit, ka njoftuar gazeta izraelite, "Haaretz". Gazeta thotë se plani është shpalosur gjatë vizitës së

Donilonit në Izrael këtë muaj.

Një zyrtar i lartë izraelit mohoi se Donilon ka njoftuar Netanyahu për planin rezervë për sulme kundër Iranit. "Asgjë në këtë artikull nuk është e saktë. Donilon nuk është takuar me Netanyahu për darkë, nuk ka biseduar me të në katër sy, e as që ka paraqitur para tij plane operative për sulm kundër Iranit, i tha agjencisë së lajmeve Reuters ky zyrtar izraelit, i cili deshi të mbetet anonim.

## Romney në Izrael

Kandidati republikan për president, Mitt Romney, filloi vizitën 36-orëshe në Izrael, gjatë së cilës do të zhvillojë bisedime me udhëheqësit izraelitë dhe palestinezë.

Romney pritet të takohet me kryeministrin izraelit, Benjamin Netanyahu, presidentin Shimon Peres dhe politikanët e opozitës, si dhe kryeministrin palestinez, Salam Fajad.

Kandidati presidencial, i cili mbërriti në Izrael të shtunën në mbrëmje, gjithashtu do të organizojë mbledhjen e fondeve në Jerusalem të hënën, para se të nisët për Poloni, që është



ndalesa e tretë dhe e fundit në turneun e tij, i cili filloi me një vizitë në Britani.

Romney, që po sfidon presidentin demokrat Barack Obama në zgjedhjet e nëntorit, shpreson se udhëtimi do të rritë kredencialin e tij për të drejtuar sigurinë kombëtare dhe diplomacinë e SHBA-së.

## Opozita siriane kërkon proces kundër Assadit

Grupi opozitar në mërgim, Këshilli Kombëtar sirian, u kërkoi vendeve të tjera të armatosin luftëtarët kryengritës. Kreu i tij, Abdulsamet Sayda, tha se në vend që t'i ofrohet azil, presidenti Bashar al Assad duhet gjykur për masakrat e kryera në Siri.

"Duam armë që të ndalojmë tanket dhe aeroplanët luftarak të Assadit, këtë kërkojmë ne!", citohej të ketë thënë ai gjatë një konference për shtyp në Abu Dhabi.

Bashkë me këtë kërkesë erdhi dhe thirrja drejtuar të gjithë vëllezërve dhe miqve arabë, ush tha ai, për të mbështetur ushtrinë e lirë siriane. Deri më tani, kryengritësit në Siri nuk kanë marrë ndonjë ndihmë us-



htarake nga jashtë, të paktën jo në mënyrë të hapur.

Në ndërkohë luftime të ashpër janë raportuar për të dytën ditë me radhë në qytetin sirian të Aleppo derisa trupat qeveritare dhe forcat kryengritëse po luftojnë për të marrë nën kontroll kryeqytetin tregtar të vendit.

Aktivistët kanë shprehur frikën se shumë civilë në qytetin prej 2.5 milionë banorësh mund të jenë plagosur apo vrarë.

## Misioni Mars One synon të ndërtojë komunitetin e parë njerëzor në hapësirë. Biznesmeni holandez 35 vjeçar, Bas Lansdorp, është themeluesi i sipërmarrjes hapësinore. Ai financoi projektin Mars One përmes shitjes së aksioneve që kishte në kompaninë energjetike me erë. Ai thotë se vajtja në Mars ka qenë një ëndërr e hershme për të, ndërkohë që arriti në përfundimin se mund të përdorte publicitetin e medias, për të krijuar të ardhura për financimin e projektit.

Qyteti holandez Noordwijk nuk njihet si qendër e fluturimeve hapësinore, por kjo do të ndryshojë në vitin 2023, kur një anije hapësinore do të nisët drejt planetit Mars. Kompania Mars One, ka në plan të ndërtojë koloninë e parë njerëzore në Planetin e Kuq brenda 11 vitesh. Fillimisht do të jenë katër astronautë që do të nisin kolonizimin e Marsit dhe pastaj çdo dy vite, kolonisë do t'u shtohen nga katër njerëz të tjerë.

Ky projekt ka pushtuar imagjinatën e të pasionuarve për hapësirën dhe teknologjinë. Faza e parë e operacionit do të fillojë në vitin 2016, me dërgimin në hapësirë të një sateliti telekomunikacioni dhe një kapsule banimi prej 5 metrash. Dy vite më pas, misioni do të dërgojë në Mars një automjet robot, për të gjetur vendin më të mirë për vendosjen e kolonisë.

Viti 2020 do të shënojë dërgimin në Planetin e Kuq të infrastrukturës teknologjike dhe të komunikimit. Pajisjet e nevojshme për të jetuar në Mars do të dërgohen në vitin 2020.

Sapo të sigurohet jeta në atë planet, mjeti hapësinor Mars One do të nisët drejt Marsit në vitin 2022, për të mos u kthyer më në Tokë. Ekipi prej katër njerëzish do të arrijë një vit më vonë dhe nuk do të kthehet më. Ekipi holandez

# PUSHTIM



thotë se nuk ka aftësitë për të ndërtuar një raketë të aftë për t'u rikthyer në tokë.

Misioni Mars One synon të ndërtojë komunitetin e parë njerëzor në hapësirë. Biznesmeni holandez 35 vjeçar, Bas Lansdorp, është themeluesi i sipërmarrjes hapësinore. Ai financoi projektin Mars One përmes shitjes së aksioneve që kishte në kompaninë energjetike me erë.

Ai thotë se vajtja në Mars ka qenë një ëndërr e hershme për të, ndërkohë që arriti në përfundimin se mund të përdorte publicitetin e medias, për të krijuar të ardhura për financimin e projektit.

"Është ëndërra ime 15 vjeçare

për të shkruar në Mars. Marsi më tërheq. Është një planet interesant me shkretëtira, male, fusha. Është një planet i bukur. Një mik më dha idenë e financimit të misionit njerëzor në Mars, përmes krijimit të një spektakli nga media", theksoi Lansdorp.

Ekipi i tij, në konsultim me kompani të rëndësishme që furnizojnë ushtrinë për misionet hapësinore, thotë se projekti i jetës në Mars mund të realizohet me teknologjinë ekzistuese. Lansdorp thotë se kjo ndërmarrje mund të kushtojë rreth 6 miliardë dollarë.

"Tingëllon si një shumë e madhe parash, por ne kemi në plan që të jemi të pranishëm në

## Ushtria e Turqisë nën vëzhgimin e qeverisë

Në Turqi, Partia për Drejtësi dhe Zhvillim që është në pushtet, e ka detyruar ushtrinë, dikur një institucion i fuqishëm, të përqendrohet te detyrat e saj ushtarake dhe të qëndrojtë jashtë jetës politike të vendit.

Të Turqit në se ble një çokolatë,

sigurim, shtëpi, apo makinë, në një fare mënyre kjo lidhet me Fondin e Ndihmës dhe pensioneëve i Forcave të Armatosura Turke. Eksperti i ushtrisë, Lale Kemal, shef i zyrës së Ankarasë për gazetën Taraf, thotë se kjo praktikë

është një mbetje e sundimit të vendit nga ushtria në të kaluarën. "Ushtria mbetet një institucion i çuditshëm, që nuk i jep llogari askujt. Një lloj si në kohët e shkuara, kur vendet e Amerikës Latine, apo Kina, a Egjipti, nuk kishin lidhje fare me sundimin e ligjit, apo

demokracinë", tha Kemal. Por bizneset e OYAK-ut tani po ndiqen me vëmendje të veçantë. Muajin e kaluar, zëdhënësi i Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim, Husein Çelik, bëri të njohur se Parlamenti do të hetojë ekzistencën dhe funksionin e fondit të pensioneëve.

Nën sundimin e Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim, një e pesta e gjeneralëve të vendit dërgjen në burg, ose presin të zhvillohet gjyqi ndaj tyre, nën akuzat për komplete. Hetimet e paprecedent e kanë nxjerrë ushtrinë jashtë arenës politike.

# MI I MARSIT



media, në mënyrë që gjithçka që bëjmë të shihet nga e gjithë bota. Jo vetëm suksesi, por edhe dështimet. Njerëzit do të shohin nga afër përvojat e astronautëve në Mars", shtoi ai.

Ekspozimi ndaj rrezatimit do të jetë një çështje e mprehtë për banorët e Marsit. Dërgimi i një mbrojtësi nga rrezatimi, që është e lehtë për transportim në Mars dhe e fuqishme sa duhet për të mbrojtur njerëzit nga efektet e rrezatimit, është një sfidë logjistike për ekipin Mars One.

Shkencëtari Bernard Foing në Agjencinë Evropiane të Hapësirës dhe ekspert i njohur për Hënë dhe Marsin, thotë se megjithëse

është gjetur ujë akullnash në Mars, gjetja e burimeve ujore për nevojat njerëzore mund të jetë problematike.

"Marsi është më i vogël se toka dhe ende nuk mund të ruajë atmosferën si planeti ynë. Besojmë se Marsi është shumë i thatë dhe i ftohtë. Tani nuk shohim shumë ujë, por kemi gjetur disa zona që tregojnë se ka pasur sipërfaqe ujore, ndoshta disa lumenj e liqene dhe kemi gjetur ujë akullnash në Mars", theksoi Foing.

NASA dhe Agjencia Evropiane e Hapësirës kanë zbuluar kohët e fundit atë që duket të jetë ujë akullnash, por duhen bërë më

shumë kërkime thotë, Foing. Ai thotë se hapi gjigant për eksplorimin të hapësirës mesa duket do të jetë në Planetin e Kuq.

Nërkohë, sipërmarrësi Landsorp thotë se ka marrë qindra aplikime nga njerëzit që duan të jetojnë në Mars, që nga bërja publike e misionit në Mars në maj të këtij viti.

Pavarësisht entuziazmit mbi mundësinë e jetës në Mars, realiteti i jetës në kapsulë do të jetë një krejt ndryshe: me hapësirë të kufizuar për të lëvizur, shumë drita kontrolli dhe njerëz të paktë për të komunikuar, pa përmendur çështjet shëndetësore.

(VOA)

## 90 të vdekur nga vërshimet në Korenë e Veriut



Shirat e rrëmbyeshëm dhe vërshimet e shkaktuara nga tajfuni kanë vrarë afër 90 njerëz në Korenë e Veriut dhe i ka lënë pa strehë më shumë se 60 mijë persona.

Agjencia zyrtare e lajmeve e Koresë Veriore raportoi se tajfuni Khanun ka shkaktuar "humbje të mëdha njerëzore dhe materiale" kur e përfshiu vendin këtë javë, duke shkatërruar ose përmbytur më shumë se 17

mijë ndërtesa dhe duke fshirë rreth 30 mijë hektarë të tokës bujqësore.

Vërshimet që erdhën pas një thatësie të egër, pritet ta përkëqësojnë mungesën kronike të ushqimit në Korenë e Veriut.

SHBA tha në muajin e kaluar se dy nga tre njerëz në Korenë e Veriut, ose një total prej 16 milionë njerëzish, vuajnë nga mosushqimi dhe mungesa e sigurimit të ushqimit.

## Shpërthim i Ebolës në Ugandë, 13 të vdekur

Shpërthimi i virusit vdekjeprurës Ebola ka lënë të vdekur 13 njerëz në Ugandë, derisa po bëhen përpjekje për të izoluar ethet hemorragjike, ka thënë Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Kundër Ebolës nuk ka trajtim mjekësor apo vaksinë.

Virusi përhapet nga kontakti i afërt dhe varësisht nga lloji,



mund të jetë vdekjeprurës për 90 për qind të njerëzve që infektohen me të.

## Kapet kryesuesi i kartelit "Los Zetas"

Qeveria meksikane ka arritur një rezultat të rëndësishëm në luftën kundër karteleve të drogës, pasi ka arrestuar një prej bosëve më të rrezikshëm të narko- trafikut.

Në pranga ka përfunduar Mauricio Guizar Cardenas, i njohur ndryshe me pseudonimin "El Amarillo" dhe i konsideruar si shefi i kartelit famëkeq, Los Zetas.

Në momentin e arrestimit personit në fjalë, i kapur në flagrancë në një hotel në lokalitetin jug-lindor të Pueblas, iu gjet një arsenal i vërtet armësh të rënda, mes të cilave granata dore dhe një raketahedhëse.

Cardenas operonte në shtetet Tabasko, Veracruz, Çiapas, Kampeçe dhe Kuintana Ro, pasi



kishte marrë komandën rajonale të kartelit në vitin 2011.

Los Zetas është një prej grupeve kriminale më të rrezikshme dhe më të dhunshme në Meksikë, që kontrollon një pjesë të mirë të kalimit të drogës nga Kolumbia në Shtetet e Bashkuara.

Dikur pjesë e kartelit të madh të Sinaloa, me detyrë vrasjet dhe zhvatjet, grupi u shkëput duke kërkuar pjesën e tij në aktivitetet e narko- trafikut.

# PROGRAMI I PËRZGJEDHUR DITOR I DIGITALB PËR 30 KORRIK 2012



**SLEVIN PAK KRIMINAL** ORA 19:00  
**REGJISORI:** Paul McGuigan  
**AKTORET:** Josh Hartnett, Bruce Willis, Morgan Freeman, Ben Kingsley etj.  
 Një i ri, gjendet rastësisht midis dy bandave kriminale, që mendojnë se është dikush tjetër. Do t'i duhet të vërtetojë shpejt identitetin e tij, përpara se një vrasës famëqëq me emrin Mr. Goodkat ta gjejë...



**VERIU DHE JUGU** ORA 19:30  
**Gjinia:** Mini - serial / Dramë - Romancë  
**Regjia:** David L. Wolper  
**Aktorët:** Patrick Swayze, James Read, Lesley-Anne Down, Wendy Kilbourne, David Caradine, Elizabeth Taylor, etj...  
 I vlerësuar me një seri çmimesh prestigjioze dhe nga një kast i jashtëzakonshëm aktorësh, për kënaqësinë dhe nostalgjinë e publikut shqiptar, Film Autor, sjell në ekran sagën e dy familjeve rivale gjatë Luftës Civile në Amerikë në mini-serialin e paharrueshëm Veriu dhe Jugu.



**RRETHESH** ÇDO DITË, ORA 12:30 DHE 19:30  
 Të mësosh duke u argëtuar... E ku ka më bukur. Si lindin tokë? Kur mbledh bimët e para? A ka ekzistojnë më Dinosaurët? Cfarë është graviteti e shumë pyetje të tjera. Xhaxhi Historiani, Xhaxhi Shkencëtari dhe Xhaxhi Marinari - do t'u japin përgjigje të gjitha pyetjeve që ju kenit...



**USHTARI UNIVERSAL 3: GJENERATA E RE** ORA 21:30  
**REGJIA:** John Hyams  
**AKTORET:** Jean-Claude Van Damme, Dolph Lundgren, Andrei Arlovski, Zahari Baharov, Garry Cooper, etj.  
 Me ndihmën e një teknologjie të vjedhur të përparuar, terroristët kanë krijuar ushtarin universal të gjeneratës së re, një makinë vrasëse e pandalshme. Ata kanë shtënë në dorë centralin bërthamor të Çernobilit duke u shndëruar në një kërcënim për të gjithë botën. I vetmi që mund t'i ndalë është Luc Deveraux, ushtari i vjetër universal. I cili do të riaktivizohet dhe ritrajnhet për një mision të fundit të pamundur...



**ARTURI** ORA 21:00  
**REGJIA:** Jason Winer  
**AKTORET:** Russell Brand, Helen Mirren, Greta Gerwig, Jennifer Garner, Luis Guzman, Nick Nolte, Geraldine James, etj...  
 Arturi, miliarderi i ri dhe i pandregshëm, gjithë jetën është mbështetur në dy gjëra për të ndrequr gabimet e tij: pasurinë e pafund dhe dadon Hobson. Por tani Arturi do të përballet me zgjedhjen më të madhe të jetës: të martohet me një femër të suksesshme të zgjedhur nga familja e tij, apo të qëndrojë me vajzën që dashuron dhe të humbasë gjithë pasurinë.



**TERAPIA E ZEMËRATËS** ORA 21:30  
**Aktorët:** Adam Sandler, Jack Nicholson  
 Një biznesmen gabimisht dënohet të ndjekë një program terapie për menaxhimin e ndjenjave të zemërimit, ku haset me një instruktor agresiv i vendosur t'ia nxijë jetën.



**MEDIUM** NGA E HËNA NË TË PRENTE, ORA 21:00  
**Krijues:** Glenn Gordon Caron  
**Aktorët:** Patricia Arquette, Jake Weber, Miguel Sandoval, Sofia Vassilieva, Maria Lark, etj...  
 Kandidat për 3 Globe të Artë dhe 17 çmime të tjera televizive. Bazuar në librin e hetueses psikologe, Allison DuBois. Një grua familjare, që gjithë jetën ka menduar se aftësia e saj për të folur me të vdekurit është një mallkim, vendos ta përdorë këtë dhunti për të zgjidhur vrasje e krime të ndryshme.



**NË KËRKIM TË ELBORADOS PJ. 7 DHE 8** ORA 20:00  
 Thesare të groposura, të humbura e të fundosura në thellësi të oqeanëve, kanë tërhequr mijëra gjathtarë thesaresh nga e gjithë bota, prej shekujsh. Një udhëtim në të shkuarën e largët, në vende ku koha duket se ka hamuar të lënë gjurmët e saj... Ekspedita të mbushura me emocione dhe aventura në kërkim të Eldorados...

**Pako Premium 16,66 EUR\* në muaj!**

**E gjithë bota në shtëpi!**  
 \* Pakon Premium 1 vjeçare tani mund ta bleni me këste mujore për 12 muaj me 0% interes.

## FRD: Jo koalicion me Berishën e Ramën

Subjekti i ri politik në Shqipëri, Fryma e Re Demokratike ka përjashtuar mundësinë për një koalicion mes saj dhe Partisë Demokratike ose atë Socialiste. Përmes një njoftimi për shtyp, grupi i ri politik ka njoftuar se koalicionin do ta formojë me

qytetarët dhe jo me parti që sipas saj shkelin parimet kushtetuese. "Fryma e Re Demokratike deklaron se, si një forcë e re politike do të punojë për konsolidimin e saj dhe shndërrimin në një faktor të rëndësishëm në skenën politike shqiptare",

thuhet në deklaratë. "Fryma e Re Demokratike deklaron se koalicioni i saj do të jetë vetëm me qytetarët shqiptarë, në funksion të ndërtimit të shtetit të së drejtës dhe realizimin e aspiratës së shqiptarëve për të qenë pjesë e denjë e bashkësisë së madhe

evropiane", vijohet në njoftimin për shtyp. Subjekti politik vlerëson më tej se në këtë drejtim, koalicioni me liderin e shumicës ose me atë të opozitës është i pamundur. "Në këtë qëllim të madh FRD nuk do të bëjë asnjë koalicion

me zotin Berisha dhe zotin Rama. Është e qartë për cilindo, se praktikisht ka një koalicion PD-PS, i cili arnoi Kodin Elektoral duke mos respektuar as parimet kushtetuese, as vullnetin e forcave politike", përfundon deklarata.



# BAN KI MOONI HIDHEROI REPUBLIKEN SERBE

**Vizita në Srebrenicë e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon, gjatë turneut të tij nëpër shtetet e Ballkanit, ka hidhëruar tej mase zyrtarët e Republikës Serbe në Bosnje, të cilët e akuzuan atë për "njëanshmëri". Bani nuk ka thënë asgjë tjetër, pos që bashkësia ndërkombëtare ka dështuar që të mbrojë viktimat e pafajshme boshnjake, pas pushtimit të enklavës nga forcat serbe.**

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e përfundoi udhëtimin e tij në republikat ish-jugosllave javë me një vizitë zyrtare në qendrën për kujtimore në Srebrenicë të enjten, duke shkakuar një reagim të ashpër në Republikën Serbe.

Zyrtarë, organizata të veteranëve e viktimave serbe e dënuan vizitën e Banit dhe thanë se duhet të kishte parë vende të tjera ku serbët e kombësi të tjera vuajtën.

Darko Babalj, deputet i Partisë Demokratike Serbe (SDS) tha se gjithkush ishte i kënaqur me vizitën e Banit, por fjalimi që shefi i OKB-së mbajti në parlament duket pak "i një-anshëm". "Jemi të pakënaqur nga fakti se Bani shkoi për të nderuar viktimat e vetëm një kombi. Ka tri kombe në Bosnje, e nga të gjitha palët njerëz u vranë në luftë. Do të jetë shumë më mirë për zyrtarët botërorë që të përqendrohen në problemet ekonomike, sesa të mbajnë fjalime politike kur mbërrijn në Bosnje", tha Babalj.

Nedeljko Mitrovic, presidenti i Organizatës së Familjeve të Ushtarëve të Kapur e të Vranë dhe të Civilëve të Humbur, tha se shpërfillja e viktimave serbe ka qenë praktikë e zyrtarëve ndërkombëtarë që vizitojnë Bosnjën. "Del se vetëm serbët janë fajësuar për gjithçka të keqe që ndodhi këtu. Bani është përfaqësues i të gjithë popujve dhe jo vetëm i njerëz", tha Mitrovic.

Bani u takua me anëtarët e presidencës së Bosnjës e përfaqësues të Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe mbajti një fjalim në asamblenë shtetërore. "OKB nuk e përmbushi përgjegjësinë e saj, duke mos arritur që të mbrojë Srebrenicën nga gjenocidi. Morëm mësimet tona nga ky incident i tmerrshëm. Mund të krahasohet me gjendjen e sotme në Siri, ku komuniteti ndërkombëtar është përsëri në sprovë", u tha Bani delegatëve të Asamblesë. Pas fjalimit të Banit, Presidenti i RS-së Milorad Dodik, u tha gaze-

tarëve se arsyeja e nisjes së konfliktit ishte njohja ndërkombëtare e e Bosnjës si si një shtet. Mujo Haxhiomerovic, presidenti i Klubit Boshnjak të delegatëve në Asamblenë Kombëtare të RS-së, tha se ishte i habitur me reagimin e Dodikut.

"Nëse njeriu që është në një funksion të një pozite të madhe politike të tillë kishte forcën të vinte në Bosnjë e të thoshte 'Ne bëjmë gabim, na falni', nuk e kuptoj pse dikush tjetër që jeton në Bosnje do të thotë diçka të tillë. Duke vizituar Srebrenicën, Bani dërgoi një porosi se komuniteti ndërkombëtar mbështet me forcë Bosnjën dhe se drejtësia do të bëhet," tha Haxhiomerovic. Seada Livnjak, 35 vjeç nga Dobojo, thotë se zyrtarët e RS-së reagojnë pa arsye.

"E kishte thënë qartë se po shkonte në Srebrenicë për të shprehur respekt për të gjitha viktimat. Është normale ta bësh këtë gjë në vendin ku humbën jetën numri më i madh i viktimave. Këto reagime vetëm prodhojnë mosmarrëveshje të mëtejshme", tha Livnjak.

Mark Kosljenovici, 28 vjeç, nga Banja Luka, mendon se çështja e vizitës së Srebrenicës po përdoret për qëllime politike.

"Mijëra civilë serbë u vranë në luftë. Askush madje nuk i kujton kështu njerëz kur vijnë në Bosnje. Betoja se politikanët nuk kujtojnë as viktimat e Srebrenicës. Vetëm vijnë këtu që të bëjnë një fotografi të vetes, të japin deklarata për gazetat," tha Kosljenovici.

## Ilir Gjoni: Shqipëria ka bërë tregti armësh me kriminelë



Nënkryetari i Komisionit të Parlamentit të Shqipërisë për Siguri, deputeti socialist Ilir Gjoni, në një intervistë për "Shqiptarja.com" u shpreh se Shqipëria ka bërë tregti armësh me tregtarët më të errët të krimit në botë. Ai nënvizon se disponon të gjitha dokumentet e nevojshme që vërtetojnë se Ministria shqiptare e Mbrojtjes ka pasur marrëdhënie me trafikantin

serb, Slobodan Tesic. Ndërkohë që për Gjonin shqetësim për sigurinë kombëtare është fakti që bizneset e errëta serbe kanë penetruar në sektorë strategjikë të ekonomisë së vendit dhe ky përbën një fakt shqetësues për të gjithë. Ndërkohë ai ka akuzuar kryeministrin Sali Berisha se nuk e ka për herë të parë trafikun dhe thyerjen e embargos së OKB-së, pasi sikurse ka pranuar edhe vetë kreu aktual i qeverisë, me firmën e PD "Shqiponja" ka thyer embargon me ish-Jugosllavinë, ndërkohë që ka pranuar dhe tregtinë e armëve, por sipas Gjonit, edhe Gërdeci dhe gjithë veprimtaria e tij e vërtetojnë këtë akuzë.

## Arrestohen 46 prostituta në Maqedoni

Policia maqedonase ka arrestuar 46 vajza të reja nën akuzën e ushtrimit të prostitucionit, në një seri hotelesh në perëndim të Maqedonisë.

Lajmin e ka komunikuar për mediat maqedonase vetë ministrja e Brendshme, Gordana Jankulovska, e cila ka dhënë edhe detajet e operacionit.

Sipas ministres, nga 46 vajzat, 22 janë me shtetësi serbe, 9 me shtetësi bulgare, 7 me shtetësi maqedonase, 4 me shtetësi shqiptare, ndërsa të tjerat nga Kosova dhe Mali i Zi.

Sipas Jankulovskës, nga hetimet është zbuluar se ato janë të moshave nga 18 në 24 vjeç dhe nuk ndodheshin në Maqedoni



ni për herë të parë. Ministrja e Brendshme ka saktësuar se ato punonin në hotele luksoze në lokalitetet e Tetovës, Zherovjanit, Vaksincës dhe Gostivarit dhe në bance të tyre janë gjetur shuma të mëdha parash.

Jankulovska ka shtuar më tej se, karakteristikë e këtij rasti ishte se vajzat kishin liri të plotë lëvizjeje, pasi kishin pasaporta të rregullta dhe mundësi për të dalë nga zona ku punonin.

## Rumunët votuan për fatin e Basescukut



Rumunët votuan në një referendum për shkarkimin nga detyra ose jo të presidentit të qendrës së djathtë, Traian Basescuk.

Basescuk është suspenduar nga parlamenti në një seri hapash, që kanë çuar në paralajmërimet e BE-së dhe të SHBA-së se demokracia po shkatërrohej.

Qeveria e qendrës së majtë e

kryeministrin Viktor Ponta e ka akuzuar Basescukun për zgjerimin e autoritetit të tij dhe përzjerjen në punët e qeverisë.

Basescuk mohon një gjë të tillë dhe kërkoi bojkotimin e referendumit. Nëse pjesëmarrja është më e ulët se 50 për qind, referendumi shpallet i pavlefshëm dhe Basescuk do të kthehet në detyrë.

Por, nëse votohet për largimin e tij, rumunët duhet të organizojnë zgjedhje të reja presidenciale. Konflikti ka paralizuar marrjen e vendimeve politike në Rumani, në kohën kur vendi po finalizonte marrëveshjet mbi një pak shpëtimi të mbështetur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.



*Coca-Cola*



**Ndaje kënaqësinë  
festive!**



"Coca-Cola", "Contour Bottle", "Dynamic ribbon" dhe "Çirioje lirimturi" janë marka të regjistruara të The Coca-Cola Company.



**KURSE** DHE FITO  
PËR TË ARDHMEN

**5.25%**  
interes



**BKT**  
BANKA KOMBETARE TREGTARE

Me çdo deponim prej **1,000** deri në **20,000€**.  
fitoni **5.25%** interes dhe bëhuni pjesë e lojës shpërblyese.

Qendra Kontaktuese  
038 666 666



[www.bkt-ks.com](http://www.bkt-ks.com)

Ne jemi gjithmonë këtu

## KOBIT PC

# SUPER AKSION



### 109 Euro



**PC FujitsuSiemens 3.2GHz  
1GB Ram, 160 Gb Hdd, DVD Rom  
Monitor TFT LCD 19" EIZO**

### 369 Euro



**Laptop TouchScreen HP Compaq  
2710p Core2Duo 1.20GHz  
2Gb DDRam 80Gb HDD**


### 89 Euro



**PC pentium IV 2.8GHz  
1Gb Ram, 80Gb Hdd, DVD Rom  
Monitor TFT LCD 17"**

**Prishtinë**  
Email: kobit.pc@gmail.com  
1. Adresa: Rr "Ilaz Kodra" Dardani afër KEK-ut  
Tel: 038 510 009 & 044 901 101  
2. Adresa: Rr: "Ilaz Kodra" Dardani afër stacionit të autobusave, Tel: 038 552 334 & 044 777 477


**Mitrovicë**  
Email: kobit.pc.mitro@gmail.com  
Tel: 044 800 999. Adresa: Rr: "Ahmet Selaci" afër Sh.F. "I, Qemali"  
si dhe depoja me shumicë në Prishtinë  
Adresa: Rr: "Drini i bardh" Afër Hekurudhës.



Republika e Kosovës  
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsior  
Agjencia Kadastrale e Kosovës

## NJOFTIM

Rindërtimi i Kadastrit në ZK:



Ferizaj	Nerodime e Poshtme	02.08.2012	19.00	Shkolla "Konstandin Kristoforidhi"
Ferizaj	Varosh	03.08.2012	19.00	Shkolla "Visar Dodoni"
Ferizaj	Komogllavë	06.08.2012	19.00	Shkolla "Besim Regjepi"
Ferizaj	Fshati i Vjetër	07.08.2012	19.00	Shkolla "Muharrem Shemsedin", Bibaj

Njoftohen të gjithë banorët e fshatrave të mësipërm se Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me IDA dhe përmes Agjencionit Kadastral të Kosovës do të fillojë rindërtimin e kadastrit në zonat tuaja.

Me këtë rast i ftojme të gjithë banorët që në datat, orën dhe vendet përkatëse si më lart të mbledhen për tu informuar më tepër rreth procesit.


Arsyet e Rindërtimit:

Mospërputhja e të dhënave grafike me tekstuale si pasojë e mos-mirëmbajtjes së rregullt të kadastrit dhe marrjen e dokumenteve nga Serbia ka sjellë domosdoshmërinë e kryerjes së këtij procesi.


Përfitimi është shumëpalësh duke filluar që prej:

- Përfundimit të të dhënave për pronësinë mbi pronën e paluajtshme në bazë të situatës aktuale në terren.
- Stabilizimit të së drejtës së pronësisë në tregun e tokës.
- Kryerjen e detyrave të tjera të tilla si: planifikimin e përdorimit, zhvillimi i infrastrukturës, konsolidimin e tokës etj

Projekti do realizohet nga:




Rr. e Durrësit, P. 42, Ap. 1/4, Tirana-ALBANIA  
Tel/Fax: +355 4 223 44 66, Mob. +355692095123, +37744 228 716  
Web: www.lorenco-co.com, e-mail: info@lorenco-co.com



Republika e Kosovës  
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsior  
Agjencia Kadastrale e Kosovës

## NJOFTIM

Rindërtimi i Kadastrit në ZK:



Gjiilan	Malishevë	30.07.2012	19.00	Shkolla "Avdullah Tahiri"
Gjiilan	Lladove	31.08.2012	19.00	Shkolla "Agim Ramadani", Lladove.
Gjiilan	Zheger	01.08.2012	19.00	Shkolla "Agim Ramadani"

Njoftohen të gjithë banorët e fshatrave të mësipërm se Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me IDA dhe përmes Agjencionit Kadastral të Kosovës do të fillojë rindërtimin e kadastrit në zonat tuaja.

Me këtë rast i ftojme të gjithë banorët që në datat, orën dhe vendet përkatëse si më lart të mbledhen për tu informuar më tepër rreth procesit.


Arsyet e Rindërtimit:

Mospërputhja e të dhënave grafike me tekstuale si pasojë e mos-mirëmbajtjes së rregullt të kadastrit dhe marrjen e dokumenteve nga Serbia ka sjellë domosdoshmërinë e kryerjes së këtij procesi.

Përfitimi është shumëpalësh duke filluar që prej:

- Përfundimit të të dhënave për pronësinë mbi pronën e paluajtshme në bazë të situatës aktuale në terren.
- Stabilizimit të së drejtës së pronësisë në tregun e tokës.
- Kryerjen e detyrave të tjera të tilla si: planifikimin e përdorimit, zhvillimi i infrastrukturës, konsolidimin e tokës etj

Projekti do realizohet nga:



Rr. e Durrësit, P. 42, Ap. 1/4, Tirana-ALBANIA  
Tel/Fax: +355 4 223 44 66, Mob. +355692095123, +37744 228 716  
Web: www.lorenco-co.com, e-mail: info@lorenco-co.com

arté

REDAKTOR: FATON RAÇI  
 e-mail: faton.raci@gazetaexpress.com  
 tel: 038 76 76 76 fax: 038 76 76 78

## Kirk Douglas dhuron 50 milionë dollarë

Legjenda hollivudiane, Kirk Douglas, ka dhuruar një shumë prej 50 milionë dollarësh për bamirësi. Aktori i njohur për filmin "Spartacus" dhe gruaja e tij, Anne, do t'ua japin paratë pesë organizatave bamirës përmes fondacionit të tyre, "Douglas Foundation". Një pjesë e parave do të

jepet për përmirësimin e spitalit që trajton sëmundjen Alzheimerit në Woodland Hills të Kalifornisë, pastaj një pjesë do t'i dhurohet një universiteti në New York për shkollimin e pakicave, po ashtu me një shumë tjetër do të ndihmohet ndërtimi i teatrit "Kirk Douglas" në Culver City.



# Dorëzohet dhe vuloset në Arkiv "Dimri" i Kadaresë

Zbatohet vendimi i Gjykatës së Tiranës për sigurim padie. Përfaqësuesi i Nexhmije Hoxhës dhe Teuta Hoxha dorëzuan dorëshkrimin origjinal.

**D**orëshkrimi aq i përfolur i romanit "Dimri i vetmisë së madhe" u dorëzua në Arkivin Qendror Shtetëror. Pas vendimit të Gjykatës së Tiranës, sipas të cilit për sigurim padie, dorëshkrimi në posedim të familjes Hoxha sekuestrohej dhe merrej në ruajtje të përkohshme nga Arkivi i Shtetit, përfaqësuesi ligjor i Nexhmije Hoxhës dhe e reja Teuta Hoxha kanë bërë dorëzimin. Sipas drejtoreshës së Përgjithshme të AQSH, Nevila Nika, "të premtën u bë dorëzimi fletë për fletë (gjithsej 1252) sipas dosjeve ku ishin vendosur, gjithsej shtatë, nga përfaqësuesi i Nexhmije Hoxhës". Sipas saj, bëhej fjalë për dorëshkrime dhe shtypshkrime, të cilat ruheshin në gjendje të mirë dhe pa dëmtime fizike. Për të gjithë procesin e dorëzimit dhe të verifikimit u mbajt një procesverbal, i cili mësohet të jetë nënshkruar nga përfaqësuesit e palëve, përmbartuesit dhe përgjegjësi i sektorit të ruajtjes pranë AQSH.


Sipas Nikës, AQSH nuk ka asnjë të drejtë për hapjen e dosjeve pa praninë e nënshkruesve. Dorëshkrimi u mbyll në një kuti, e cila është mbyllur me skoç dhe me vulën e përmbartuesit dhe vulë dylli me shenjën e AQSH-së dhe të përfaqësuesit të familjes Hoxha. "Dorëshkrimi u vendos në dhomën ku mbahen kodikët", informon drejtoresha Nika. Ndërkaq, përfaqësuesja ligjore e Ismail Kadaresë, avokatja Flonja Tashko, thotë se i gjithë procesi i dorëzimit u krye në mënyrë shumë të rregullt, në bazë të vendimit për sekuestrimin dhe inventarizimin e dorëshkrimit të romanit të Ismail Kadaresë. Sipas saj, përmbartuesi mbajti procesverbal për të gjithë procedurën, ndërsa Arkivi bëri verifikimin dhe inventarizimin e dorëshkrimit. "Jemi shumë

të kënaqur për këtë hap. Sigurisht që dorëzimi dhe ruajtja e dorëshkrimit pranë Arkivit të Shtetit është një arritje, ndërkohë që ne presim vendimin e Gjykatës, duke shpresuar që të mund të marrim të drejtën tonë të autorit", u shpreh Tashko. Historia e romanit me një jetë të vështirë "Dimri i vetmisë së madhe" u rihap dhjetë ditë më parë, kur Ismail Kadare paditi bashkëshorten e ish-diktatorit Nexhmije Hoxha. Më datën 18 korrik, Kadare ka paraqitur në Gjykatën e Tiranës një kërkesë-padie, për të cilën është bërë shkak dorëshkrimi origjinal i romanit "Dimri i vetmisë së madhe".

Sipas padisë, shkrimtari pretendon se dorëshkrimi origjinal i këtij libri mbahet në mënyrë të paligjshme nga e veja e diktatorit. Pasi kanë dështuar të gjitha tentativat e shkrimtarit për ta rimarrë këtë dorëshkrim, ai i është drejtuar Gjykatës së Tiranës përmes një kërkesë-padie. Çështja gjyqësore mban numrin 14897. Në Gjykatën e Tiranës, padia po shqyrtohet nga gjyqtari Bledar Abdullai.

## DORËZIMI I FOTOKOPJES NJË VIT MË PARË

Pas shumë tentativash të Ismail Kadaresë, përmes ndërmjetësish, për të rimarrë nga Nexhmije Hoxha dorëshkrimin e romanit "Dimri i vetmisë së madhe", në qershor të vitit të shkuar Teuta Hoxha ka dorëzuar në Arkivin e shtetit një kopje të romanit. Në emër të Nexhmije Hoxhës, ajo dorëzoi një fotokopje të dorëshkrimit. Sa i përket originalit, Nexhmije Hoxha pretendon se është një dhuratë nga ana e shkrimtarit Ismail Kadare dhe ajo nuk ka përse ta dorëzojë.





## Mes akteve të Meredith-Vulës

Të enjten, më 2 gusht, në orën 19:00, në Parkun Arkeologjik Kombëtar në Prishtinë (përballë Muzeut të Kosovës), do të hapet ekspozita më fotografi 'Mes akteve' e fotografes Lala Meredith-Vula. Ekspozita, e cila do të jetë e hapur deri më 14 gusht, hapet

në kuadër të manifestimit 'Ditët e mërgatës 2012'. 'Mes akteve' është një seri fotografish të bëra gjatë tre dekadave. Matematika e tyre shkon nga takimet publike për pajtimin e gjaqeve dhe periudha pas luftës e jeta pastorale në Kosovë tek imazhet e

diasporës, përfaqësuar nga gruaja me veshje tradicionale shqiptare në sfonde e vende të ndryshme të botës. Ndonëse fotografitë janë bërë në një vend e kohë të caktuar, jehona e domethënja e tyre nuk është e lidhur me një moment konkret.

Ato nuk kanë për qëllim të japin portretin e një ngjarjeje, por duan më shumë të shprehin ndjenjat që burojnë nga ngjarja, të mbushin hendekun mes ngjarjes e portretit të saj. Ato janë 'foto çasti' të aksionit e ngjarjes kryesore që portretizojnë.

Shkrimtari 46-vjeçar, me pamjen dhe jetën e një dendi, të cilit i pëlqen që të joshë në mënyrë të vazhdueshme dhe të ketë një jetë sentimentale shumëgjyreshë në rrethet elitare pariziene dhe gjatë, është një nga njerëzit më në zë të brezit të tij, në Europë. Veç kësaj, është edhe kritik letrar, botues dhe së fundi ka eksploruar edhe në lëmin e regjisë. Filmi i tij i parë bazohet në librin e tij të fundit "Dashuria zgjat tre vjet". Frederic u bë i famshëm së pari me një pamflet që shkroi kundër publicitetit, si dhe me romanet që pasuan, mes të cilëve përmendim "Një roman francez", dedikuar familjes së tij. Dhe më pas, në veprat në vijim, ka parapëlqyer dhe ka ndjekur gjithmonë linjën autobiografike. Ndërsa në librin për dashurinë dhe filmin, në të cilin është dhe regjisor, që është një komedi, alteregoja e tij quhet Marc Maronnier dhe përfaqëson tipologjinë e adoleshentit 40-vjeçar, që haset shpesh në ditët e sotme. Një maskull që tenton me çdo kusht të duket dhe të veprojë si i ri, i pakënaqur me jetën dhe njerëzit që e rrethojnë, pra mjeshër për të mos qenë i lumtur. Në një intervistë, autori flet për mënyrën se si ai e sheh dashurinë dhe për dashurinë në përgjithësi.

### Jeni një egoist romantik?

Në fakt, kjo është një shprehje e të madhit Scott Fitzgerald, të cilën e kam huazuar prej tij, për të përshkruar gjithë brezin tim. Ne, brezi i viteve '60 me prindërit tanë që përjetuan revolucionin seksual, duket se kemi humbur çdo iluzion. Në marrëdhëniet e dashurisë jemi nihilistë, egoistë, madje edhe shumë depresivë. Personazhi im kërkon që të vetëvritet në fillim të historisë.

### Lacan thoshte se, në fakt, dashuria është gjithmonë një formë vetëvrasje...

I dashuruari ndihet i pamposthur dhe mundet dhe në këtë Lacan ka të drejtë, që të vërë në rrezik qenien e tij, atë fizike dhe mendore për arsye dhe rrethana të ndryshme. Louis Arragon ka shkruar: "Nuk ekziston dashuri e lumtur. Frika nga vuajtja shpesh na bën të paafte për të dashuruar". "Në vitin e parë është pasioni, në të dytin futet në lojë dhembshuria dhe në të tretin nis bezdisja".

Po, këtë e kam shkruar në libër dhe e mbështes gjatë gjithë faqeve të tij. Titulli është provokues edhe pse të them të vërtetën, jam bazuar në statistika reale dhe objektive. Pjesa më e madhe e martesave dështon brenda tre viteve të para të jetës së përbashkët. Madje, tani jam më se i bindur edhe për faktin se ky cikël është përshpejtuar edhe më.

### Ju e shihni dashurinë si një produkt që ka një datë skadence dhe që duhet të konsumohet brenda datës?

Kur nisa që të shkruaja këtë libër ishte viti 1997 dhe nuk kishte as internet dhe as celularë. Që nga ajo kohë, mundësitë e takimeve dhe si pasojë, edhe të ndarjeve ishin rritur jashtë mase. Sapo te një çift nis dhe shfaqet mërzia e të jetuarit bashkë, lind tentativa për të shkuar dhe kërkuar diku gjatë, atë që nuk ta jep më marrëdhënja jote tashmë e qëndrueshme. Dhe për ta bërë një gjë të tillë, mjafton një mesazh, ose një klik. Në një regjim të tillë është e vështirë që të ndërtohet një marrëdhënie të qëndrueshme.

### Ju mendoni se t'i betohesh dikujt me dashuri të gjatë është shumë pak romantike...

Po, por ky është realiteti i sinqertë. Mbijetojnë të tjera forma të dashurisë së përjetshme si: besimi, marrëdhënja mes prindit dhe fëmijës. Në çift duhet që të kënaqesh me një kohëzgjatje të kufizuar. Filozofi Pascal Bruckner, i cili merr pjesë edhe në filmin tim, flet për "parajsën dashurore". Si të jemi të lirë dhe të pranojmë që të duam dhe të na duan. Megjithatë është diçka që shpesh ngërthehet nga kontradikta, sepse duam dikë, pastaj e kuptojmë se duam edhe lirinë tonë. Mendoj se të gjithë duhet që të jemi më realistë.

### A mendoni se ky realizim është një variant më elegant i cinizmit?

Si shumë bashkëmoshatarë të mi, edhe unë jam shumë i frikësuar kur bëhet fjalë për marrëdhëniet dashurore. Kërkoj dashuri por me riskun zero. Kjo nuk vlen vetëm për meshkujt, por edhe për femrat e këtij brezi, madje dhe për femrat më të reja në moshë, të cilat janë edhe të pavarura ekonomikisht. Protagonistja tjetër e librit është Alice, një grua e martuar. Kur ajo takon Markun dhe të dy bëhen dashnorë, ajo refuzon që të ndahet nga bashkëshorti edhe pse ata të dy duheshin tashmë. Dhe këtë e bën sepse ka frikë që të vuajë.

### A është bërë vallë, sipas jush, një klishe tashmë 40-vjeçari që i ikën dashurisë nga frika?


Në libër dhe në film jam për-pjekur që t'i heq maskën këtij 40-vjeçari që përpigjet të hiqet ai që nuk është dhe që, mbi të gjitha, tallet me ndjenjat duke i përcmuar ato. Janë të shumtë ata që sillen kështu së jashtmi, por që në fakt thellë-thellë mendojnë ndryshe.

### Por, në fund, të gjithë "e pësojnë". E kam fjalën për dashurinë...

Në këtë moshë, kur e kupton se

# Egoisti roma

**"Nuk e konsideroj veten një specialist të ndjenjave dhe vetë jeta ime private tregon se nuk kam asgjë për të thënë, apo për të dhënë shembull", deklaroi shkrimtari Frederic Beigbeder, i njohur së fundi edhe për publikimin e librit të tij: "Dashuria zgjat tre vjet".**



nuk mund ta ndryshosh botën, të fitosh zemrën që të rreh duket një mrekulli. Është utopia e fundit që na mbetet...

### Por ndërkohë kemi pushuar së besuari te "princi i kaltër"?

Ai ishte një koncept i mrekullueshëm marketingu romantik. Por nuk ekziston. Dhe sikur të ekzistonte, do të ishte një bastard. Sot më shumë se njerëzit, duam dashurinë. Është një gabim i madh. Jemi në kërkim të deklaratave

metafizike, ndërkohë që duhet të ishim në kërkim të dikujt konkret, me mish e shpirt, me të mira e me të këqija, që të na bënte të ndiheshim mirë, pra kemi nevojë për një qenie njerëzore si ne.

### Ja dhe një citim tjetër nga libri juaj: "Të duash dikë që të do është narcizizm. Të duash dikë që nuk të do, kjo është dashuri"

Dashuria është si feja, është një akt besimi. Është ende gjëja më e bukur që mund të na ndodhë në

jetë. Nuk është arritur kurrë që të shpiket një drogë kaq e fuqishme. Si shkrimtar, për mua ajo është filli që më lejon që të tregoj për ngjarje dhe personazhe.

### Të paktën, për këtë, nuk ekzistojnë të drejtat e autorit...

Më pëlqen gjithsesi që të shoh se si pasioni arrin që të shembë të gjitha muret mbrojtëse, të cilat ia vëmë vetes për të mos rënë në dashuri dhe si pasojë, për të mos vuajtur. Për mua si shkrimtar

## Lohan do rol në filmin «Thelma and Louise»

Lindsay Lohan në profilin e saj në Twitter ka shprehur dëshirën që të luajë me Jennifer Lawrence në «Thelma and Louise», por në stilin ala «Natural Born Killers». Jennifer Lawrence u bë e famshme me filmin «Hunger Games».

Problemikja Lindsay Lohan duhet që së bashku me yllin e filmit, «Hunger Games», Jennifer Lawrence të luajë në rixhirimin «ultra të dhunshëm» të një prej veprave kult të fillim viteve të nëntëdhjeta, «Thelma and Louise».

«Jennifer është një gjeni dhe unë dua të punoj me të në këtë film», ka shkruar Lindsay në Twitter e saj. Në filmin e xhiruar në vitin 1991, rolin e mikeshave në arrati e kanë luajtur Susan Sarandon dhe Gina Davis. Mediat amerikane kohë më parë

kanë raportuar se Lohan po ashtu ka kërkuar që të punojë edhe me aktorin, Brad Pitt, por ajo u ndje e ofenduar kur dëgjoi se emri i saj gjendet në listën B të aktorëve të preferuar të bashkëshortit të ardhshëm të Angelina Joliet.



# antik

është e mrekullueshme që të përshkruaj humbjen e kontrollit, që në fakt, është momenti kur njeriu është i shtërnguar që më në fund të jetojë dhe të shprehet.

### A ka ndonjë libër apo faqe që doni të kujtoni?

Jam fanatik i gjendjeve të dyfishta, i personazheve që bëjnë sikur janë imunë dhe më pas janë të parët që bien në kurthin e romantizimit, sepse kanë nevojë, por nuk e pranojnë aspak. Mendoj për «Kapriçiot e Marianës» të Alfred de Musset. Octavi që përpigjet të ndjellë Marianën në emër të një miku të tij dhe në fakt, bie vetë në dashuri me të. Është ajo gjë që në Francë e quajmë «marivaudages». Pra një ndërthurje mes mashtrimeve dhe tradhtive brenda marrëdhënieve dashurore.

### Xhelozia është një ndjenjë, e cila nuk del kurrë jashtë mode.

Është një ndjenjë, e cila forcohet kur dashuria bëhet e brishtë dhe e thyeshme, e cenueshme. Xhelozia është e pashmangshme dhe natyrisht është e pranishme në të gjitha marrëdhëniet. Duhet vetëm që të kontrollohet, sepse nuk është një ndjenjë seksi. Por kur të zë, nuk ke nga shkon. Në të shkuarën shumë eksperimente të famshme me «çifet e hapura» kanë dështuar në mënyrë të pashmangshme, të gjitha për faj të xhelozisë.

### Si shkrimtar, a mendoni se fraza «të dua» e ka humbur apo e ka shtuar intensitetin që mbart?

Duhet që të jetë përballë teje personi i duhur për t'ia thënë këto fjalë dhe që ato të kenë kuptim. Për këtë duhet që të jesh me shumë fat në jetë. Dashuria është ajo ndjenjë e mrekullueshme dhe e rrallë që rrefehet edhe në filmin «Unë dhe Ana». Woody Allen është me Diane Keaton në kuzhinë. Të dy përpigjet që të gatuajnë një arragostë të gjallë që u rrëshqet. Mes të qeshurash ka edhe momente paniku. Në fund të filmit, Allen e përsërit të njëjtën skenë me një grua tjetër, një ish-modele, shumë e bukur dhe e re, por asgjë nuk funksionon si me Anën. Gjatë kësaj përvoje ai mërzitet për vdekje. Të gatuash një arragostë të gjallë mund të jetë shumë zbavitëse ose tmerrësisht e mërzitshme. Varet nga personi. E njëjtë gjë vlen edhe për dashurinë.



## Arti i grafitit në Afganistan

Të rinjtë në Kabul po i zhvendosin kufijtë e shoqërisë konservatore të Afganistanit. Por ata e bëjnë këtë nën rrezikun e presioneve të rënda sociale.

Grafitet në Kabul janë një art i rrezikshëm. Për artistin e vetme femër të grafitit në Afganistan, Shamsia Hasani, marrja me këtë formë arti është pothuajse e pamundur. Nuk është e pranueshme nga kultura që një grua të dalë në rrugë e vetme. Pastaj ka edhe rreziqe tjera të përditshme në një vend që është në luftë.

«Ndjehem në rrezik nëse shkoj jashtë për t'u marrë me këtë formë arti».

Shamsia beson se figura e saj abstrakte e graas me një trup të mbuluar me burkë me ngjyrë blu mund të ndihmojë në ndryshimin e mënyrës se si gratë mendojnë për veten e tyre.

«Unë dua të ndryshoj vetëm formën e burkës, sepse forma e saj është shumë e rëndësishme, vetëm falë formës ato mund të duken shumë të lumtura. Në realitet forma duket shumë e trishtuar, por unë kam përdorur dizejno të re për të ndryshuar këtë formë si një mënyrë për të ndryshuar mendjet e grave që i veshin ato dhe si një inkurajim për të ndryshuar veten dhe mendjen e tyre».

Shamsia ka pasur një mundësi të vetme për t'u marrë me artin

grafitit në mjedis të hapur në një aktivitet të zhvilluar në Gjermani.

Por në Kabul ka ajo gjetur një zgjidhje. Ajo fotografon muret në qytet dhe pastaj i ngjyros fotografitë. Ajo e quan këtë grafiti digjital dhe thotë se kjo është një mënyrë për të sjellë ndryshim në shoqërinë afgane.

«Grafiti është për njerëzit, për ndryshimin e ideve të njerëzve. Është ideja ime, dua të ndryshojë idetë e njerëzve».

Studio e saj është e vogël. Dhe stili i saj artistik përfshin një spektër të gjerë. Por arti i saj është aty ku është zemra e saj.

«Grafiti është për ata që janë të interesuar të bëjnë art në mjedis të hapura. Sipas mendimit tim grafiti është art, dhe mendoj se është më efektiv se sa çdo shprehje tjetër artistike për zhvillimin e artit këtu në Afganistan».

Ajo pikturon në muret e brendshme të një kafeneje. Fakti që Shamsia merret me grafitin në një vend konservator si Afganistani është shenjë e ndryshimeve që po kalon vendi. Por fakti se ajo është shumë e frikësuar për t'u marrë me këtë lloj arti në rrugë, tregon se sa i ngadalshëm është ky ndryshim.

## LIBRA TË RINJ



### SOPHIE KINSELLA

«Zonja e funeraleve»

Përkthet: Afërdita Shuteriqi

Botoi: «Dituria»

Sophie Kinsella është pseudonimi i letrarit Madeleine Wickham. Ajo lindi më 12 dhjetor 1969 në Londër, ku jeton bashkë me të shoqin dhe tre fëmijët. Ka studiuar në New College në Oksford dhe më pas ka punuar për shumë kohë si gazetare e rubrikës ekonomike. Romanet e serisë «E fiksuar pas dyqaneve» e kthyen atë në një nga shkrimtarët më të famshme, e përkthyer në shumë gjuhë. Jo më pak të rëndësishëm janë për lexuesin anglez, e tashmë edhe për atë shqiptar, romanet që kjo autore i ka shkruar nën emrin e saj të vërtetë (Madeleine Wickham), ndër të cilat «Zonja e funeraleve» dhe «Pushime në vilë», të botuara së fundi nga shtëpia botuese «Dituria». Kjo shkrimtare e ka njohur lexuesin me Samanta Suitingun (Mbretëresha e shtëpisë), me Ema Koriganin (E mban dot një të fshehtë?), me të famshmen Beki (seria E fiksuar pas dyqaneve...). Tani vijjnë dy karaktere krejt të reja, jo më pak interesante e aventuriere, jo më pak komike, dhe strumbullar situatash të këndshme. E para është Fler Deksani (Zonja e funeraleve), gruan e bukur dhe tërheqëse, por mbi të gjitha pa skrupuj. E pajisur me një gardërobë të jash-tëzakonshme veshesh të zeza elegante, e informuar nga nekrologjiti e botuara në Times, Flëri merr pjesë në funerale dhe përkujtimore, duke pasur si qëllim të joshë vejanët e pasur e të pangushëlluar. Një satirë e hollë e shoqërisë së lartë britanike me të gjitha zakonet e veta, perfekte si një pjesë teatri klasik.

### JOHN WYNDHAM

«Dita e Trifidëve»

Përkthet: Piro Misha

Botoi: «Linus»

Kur Bill Maseni zgjohet në shtratin e spitalit, ku është i shtuar që prej një jave, pas një operacioni në sy, mendon se ka humbur shfaqjen e shekullit: një shi fragmentesh të një komete që një natë më parë kishte përshkuar qiellin e Londrës. Njerëzit janë verbuar dhe një grup i vogël njerëzish që përpigjet të organizohen për të mbijetuar dhe do t'u duhet të përballen me trifidët, këto bimë misterioze, që kanë aftësinë të zhvendosin, të cilat duken të vendosura për t'i zhdukur njerëzit nga faqja e dheut. Famen e këtij romani të shkrimtarit anglez John Wyndham, të konsideruar një ndër kryeveprat e të ashtuquajturës letërsie pas-apokaliptike, ia kanë shtuar edhe më tre ekranizimet që i janë bërë, më i fundit, një serial me gjashtë seri, i prodhuar në vitin 2009 nga BBC.

### YLLKA FILIPI

«Dante, Migjeni, Kadare»

Botoi: «Albas»

«Dante, Migjeni, Kadare; trekëndëshi infernal universal», është një përpjekje krahasuese mes letërsisë së tre shkrimtarëve, për të gjetur pikat e takimit dhe ndikimit të letërsisë së dy të parëve me Kadarenë. «Baza e këtij misioni krahasimtar do të nisë nga pikëtakimet e vetëdijshme të Kadaresë me Danten dhe reminishencat instiktive të Migjenit me ferrin dantesk. Kadare pohon tundimin nga Hadesi, ndërsa vepra e Migjenit konstaton ferrin shqiptar të viteve '30 e më gjerë. Analogjitë mes botës infernale danteske dhe asaj kadareane janë tashmë një përfundim i konsoliduar nga autori, i cili e konstaton një gjë të tillë», shkruan Filipi.

# Rozë

redaktor: Ardian Jasiqi  
e-mail: ardian.jasiqi@gazetaexpress.com  
tel: 038 76 76 76 fax: 038 76 76 78

## Biel hap restorant

Aktorja Jessica Biel është duke planifikuar të hapë një restorant të vetin. Aktorja – e cila është e fejuar me këngëtarin Justin Timberlake – ka thënë se ajo dëshiron që të hapë një restorant me një furrë të mirë pjekëse në New York. "Dua që ta kem edhe këtë komponentin e furrës, sepse mendoj se ushqimi që piqet në furrë është shumë i mirë dhe e bën ushqimin të këndshëm", tha ajo.



# Realiteti e tejkaloi ëndrrën time

Megjithëse është shumë e re, ajo tashmë është një emër shumë i njohur në muzikën e lehtë shqiptare. Kjo është këngëtarja e re shkodrane, Elhaida Dani, fituesja e "Top Fest 9".



Në një intervistë të dhënë për gazetën "Koha Jonë" në suplementin "Summer Time" Elhaida rrëfen si ka nisur rrugën e këngës, kush ka qenë shtytsa për të, cilat janë projektet e saj dhe shumë të tjera. Nëse më parë emri i saj njihet vetëm nga një rreth i ngushtë, sot ajo njihet nga shumë shqiptarë, por ajo rrëfen se është me "këmbë në tokë" dhe se fama thjesht i ka shtuar përgjegjësinë për të dhënë më të mirën nga vetja.

**Elhaida çfarë kujtoni nga fillimet tuaja të para në rrugën e këngës?**  
Unë kam studiuar për piano që në moshën 6-vjeçare dhe kam kënduar gjithmonë, por asnjëherë nuk kam marrë pjesë nëpër festivale fëmijësh apo aktivitete të tjera. Vetëm gjatë shkollës së mesme jam bërë pjesë e aktiviteteve të ndryshme shkollore si dhe të qytetit. Pastaj siç e dini dhe pjesëmarrja ime në "Star Academy" ku unë shpalla fituese, me dha një mundësi evidentimi dhe një shtysë shumë të madhe për t'u marrë seriozisht me këngën.

**Cila ka qenë pjesëmarrja juaj e parë nëpër festivale?**

Unë kam dy histori festivalesh: festivale ndërkombëtare dhe festivale kombëtare. Pothuajse të dyja kanë zanafillën në vitin 2011. Në korrik të vitit të kaluar, kam qenë pjesëmarrëse dhe fituese e festivalit ndërkombëtar "Suncane Skale", pas atij, në shtator pjesëmarrëse dhe fituese e festivalit "Zlaten kesten" në Bullgari. Gjithash-tu gjatë 2012 kam qenë pjesëmarrëse dhe fituese në disa festivale të tjera në Rumani e Bullgari. Ndërsa me festivale kombëtare kam filluar me edicionin e kaluar të festivalit të fundvitit dhe ishte një nder i madh për mua të isha pjesëmarrëse në 50-vjetorin e tij. Kënga ime mori dhe çmimin "best melody" pastaj direkt erdhi Top Fest.

**E prisnin vendin e parë në Top Fest?**

As nuk e kisha imagjinuar... madje e keni parasysht kur hyn në një kom-peticion dhe qoftë vetëm një herë, të kalon nëpër mend "ah sikur ta fitoja" ... për mua as kjo s'ka qenë, vetëm kam menduar "ah sikur të isha në finale"! Por ja që realiteti e tejkaloi

ëndrrën time, jo vetëm që isha në Fi-nale por isha edhe fituese e festivalit.

**Ju jeni ndër ato këngëtare që kanë menaxherë, çfarë humbin ata këngëtarë që nuk kanë?**

Ne kemi një vit që punojmë bashkë dhe jam shumë e kënaqur. Unë kam menaxherë, pra një vajzë dhe ajo merret pothuajse me çdo gjë. Përzgjedhjen e intervistave, party-t, koncertet, festivale. Madje-madje edhe të veshja ime ndërhyjnë edhe pse e ka luftë të humbur (qesh). Ata që nuk e kanë, humbin kryesoren, qetësinë dhe qartësinë në përzgjedhje.

**Çfarë ka ndryshuar te ju, marrja e një çmimi të madh?**

Po e filloj mbase që te reagimet e njerëzve, në qoftë se me përpara njihesha vetëm në rrethin e muzikës live dhe klientelës së saj, sot kudo që kaloj ka reagime. Pas kësaj dhe përgjegjësisë e daljes në skenë dhe prezantimi për një këngë të re është rritur.

**Po këngës "S'je me" keni menduar që t'i bëni një klip?**

Oej kam t'i bëj një klip të thjeshtë, por jam duke menduar mundësitë.

**Ju studioni për...?**

Kam mbaruar para një viti Liceun artistik "Preng Jakova" për piano në qytetin tim të lindjes, në Shkodër dhe do të konkurroj këtë vit në Akademinë e Arteve për kompozicion, pasi vitin e kaluar vendosa ta bëja pushim që t'i përkushtohesha punës.

**A do të hiqnin dorë nga muzika, nëse do t'ua kërkonte njeriu i juaj i zëmërs?**

Duke menduar që njeriu i zëmërs duhet të të dojë e të të përkrahë për punën tënde, nuk besoj se do jem para një zgjedhjeje të tillë.

**Meqenëse po flasin për këtë temë, a ka një njeri special në jetën tuaj?**

Mbesa ime që lindi një javë pas fitores në "Top fest" apo nuk quhet?! Jo, nuk ka një njeri special në jetën time, pasi jam e fokusuar totalisht diku tjetër këto kohë e fundit. (Me shkurtime nga Koha e Jonë)



## Drekë intime me një burrë misterioz

Katie Holmes ka shkuar në një darkë intime me një burrë misterioz në fillim të javës që lamë pas, kanë thënë burimet e tabloidëve amerikanë. Aktorja – e cila së fundi u nda nga burri i saj, Tom Cruise është parë duke u përfqatur me një burrë të panjohur në një restorant. Lajmin për mediat e kanë bërë të ditur shokë të Katie që kanë dhënë edhe burimin për tabloidët amerikanë.



# A u martua Linda?

**Këngëtarja kosovare, Linda Halimi thuhet se është martuar në një ceremoni të fshehtë në Kosovë me amerikanin Davon Edwards, i njohur me nofken e tij, Big D. Portalet kosovare kanë shkruar se këngëtarja është martuar fshehtas.**

Prishtinë, 29 korrik - Këngëtarja Linda Halimi, e njohur më tepër për zërin e saj të mrekullueshëm dhe për interpretimet e saj të veçanta, thuhet se ka vendosur t'i japë fund beqarisë. Burime të afërta me këngëtarën kanë deklaruar se ajo është martuar me një ceremoni të vogël dhe të fshehtë në Kosovë. Linda Halimi, e pyetur për këtë nga portali IndeksOnline, nuk e ka pohuar, e as nuk e ka mohuar, martesën me Davon Edwards (Big D), duke mos dashur të japë detaje për publikun. Ajo vetëm theksoi se është duke kaluar momentet më të lumtura në jetën e saj. "Krejt çfarë mund të them

është se po jetoj ditët më të mira të jetës time, duke mos çarë aspak kokën se kush më marton, ndan, fejon, ose çka do tjetër. Unë jam artiste që për audiencën mund të ofroj vetëm muzikën time por jo dhe veten time. Jeta personale është tepër private dhe e rëndësishme për mua është ta jetoj për vete pa u dhënë të tjerëve detaje se pse i bëj ato që bëj. Privatësia ime është cenuar përtej limiteve dhe nuk me vjen keq nëse diskutohet për jetën time private në media", tha Halim për këtë portal. Ajo shtoi se bashkëpunëtorë për këtë gjë nuk do të jetë vetë. Linda Halimi mund të jetë shqiptarja e parë, e cila do të bëhet nuse amerikane.

Ajo kohëve të fundit ka qenë shumë në fokus të medieve kosovare për shkak të fejesës me Big D përderisa edhe Express ka tentuar që të flasë me këngëtarën gjatë së dielës, por kontakti më të ishte pothuajse i pamundur. Është martuar ajo jo Linda, këtë do ta shohim më vonë, edhe pse këngëtarja kohëve të fundit më shumë është e zënë me biznesin e saj privat në Prishtinë për dobësim. Ajo në fillim të këtij viti ishte fejuar me reperin Big D, ku edhe shumë kosovarë kishin dhënë komente, në disa raste edhe fyese, për këngëtarën fama e së cilës i kalon kujtë e Kosovës, pasi që ajo njihet mirë edhe në Ballkan për këngët e saj.

## horoskop



### Dashi

21 mars - 20 prill

Para jush është një periudhë e mbushur me plot sfida. Jeni të sigurt në atë që po e bëni, prandaj po veproni me qetësi të jashtëzakonshme. Kushtoni kujdes sasisë së alkoolit që jeni duke e konsumuar. Në lidhjen dashurore jeni duke menduar të bëni të bëni hapin vendimtar.



### Demi

21 prill - 21 maj

Pjesa e parë e javës do të ketë ndryshime të mëdha në planin afarist. Po jepni çdo gjë nga vetja, suksesi nuk do t'ju mungojë. Shmanguni situatave që ju shkaktojnë tensione dhe tubimeve të mëdha. Kot po përpigjeni të fitoni simpatinë e personit i cili për ju është tepër i rëndësishëm. Edhe aq më keq, mund të ndodhë që atij personi i qojë t'i duket argëtuese dhe mund të bëjë lojra me ju.



### Binjakët

22 maj - 21 qershor

Periudha e kaluar ka qenë e suksesshme për ju, ndonëse jeni ballafaquar me probleme të caktuara, më së shumti me eprorët tuaj. Shëndeti juaj është i shëkëtyeshëm, macje mund t'u jepni ndonjë këshillë edhe miqve. Lidhja juaj është stabile. Edhe pse kjo gjë ju bën të ndiheni të lumtur, mund të ndodhë që të dëshironit të ndryshonit diçka. Mos u frikësoni. Kjo ndjenjë është krejtësisht e natyrshme.



### Gaforrija

22 qer. - 22 korrik

Situata afariste po ju frikëson, sidomos ajo që po ngjan në punë. Është kohë krize, andaj edhe vendi yt i punës nuk do të kursehet nga tronditjet. Nëse ndieni ndonjë dhimbje apo ndonjë pengesë shëndetësore, është koha të shkoni te mjeku. Personin për të cilin keni ëndërruar një kohë të gjatë e keni parë duke u takuar me të tjerët.



### Luani

23 korrik - 22 gusht

Këtë javë mund të prisni që në planin afarist t'ju ndodhë diçka e bukur. Jeni duke notuar në ujëra të qeta. Puna po ju ecën sipas planifikimit të bërë. Shëndeti juaj varet nga ajo se çka konsumoni nga ushqimet, dhe ju fatkeqësisht po i konsumoni gjërat më të këqija. Jeni person i pavendosur.



### Virgjëresha

23 gusht - 22 shtat.

Sapo i keni përfunduar disa punë dhe keni menduar se do t'ia përkushtoni veten një pushim të merituar, atë që kanë situatë edhe më shumë. Temperaturat e larta ju shkaktojnë telashë shëndetësore. Kujdes këto ditë mos dilni pa ndonjë nevojë të madhe. Krejtësisht papritur jeni dashuruar në një person me të cilin punoni së bashku.



### Peshorja

23 shtator - 22 tetor

Në planin afarist jeni duke kërkuar një shans të ri. Edhe pse akoma nuk po arrini sukses, nuk do të thotë se duhet të humbni entuziazmin me të cilin i qaseni çdo bisedë që e bëni me partnerët afaristë. Hani më pak. Dhjami seriozitet rezikon shëndetin tuaj. E keni bindur veten se është koha që të filloni lidhjen dashurore me një person që po ju pëlqen.



### Akrepi

23 tetor - 21 nëntor

Këtë javë duhet të kujdeseni posaçërisht në organizimin e punëve dhe në respektimin e afateve. Jeni pak i brengosur për shkak të testeve që i keni bërë këto ditë. Nuk keni arsye. Ndaj partnerit jeni duke shfaqur xhelozitë pamatur. Këtë matje e ka vërejtur edhe partneri juaj. Mirëpo kjo gjë nuk e pengon edhe aq shumë.



### Shigjetari

22 nën. - 21 dhjetor

Jeni të kënaqur me punën që po e bëni. Po punoni mirë, mirëpo kini kujdes, sepse marrëdhëniet e këqija me një bashkëpunëtor mund t'ju shkaktojnë probleme të mëdha dhe të gjitha ato që i keni arritur t'ju shkojnë dëm. Keni nevojë për aktivitete më të mëdha fizike. Jeni duke u përpjekur shumë që një person t'ia bëni me dije se e dashuronit. Taktika e këllë është plotësisht e gabuar.



### Bricjapi

22 dhjetor - 20 janar

Në punë, sikur edhe në dashuri, duhet të bashkëpunoni me persona stabile dhe të sigurtë, me persona të cilët në çdo çast mund të gjeni mbështetje. Ajo që aktualisht do t'ju përshtatet organizimit tuaj është një pushim i gjatë dhe i këndshëm. Jeni person tepër i durueshëm dhe sistematik. Këto karakteristika tuaja mund të bëhen problem në lidhjen tuaj dashurore.



### Ujori

21 janar - 18 shkurt

Përdoreni autoritetin që e keni krijuar te bashkëpunëtorët tuaj. Ju dini se si të punoni me të tjerët. Kjo është njëra ndër karakteristikat tuaja. E keni ngarkuar veten më tepër se ç'është me gjendjen tuaj shëndetësore. Është më i mirë seç po mendoni. Keni gjasa të mira që të krijoni një lidhje dashurore me një person me të cilin tashmë një kohë të gjatë po punoni bashkë.



### Peshqit

19 shkurt - 20 mars

Është çasti i fundit që t'i përmirësoni raportet me bashkëpunëtorët. Ka shumë mënyra që të ruani kondicionin fizik. Vrapimi, vozitja e biçikletës, shëtitja në natyrë, ushtrimet në sallë, fitness. Një person, nga i cili as që e keni pritur, po ju dërgon shenja se është i gatshëm të fillojë me ju një lidhje të zjarrtë dashurore.

# shkurteshqip

Shkurt e shqip / e-mail: shkurteshqip@gazetaexpress.com  
tel: 038 76 76 76, fax: 038 76 76 78 adresa: Dardania 1/1, Prishtinë

» Komentet e lexuesve në Express Online

Express, 29 korrik 2012

## » Parashikimet e Kuçit



### Gjilani

Ani Hajredin. Faleminderit. A është e sigurt?

### Kadir

Çka po thotë horoskopi o Hajredin!

### Bleta

Institucionet e luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar por jo të vetin gjithnjë të të tjerëve.

### Topi

Kërkoj nga gazeta Express ta publikojë dekarimin e Hajredin Kuçit sa ishte i papunë çka ky deklaroi para një grupi studentësh, citoj: "Se do isha i lumtur po nëse arrihet liberalizimi i vizave para 2022". Unë s'i kuptoj këta njerëz të paskrupullt sa janë të papunë e tregojnë realitetin e Kosovës politike zhvillimit të saj dhe ecjeve sociale, ekonomike dhe politike. E si të kthehen prapë në qeveri apo bëhen pjesë e qeverisë gënjejnë aq shumë sa që turpi i tyre nuk i lë as të skuqen para popullit dhe familjarëve të vet. Ky aq shumë gënjen sa një profesor i drejtësisë duhet ditur se gënjeshtret janë të dënueshme me ligj, sidomos kur janë në pyetje çështjet shtetërore. Cilat pushtetar të Kosovës po i dalin fjalët apo premtimi në fund, e vëmë vëmë tek ta është kostoja e lartë e harxhimeve të tatimpaguesve.

### Pogragja

E dimë krejt Kosova këtë lajm o Hajredino, flm për informim bile ne popullin e dimë se në vitin 2013 do të na premtohet liberalizimi për vitin 2014 e kështu me radhë. Lum Kosova që ka kësi ministra e kryeministra...

### Mjeshtri

S'po di a mi besu, kur jepi dorëheqje pat thënë do të ndihesha i kënaqur nëse e arrimë ato në vitin 2016.

### BARDHI

Kur u largua nga qeveria Kuçi tha: Kosova vështirë se deri në vitin 2020 do të anëtarësohet dhe udhëtimi pa viza vështirë se mund të realizohet së shpejti. Ne kundërshtim me deklaratat e veta ka ra kësaj radhe.

### BEKIMI

Me këto ëndrrat e tua mos je ka mendon që po të ftojnë në Bruksel mu bo najfar këshilltari për çështje juridike, a është e frikshme kjo ëndërr?

### Aferdita

Po ti je parashikues, se ti kur ke dhënë dorëheqje e ke ditur se ki mu kthy, veç neve nuk na e ke thënë.

### Nokia

Po jap dorëheqje po shkon në pushime nja 9 ditë apo 10 po kënaqet me familje, e populli po do me falimentu totalisht, e populli veç rri këqyr sehir. O Popull zgjohuni, sepse ka kush ju udhëheq.

### Neli

O zoti Kuçi. a nuk po ki turp tash me dal me na rrejt a mendon se është kah të beson dikush, a hajmedet haj!

### Felix

Mos more Kuçi se i le fallxheshat pa punë, deri sa ato e shohin fatin e jetërit në pëllëmbë të dorës, jam kurioz ta di ti ku po e sheh fatin e Kosovës?

### » Sqarim

■ Opinione e botuara në rubrikën "Shkurteshqip" nuk shprehin qëndrimet e redaksisë.

Express

# Sanduiç

## EDMOND TUPJA

Ja, pra, edhe një tjetër fjalë e huazuar nga anglishtja, sandwich: dy feta buke, midis së cilave vendosen ushqime të ftohta (proshutë, mish, sallam, djathë, sallatë etj.), me ose pa salcë kosi, mustardë, keçap etj.). Kjo fjalë, kaq e përdorshme dhe e përdorur sot gati nga të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare (disa e shqiptojnë si anglezët, sanduiç, të tjerë si amerikanët, senduiç), ende nuk figuron në Fjalorin e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006. Gjënë "sanduiç" e kam njohur që në fëmijërinë time të hershme: nëna më përgatiste gjithmonë, që t'i haja gjatë pushimit të madh të Shkollës së Kuçit, dy feta bukë me vaj e sheqer, ose, në rastin më të mirë, me gjalpë e thërrime djathi, të cilat më shjolinin shumë, pavarësisht se as ime më, as unë nuk e dinim që quheshin sanduiç. Por, cila është prejardhja e fjalës "sanduiç"? Kjo fjalë angleze daton që nga viti 1762 dhe vjen prej emrit të kontit Sandwich, kumarxhi i pandreqshëm, kuzhinieri i të cilit shpiku këtë mënyrë të ushqyeri me të vetmin qëllim që t'i krijonte të zotit mundësinë të hante diçka pa u larguar nga tryeza ku luante bixhoz. Fjala "sandwich" nisi të përdorej në Francë në vitin 1802, kurse në vitin 1881, po në Francë, nisi të përdorej shprehja "homme-sandwich" – që dikur është shqipëruar me shprehjen "njeri-reklamë", por që mund të rishqipërohet me shprehjen "njeri-sanduiç" –, në kuptimin "njeri që shëtit rrugëve me dy postera publicitarë, njërin mbi gjoks, tjetrin mbi shpinë".

Duke i kërkuar ndjesë lexuesit të rregullt, të vëmendshëm e të paanshëm të kësaj rubrike që u zgjata pak si shumë me prejardhjen e fjalës "sanduiç", po nxitoj ta vendos e ta aktualizoj këtë fjalë në kuadrin e jetës politike shqiptare: Çdo ditë e më shumë bindem se po shtohet numri i bashkatdhetarëve të mi që po kthehen, jo rrallëherë pa e ditur as vetë, në njerëz-sanduiç. Për këtë u ndërgjegjësova vite më parë gjatë një fushate për zgjedhjet në Parlament. Asokohe, nga një burim i mirinformuar, por shumë konfidencial, mora vesh se, gjatë asaj fushate, disa biznesmenë po finanonin njëkohësisht edhe Partinë Socialiste, edhe Partinë Demokratike. Përlogaritja e tyre ishte më se e qartë: cilado parti të fitonte shumicën parlamentare, pra, të qëndronte apo të vinte në pushtet, ajo do t'ua shpërblente në njëfarë mënyre të gjithë atyre që e kishin financuar gjatë fushatës në fjalë. Këta lloj biznesmenësh luanin kështu rolin e njeriut-sanduiç, veçse nuk i bënin reklamë të njëjtit produkt,

por dy produkteve të ndryshme, për të mos thënë të kundërta, çka binte pak erë oportunist. Në fakt, nuk duhet të çuditemi me këtë dukuri moralisht jo fort të shëndetshme: A nuk pati gjatë pushtimit otoman fise apo familje shqiptare, nga pjesëtarët e të cilave disa mbetën të krishterë e disa të tjerë – vëlla, kushëri, krushk etj., etj. – përqaftuan fenë e pushtuesit? A nuk pati gjatë Luftës së Dytë Botërore fise apo familje shqiptare, nga pjesëtarët e të cilave disa u bashkuan me komunistët e disa të tjerë – vëlla, kushëri, krushk etj., etj. – me ballistët apo zogistët? A nuk pati e ka ende sot, me vendosjen dhe konsolidimin e demokracisë të ne, fise apo familje shqiptare, nga pjesëtarët e të cilave disa u radhitën politikisht djathas e disa të tjerë – vëlla, kushëri, krushk etj., etj. – majtas? Madje, praktika tregon dhe dëshmon se disa nga partitë e vogla sillen natyrshëm si njerëz-sanduiç duke kaluar sa nga njëri krah politik në tjetrin, por gjithmonë me kahe drejt krahu fitimtar, duke synuar kështu të përfitojnë të paktën ndonjë post ministror. Shkrimtari Ismail Kadare e përshkruan fort bukur këtë tip njeri-sanduiç oportunist e pa karakter të romani "Kronikë në gur", në mos gabofsha, kur flet për një girokastrit me emrin Jorgo Pulaj, i cili, kur qyteti i tij lindes u pushtua nga trupat fashiste italiane në vitin 1939, nxitoi ta ndryshonte emrin e mbiemrin duke u vetëquajtur Xhorxo Polo; kur grekët e pushtuan Gjirokastrën gjatë Luftës Italo-Greke, ai nuk vonoi të vetëquhej Jorgos Pulos; me ardhjen e nazistëve gjermanë, emri i tij u shndërrua menjëherë e krejt natyrshëm në Jurgen, por, shton shkrimtari i madh, ky zotëri kishte edhe një emër rezervë në rast pushtimi japonez: Jogura!

Së fundi, duke pasur parasysh këtë talent të veçantë të shumë e shumë shqiptarëve për të luajtur rolin e njeriut-sanduiç, madje multisanduiç (kujdes, i nderuar lexues, se mos nuk e shqipton dallueshëm shkronjën "I" të kësaj fjalës së fundit!), po marr guximin për t'i sugjeruar Ministrisë së Punës, së Çështjeve Sociale e të Shansëve të Barabarta të marrë tërë masat e nevojshme për të hapur sa më shumë vende pune për çdo lloj publiciteti, të vërtetë e të rremë, të ndershëm e të pandershëm, fisnik e vulgar, çka do ta ulë aq ndjeshëm numrin e të papunëve në Shqipëri sa që, pavarësisht krizës botërore që po përjetojmë, edhe vendet më të zhvilluara do të na kenë përzemërsisht zili!

(Panorama)



## Fjalët e Botës

“ Shqipëria ka bërë tregti armësh me kriminelë.”



**ILIR GJONI,**  
Nënkryetari i Komisionit të Parlamentit të Shqipërisë për Siguri, i cili u shpreh se Shqipëria ka bërë tregti armësh me tregtarët me të errët të kriminit në botë.

“ Assadi duhet të gjykohej për krime të luftës.”



**ABDULLASET SAYDA,**  
Kryetar i Këshillit Kombëtar të Sirisë në mërgim, i cili tha se presidenti sirian, Bashar Al Assad, duhet gjykuar për masakrat kundër popullit të kryera në Siri.

“ Izraeli nuk është njoftuar nga SHBA-ja për planin për të sulmuar Iranin.”



**NJË ZYRTAR ANONIM IZRAELIT,**  
I cili mohoi shkrimin e gazetës "Haaretz" se këshilltari për siguri kombëtare i Barack Obamës ka njoftuar kryeministrin izraelit, Netanyahu, me planin për të sulmuar Iranin.

# Ban Ki Moon në Kosovë – asgjë më shumë se kujtesë për problemet serioze të vendit

**Andrew MacDowall**

Vizita e Ban Ki Moon në Kosovë të martën është e para e një Sekretari të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, që nga koha kur shteti i vogël shpalli pavarësinë e vet të kontestuar në vitin 2007. Vizita ishte kundërtënëse dhe duket e pagjasë që do të sjellë ndonjë zgjidhje të shpejtë të çështjes së sovranitetit të Kosovës. Por të paktën i kujton botës se ky vend, bashkë me problemet e tij serioze, ekziston.

Vizita ishte pjesë e një turi më të madh në Ballkanin Perëndimor – Ban ishte në Beograd të hënën dhe në Slloveni më 20

korrik. Ai është, të paktën në letër, duke vizituar Kosovën për të kontrolluar prezencën e atjeshme të OKB. Kjo në fakt është e pa ndonjë rëndësi këto ditë, sepse misioni i OKB në Kosovë, UNMIK, ia kaloi shumicën e përgjegjësisë të tij misionit të BE, EULEX, dhe autoriteteve kosovare. UNMIK tani është aty sa për të informuar zyrat qendrore të OKB për ngjarjet në rajon.

“Nuk ka pritshmëri të mëdha rreth kësaj vizite”, tha Krenar Gashi, drejtor ekzekutiv i Institutit të Politikave të Zhvillimit një think-tank me qendër në Prishtinë. “Por mund të ndihmojë që Kosova të ketë

edhe njëherë vëmendjen e botës”. Ndërkohë që shumica e globit mund të ketë pushuar së menduari rreth Kosovës, Serbia natyrisht nuk e ka bërë këtë. Pozicioni i saj thellësisht i çuditshëm rreth asaj që ajo e konsideron si provincë e shkëputur, mbetet i pandryshuar.

Ivica Daciç, kryeministri i zgjedhur i Serbisë, ka pranuar se raportet me Kosovën janë pengesa kryesore që ndalojnë fillimin e bisedimeve për anëtarësim të Serbisë në Bashkimin Europian, gjë të cilën qeveria e tij në pritje ka synim të nisë nga fundi i vitit. Ai bashkë me presidentin Tomislav

Nikoliç, një ish-ultranacionalist i cili tani predikon rëndësinë e anëtarësimit në Bashkimin Europian, kanë dhënë shenja gatishmërie për të vazhduar negociatat me palën kosovare dhe për të implementuar marrëveshje në fusha të ndryshme. Kjo pavarësisht faktit se të dy ata ishin të lidhur ngushtë me Slobodan Millosheviçin, i cili hapi luftë në fund të viteve '90 në përpjekje për ta mbajtur Kosovën si pjesë të Serbisë.

Megjithatë, Serbia nuk ka gjasa që ta njohë qeverinë e Kosovës në të ardhmen e afërt. Siç nuk do bëjnë edhe mbështetësit e saj Moskë dhe Pekini. Siç Daciç

i tha radios gjermane Deutsche Welle së fundi: “Ne duhet ta organizojmë planin tonë në lidhje me Prishtinën në një mënyrë që nuk vë në rrezik lëvizjen tonë drejt Bashkimit Europian dhe në një mënyrë që Serbia nuk është e detyruar të njohë Kosovën dhe Metohinë si një shtet i pavarur”.

Sidoqoftë Gashi një kritik i qëndrimit të Beogradit në lidhje me Kosovën është skeptik. Ai nuk pret ndonjë lëvizje serioze sa i takon hapave për anëtarësim të Serbisë në Bashkimin Europian në afat të shkurtër dhe shqetësohet se qeveria e re serbe do të jetë edhe më pak “negociatore” sesa paraardhësjë e saj.

# Greçia ka vetëm pak javë për të bindur kreditorët, përndryshe 'Grexit'

**The Economist**

Gjatë vizitës së tij në Athinë këtë javë José Manuel Barroso, kreu i Komisionit të Bashkimit Europian, i dha një paralajmërim të fortë Antonis Samaras, Kryeministrit të ri të qeverisë së një koalicioni jo dhe aq të qëndrueshëm mes së majtës e së djathtës. Greçia ka vetëm dy javë për të bindur kreditorët e saj se mund të fusë në shina reformat ekonomike. Nëse planet e saj të fundit për një paketë shkurtimesh në shpenzime prej 14.5 miliardë eurosh përgjatë dy viteve të ardhshme do të gjykohej

jo realiste, kredia e radhës prej 31.2 miliardë eurosh do të vihet në pauzë.

Nëse ndodh kjo, Greçia nuk do të jetë në gjendje për të përfunduar rikapitalizimin e bankave të saj të mëdha. Pa kredi ekonomia do të bllokohet. Pensionet dhe rrogat e sektorit publik nuk do të paguheshin. Një 'Grexit' (dalje e Greqisë) nga zona euro do të pasojë brenda pak javësh. Shqetësimi i grekëve është se kur Spanja e Italia do të vihen nën trusninë e tregjeve financiare, disa anëtarë të eurozonës mund të tundohen për të sakrifikuar Greçinë.

Dy qeveri të mëparshme greke

dështuan paq që nga mesi i vitit 2010 për të zbatuar reformat me të cilat u ra dakord me Komisionin Europian dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar falë korrupsionit të zgjeruar zyrtar dhe mungesës së një vullnetit politik. Z. Samaras ndërsa ishte në opozitë ishte kundër paketës së parë të ndihmës; ai do të sërish, në njëfarë pike, të rinegociojë pjesë të paketës së dytë.

Yannis Stournaras, ministri teknikrat i Financave, ka detyrën e vështirë të bindjes së kreditorëve të Greqisë se qeveria e tij është me e mirë se paraardhëset. Trojka e zyrtarëve nga Bashkimi

Europian, Fondi Monetar Ndërkombëtar, dhe Banka Qendrore Europiane ishin posaçërisht të pakënaqur me një hendek prej 3 miliardë eurosh në të ardhurat nga privatizimet si dhe nga mungesa e progresit në shkurtimet e vendeve të punës në sektorin publik.

Pak pas mbërritjes së trojkës më 25 korrik z. Stournaras shpalli krerët e rinj të Agjencisë së Privatizimeve. Antonis Maniatakis, ministri i Administratës Publike, shpalli se pesë njësi të sektorit publik do të mbyllen menjëherë, ndërkohë që 16 të tjera u 'unifikuan' me departamente të tjera.

Pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë punonjësit e tyre do të dalin në pension ose do të transferohen në punë të tjera. Kjo është ende shumë larg 15 mijë shkarkimeve nga puna për vitin 2012, për të cilat pat rënë dakord qeveria paraardhëse. Kursimet vjetore nga kjo do të jenë në shumën modeste të 40 milion eurove. Z. Maniatakis premtim edhe 1800 'unifikime' të tjera me kursime shumë të mëdha, brenda javësh. Sindikata e shërbimeve civile ndërkohë ka kërcënua me grevë. A do t'i shohin këto masa si të mjaftueshme z. Barroso dhe trojka?

## 5 ditë pa Ty



# Avni Kuqi

(1974-2012)

Ti ishe shumë i ri për t'i thënë lamtumirë kësaj Bote, por vdekja të mori aksidentalisht.

Çfarëdo që shkruajmë për Ty Avni, është pak sepse T'i kishe aq të mira, sa që nuk ka fjalë që të përshkruhen.

Ishe shembull për gjithçka.....

Ti do të mbetesh gjithmonë në mendjet dhe zemrat tona.

***Të kujtojnë me mallë: Sahit Krasniqi, Ilmi Krasniqi, Fevzi Krasniqi, Avni Krasniqi, Valmir Krasniqi, Asdren Krasniqi si dhe kolegët nga Molitoria dhe IFA: Tafili, Islami, Besimi, Fatmiri Gzimi, Burimi, Meli, Kameri. Bedriu, Zeqa, Hamiti, Nurija, Myrveti dhe Egazona.***

## PALUAJTSHMËRI

## SHITJE

■ Shes banesën në "Dardani", kati i V, 45m2, e mobiluar, me dokumentacion të rregullt, çmimi fiks 43.000 €. Poashtu në rr.UOQ-së, "Qafa" banesa 87m2, 2 dhoma gjumi, 2 banjok, çmimi 900 € për m2. Tel:044/283 352. (30-01.08.2012)

■ Shitet banesa në lagjen Emshir pranë restorantit Garden, banesa është ndërtim i ri, quhet Banesat të Konakut. Banesa është në katin e V, madhësia 86m2, ka 2 dhoma gjumi, salon, posedon lift dhe ne katin përderis gjendet çerdhja për fëmijë + oborri i rregulluar me stil evropian ka edhe bazenë për lagje. Çmimi 900 € për m2. Tel:044/163 199. (30-01.08.2012)

■ Pa ndërmjetësim nga pronari shiten këto lokale në Prishtinë: Shitet Lokali-përderis ekstra i rregulluar, në udhëkryqin e Bulevardit "Bill Clinton" -Dardani-Prishtinë, në sip. prej 30m2 (faktike 33m2) me gjelbërim para lokalit rreth 10m2. Çmimi 110.000 €. Shitet banesa e shndërruar në Zyre në Rr.Luan Haradinaj 7-Prishtinë, (përballë Stacionit të Policisë 92) Kati i II mbi agjencionin "ALTA VIA", në sip. faktike prej 120m2. Çmimi 185.000 €. Shitet Lokali përderis në qendër përballë ish selisë së UNMIK-ut / selia e EULEX-it dhe përballë Grand Hotelit në sip. prej 65m2. Çmimi 175.000 €. Këto lokale/zyre janë në qendër të Prishtinës, krejtësisht të rinovuara. Tel: 044/ 872 014. (30-04.08.2012)

■ Shes banesën në lagjen e Spitalit. Banesa është në përfundim-çelsat merren me sip. 100m2, kati i 5-të, ka lift dhe ujë 24 orë. Ka edhe garzhin, shkollën fillore e ka shumë afër. Çmimi i vulltshëm. Page-sa me marrëveshje. Tel: 044/ 163 199. (28-30.07.2012)

■ Shitet banesa pranë Komunës së vjetër në Prishtinë. Banesa është me leje ndërtimi, kati i parë. E gatshme për banim, ka 73m2, posedon lift. Çmimi shumë i vulltshëm. Banesa ka 2 dhoma gjumi dhe sallon të madh, e pa mobiluar, ka banjoh dhe ballkon. Tel: 044/ 163 199. (28-30.07.2012)

■ Shitet banesa dy dhomshe, 63m2 ndërtim i ri në Bregun e Diellit përballë banesave të Standardit, çmimi 40.000 €. E mobiluar në mënyrë solide. Tel:044/234 363. (28-30.07.2012)

■ Shes banesën tredhomëshe në lagjen Kodra e Diellit, afër objektit Princësia, me sip.74m2, kati i 3-të. Banesa ka dhomë dite me kuzhinë, 2 dhoma të fjetjes, shpajz, banjoh, korridor dhe ballkon. Ndërtim i ri, me leje ndërtimi, e gatshme për banim. Çmimi 59.000 €. Tel: 044/ 245 454; 038/ 248 165. (25-30.07.2012)

■ Shes banesën tredhomëshe në Fushë Kosovë afër Qerdhës së vjetër, me sip.85m2, në katin e parë. Banesa ka dhomë dite me kuzhinë, 2 dhoma të fjetjes, terasë, shpajz, banjoh dhe korridor. Banesa është në ndërtim e sipër dhe përfundon në dhjetor 2012. Çmimi 39.000 €. Tel: 044/ 245 454; 038/ 248 165. (25-30.07.2012)

■ Shes banesën tredhomëshe në Aktash afër OSBE-së dhe Klinikës Gjermane të Syve, me sip.90m2, në katin e V-të. Banesa ka dhomë dite me kuzhinë dhe terasë, korridor, shpajz dhe banjoh. Ndërtim i ri. Çmimi 72.000 €. Tel: 044/ 245 454; 038/ 248 165. (25-30.07.2012)

■ Shiten 12 ari truall në Fushë Kosovë, me infrastrukturë dhe dokumentacion të rregulluar. Tel: 045/ 389 522, 049/ 550 244. (19-02.08.2012)

■ Shesim banesën 60m2 në Ulpianë -Prishtinë D9 H8 Nr.16, kati i 4-të. Me dy dhoma fjetjeje plus sallon. Çmimi fillestar 80.000 €. Tel: 045/ 437 367. (18-31.07.2012)

■ Agjensioni për Patundshmëri Kosova Immobiliën, bën ndërmjetësim në shitblerje dhe qiradhënie, si: BANESA, SHITEPI, TROJE, LOKALE AFARISTE, etj. Gjithashtu nëse keni pronë për të shitur apo për qiradhënie, ju ftojme për bashkëpunim. Mund të na kontaktoni: tel: 044/ 245 454, 038/ 248 165. kosovaimmobiliën@ipko.net; www.kosova-immobiliën.com (10-10.08.2012)

## BLERJE

■ Blej lokal ose banesë përderis në Prishtinë. Lokali ose banesa duhen të jenë në lagjet:rr. Luan Haradinaj, Fehmi Agani, UQK, Nëna Tereza, Agim Ramadani, Bill Clinton, në Ulpianë të Aleanca dhe Ulpianë përballë Spitalit.Lokali ose banesa paguhet me kesh.Tel:044/283 352. (30-01.08.2012)

## ME QËRA

## LËSHOHEN

■ Lëshohet banesa me qira në Qendër të qytetit.1)Përballë policisë, 1dhomshe, kati i III, lëshohet për një çift, çmimi 250 €. 2)në Qendër rr.UOQ-së, banesa ndërtim i ri, 2dhoma gjumi, sallon dhe kuzhinë 300 €. 3)Banesa te Sllovenia Sporti, 2dhoma gjumi, garazhë, çmimi sipas marrëveshjes.Tel:044/283 352. (30-01.08.2012)

■ Lëshohet banesë me qira në Bregun e Diellit I (përballë ambullantës). Banesa është dy(45m2) dhomshe e rinovuara dhe e mobiluar, çmimi 220 €.Tel:044/148 564. (30-01.08.2012)

■ Lëshohet me qira 1 dhomë e shtëpisë të "Qafa" hyrje e veçant për studenta ose të punësuar (meshku). Tel:044/555 625. (30-01.2012)

■ Lëshohet banesën me qira me çmim të arsyeshëm, posedon dhomë dite, kuzhinë, 2 dhoma gjumi, ballkon, banjoh, garazhë për veturë dhe depo. E mobiluar me mobilje të reja dhe shumë elegante, kati IV, me ashensor.Lagjia e Spitalit rr:"Muharrem Fejza".Preferohen familjar ose ndërkombëtar për afat të gjatë.Tel:044/149 660. (30-01.08.2012)

■ Lëshohet banesën me qira në Ulpianë. Banesa ka dy dhoma gjumi, një dhomë dite me kuzhinë. Banesa është e mobiluar me mobilje luksoze. Preferohet për çifte dhe familjar. Tel:049/600 512;045/285 539. (30-01.08.2012)

■ Lëshohet një dhomë me korridor, banjoh posedon në kënd kuzhinën me të gjitha pajisjet, tresh, dysh, tavolinë.Shtëpia gjendet në lagjen e Spitalit afër Eulex-it. Mund të telefononi prej orës 10 mëngjes deri në 19 mramje.Tel:044/164 022;049/394 556. (30-01.08.2012)

■ Lëshohet lokalim me qira në Bregun e Diellit-Qendra Tregtare nr.25, është i përshtatshëm për butik, atele, kafiteri, pastiqeri etj.Çmimi 600 €, në muaj dhe çdo 6 muaj ka zbritje.Tel:044/184 768. (29-03.08.2012)

■ Lëshohet shtëpinë me qira.Shtëpia ka 1 dhomë gjumi, kuzhinë, korridor dhe banjoh.Shtëpia është e pajisur me mobilje krejtësisht të reja. Gjendet afër tregut të gjelbër në Prishtinë ose afër Hotel Sara-ish Bihazit.Tel:038/229 191; 044/346 086. (29-07.08.2012)

■ Lëshohet me qira banesën në lagjen Bregu i Diellit, te Oaza ose Posta e Vogël. Banesa është e mobiluar dhe gjendet në katin e dytë, rreth 45 metra katrorë. Çmimi: 200 euro. Tel: 044/49 42 52 80 dhe 044 545 138. (29-31.08.2012)

■ Lëshohet me qira banesën në Prishtinë pranë Komunës së vjetër, prapa Pro-Credit Bank. Madhësia: 2 dhoma gjumi, sallon, e mobiluar me mobilje ekstra. Si dhe dy banesa në Bregun e Diellit, të mobiluara super. Tel: 044/ 163 199. (28-30.07.2012)

■ Lëshohet me qira dy banesa te teatri "Dodona", njëra në katin e parë dhe tjetra në katin e dytë,banesat posedojnë nga dy dhoma gjumi,dhomë dite,kuzhinë dhe janë në tërësi të mobiluara në mënyrë moderne,çmimi 350 euro (I diskutueshëm). Lëshohet me qira banesa në Dardani afër bulevardit "Bill Clinton",banesa posedon një dhomë gjumi,dhomë dite,kuzhinë të veçantë dhe është në tërësi e mobiluar,çmimi 270 euro.Tel:044/670 608. (28-30.07.2012)

■ Lëshohet banesën me qira një dhomëshe të mobiluar. Banesa gjindet afër Hotelit Grand. Tel:044/651 074. (28-30.07.2012)

■ Lëshohet banesën me qira. Banesa gjendet te Qafa afër pompës së benzinës, është dydhomshe, e re dhe e mobiluar. Tel: 044/ 888 611; 049/ 805 050. (28-02.08.2012)

■ Lëshohet banesë me qira në Lakërishtë, në katin e 3-të, me dy dhoma gjumi, kuzhinë dhe banjoh. Lifti punon. Tel: 044/ 332 640. (28-02.08.2012)

■ Lëshohet me qira banesën dydhomshe në Ulpianë, kati i parë. E mobiluar, me ngrohje qendrore. Lëshohet për pushime sezonale dhe afatgjatë. Tel: 044/ 292 721. (27-01.08.2012)

■ Banesa për qiradhënie në Prishtinë në lagjet: Ulpianë 1 dhomëshe (garsonierë) kati 1, 240€; 1 dhomëshe (garsonierë) kati 3, 300€; 2 dhomëshe kati përderis 50m2, 300€; lagja Aktash 1 dhomëshe kati 2, 200€; 2 dhomëshe kati 5, 250€; 2 dhomëshe kati 1, 300€; 2 dhomëshe kati 6, 300€; 2 dhomëshe kati 4, 350€; 3 dhomëshe kati 4, 440€; lagja Bregu Diellit 2 dhomëshe kati 2, 250€; 2 dhomëshe kati 3, 200€. Tel: 044/ 44 33 49, 038/ 248 165. (26-31.07.2012)

■ Lëshohet banesat me qira: Njëra banesë është e mobiluar, ka 1 dhomë gjumi dhe 1 dhomë dite me kuzhinë, kati i parë. Ndërsa banesa tjetër është e pamobiluar, me 1 dhomë gjumi, 1 dhomë dite me kuzhinë, tarracë, kati i parë. Banesat gjenden në Mati I, Rr. "Muharrem Fejza". Tel: 044/ 292 173. (26-31.07.2012)

■ Lëshohet dy dhoma me qira me hyrje të veçantë. Të mobiluara. Tel: 038/ 220 692, 044/ 605 340. (26-31.07.2012)

■ Në Ulpianë te AAK -ja, lëshohet banesë me qira 40m2. Komplet e mobiluar dhe e rinovuara. Lëshohet edhe për pushime verore. E gatshme për banim. Tel: 044/ 255 873, 049/ 688 502. (26-31.07.2012)

■ Banesë me qira në lagjen Bregu Diellit (pranë qendrës tregtare), kati 3. Banesa është e rinovuara në të gjitha elementet dhe është me cilësi të veçantë, ka dhomë dite, dhomë gjumi, kuzhinë, banjoh, korridor dhe tarracë. Marrëveshja bëhet me kontratë dhe për qëndrim të gjatë, çmimi 350 €. Jap me qira 9 banesa te parku i qytetit afër

ish S.Sport. Banesat janë të reja me cilësi të veçantë ndërtimi, ambienti dhe vendndodhje, me 1, 2, 3 dhoma gjumi. Të përshtatshme për familjar apo ndërkombëtar. Marrëveshja bëhet me kontratë dhe për qëndrim të gjatë. Çmimi për banesë me 1 dhe 2 dhoma gjumi 320 €, çmimi për banesë me 3 dhoma gjumi 380 €. Jap me qira 2 lokale dhe 28 zyre afariste në Prishtinë, afër ish S.Sport. Lokali përderis është me madhësi 233m2, tjetri në katin 1 po ashtu 233m2, 28 zyret gjenden me madhësi të ndryshme në katin 2,3, 4, me gjithsej 12 banjoh, ka ashensor dhe alarm. Lokalet dhe zyret janë të cilësisë së lartë. Ideal për biznes. Marrëveshja bëhet me kontratë dhe për qëndrim të gjatë, çmimi sipas marrëveshjes. Po ashtu jap me qira objektin në Prishtinë afër ish S. Sport me madhësi 1400m2. Objekti është i ri modern 4 katësh, ka katin përderis dhe podrumin, ka nx. qendrore, ashensor, i kompletuar me të gjitha, vendparkim për 10 makina, ujë e rrymë 24h, alarm etj. I përshtatshëm për ushtrimin e të gjitha veprimtarive. Çmimi sipas marrëveshjes. Marrëveshja bëhet me kontratë dhe për qëndrim të gjatë. Pa ndërmjetësim drejtpërdrejt me pronarin. Tel: 044/ 843 926. E-mail: lepia11@hotmail.com. (26-31.07.2012)

■ Lëshohet banesë me qira të rregulluar ekstra, te Simfonia në Ulpianë, si dhe në Qendër te Grand Hotel. Banesat janë të përshtatshme edhe për çifte. Tel: 044/ 500 791. (23-31.07.2012)

■ Agjensioni "Megi", lëshon banesa, shtëpi, lokale si dhe objekte të ndryshme me qira, për ndërkombëtar dhe vendor, në Prishtinë. Po ashtu bën edhe shitjen e banesave të reja dhe të vjetra, lokaleve, trojeve, në Prishtinë dhe Fushë-Kosovë. Gjithashtu ju mundëson të ofroni banesat, shtëpitë, lokalit për qiradhënie dhe shitje. Agjensioni gjendet në Dardani Kroj i Bardh lokalit nr/94. Tel: 038/ 555 003, 044/ 464 936, 040 613, 044/ 425 185 apo në e-mail: agencymegi@hotmail.com. (06-06.08.2012)

■ Në qendrën e re tregtare "Dardania" (ish Novi Domi), lëshohet një lokal me qira, me sip. 50m2. Lokali lëshohet nga data 01.07.2012. Tel: 044/ 307 279. (04-04.08.2012)

## KËRKOHEN

■ Kërkoj vend pune për përkujdesje për fëmijë të vegjël, kam përvojë se jam nënë e 3 fëmijëve të mi.Jam nënë 50 vjeqare qytetare nga Prishtina. Kam punuar edhe më herët në këtë drejtim.Tel:044/476 500. (28-30.07.2012)

■ Kërkoj urgjentisht banesë për një familje te "Sllovenija Sport",banesa duhet të ketë dy dhoma gjumi,dhomë dite,kuzhinë dhe të jetë në tërësi e mobiluar me kushte cilësore për banim,çmimi deri në 350 euro.Tel:044/301 283. (28-30.07.2012)

■ Kërkojmë banesa luksoze, kat shtëpisë dhe shtëpi komplete (me oborr) me qira, për ndërkombëtar, për afat të gjatë dhe të shkurtë. E-mail: yrea@live.com ose në tel: 044/ 550 111. (25-08.08.2012)

## VETURA

■ Shes Opel Vektra, viti i prodhimit 1993, 140.000 ka të kaluara, ngjyrë vishnje, auto matik. I regjistruar deri më 2013, në gjendje shumë të mirë. Tel: 044/049/ 283 352. (30-01.08.2012)

■ Shes veturën Mini Cooper 1.6. benzin, viti 2003.Tel: 044/049/ 253 437. (26-30.07.2012)

# Sport

redaktor: al det asani  
e-mail: al.det.asani@gazetaexpress.com  
tel: 038 76 76 76 fax: 038 76 76 78

## Suspendohet Galiulina, pozitive në anti-doping

Gjmnastja Luiza Galiulina është suspenduar nga Olimpiada e Londrës, pasi ka rezultuar pozitive, në testin e anti-dopingut. Sportistja nga Uzbekistani rezultoi pozitive edhe në testin e dytë, të bërë të dielën. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar tha se Galiulina, e cila nuk kishte shpresa për medalje, kishte përdorur mjete të ndaluara, të cilat u zbuluan pas kontrollit urivor në Londër, që iu bë të mërkurën. 20 vjeçarja

ishte dashur të garonte në kualifikimet e së dielës në gjmnastikë, por testi B ia mohoi një gjë të tillë dhe ajo do të rikthehet në shtëpi. Galiulina e kishte fituar medaljen e bronzit në tufën e balancuar në Lojërat e Azisë, më 2010. Kjo ishte pjesëmarrja e saj e dytë në Olimpiadë, pasi kishte përfunduar në pozitën e 60-të në vitin 2008. IOC ka njoftuar se Galiulina pretendon se nuk kishte përdorur mjete të ndaluara dhe se

nuk ia kishte idenë për këto produkte. Ajo kishte thënë se ka përdorur medikamente të zemrës këtë muaj dhe kishte përdorur disa produkte të barishteve natyrale, për ta ndihmuar që të fle dhe të relaksohet. Ndërkohë, edhe sprinterja nga ST Kitts e Nevis, Tameka Williams është përcjellë për shtëpi, pasi kishte përdorur mjete të ndaluara dhe ka dalë pozitive, në testet e anti-dopingut, ka njoftuar vendi nga Karaibet.

## Humb Zvicra e shqiptarëve



Zvicra U-23 ka pësuar humbje nga Koreja e Jugut U-23, në ndeshjen e dytë të Grupit B me rezultat 2:1. Treshja shqiptare, Admir Mehmedi, Amir Abrashi e Pajtim Kasami kanë luajtur nga minuta e parë, por nuk kanë mundur ta ndihmojnë skuadrën Helvetike ta shmang humbjen. Sulmuesi i Dinamo Kievit dhe mesfushori i Grasschopersit kanë luajtur gjatë gjithë ndeshjes, kurse mesfushori i Fulhamit, i ndëshkuar me karton të verdhë që në fillim të takimit, është

zëvendësuar në minutën e 85-të nga Wiss. Golat për ekipin aziatik i realizuan Park (57') e Kim (64'), kurse për ekipin e Pierluigi Tamit shënoi Emeghara në minutën e 60-të. Pas dy ndeshjesh të zhvilluara, Zvicra ka grumbulluar vetëm një pikë. Sidoqoftë, ky ekip ka ende shpresa për kualifikim në fazën tjetër, por ka punë shumë të vështirë, pasi që duhet ta mposht favoritin e grupit, Meksika. Kjo ndeshje do të zhvillohet më 1 gusht, nga ora 18:00.

## Asllani në formë



Kosovare Asllani shfaq lojë të mirë, atëherë kur i dha rasti në Olimpiadën e Londrës. Futbollistja kosovare, e cila po e përfaqëson Suedinë në Londra 2012; luajti rreth 30 minuta ndaj Japonisë, në barazimin pa gola, ndërsa mediat suedeze paraqitjen e saj e vlerësuan si brilante. Madje, uebfaqja suedeze expressen.se ka shkruar se 23-vjeçarja e meriton të luajë në formacionin bazë të suedezeve, që nga ndeshja e radhës. "Jam në formë të mirë, pasi jam përgatitur për një kohë të gjatë dhe luajta

më shumë. Po përpiqem ta bëj hapin e radhës dhe ta ndihmoj ekipin", thotë Asllani, e cila vitin e kaluar ishte lënë jashtë skuadrës kombëtare, në Botërorin e mbajtur në Gjermani. Gjithnjë sipas expressen.se, Suedia nuk mund ta lërë në bankinë një lojtare si Asllani, nëse dëshiron të shkojë larg në këtë turne. "Kosovare Asllani është në formë aq të mirë, sa që në realitet mund të jetë diferenca nëse Suedia do të marrë apo jo medalje në Olimpiadë. Mendoni mirë për Asllanin", shkruan kjo uebfaqe.

# SHKEPUTEN KINEZET



Kinezët dhe amerikanët janë shkëputur ndaj skuadrave tjera në Olimpiadën e Londrës. Këto dy vende po e thonë fjalën kryesore në ditët e para, duke grumbulluar nga 12, respektivisht 11 medalje në total, për t'i lënë prapa italianët, koreanët dhe ekipet tjera.

Të dielën janë zhvilluar aktivitetet sportive të ditës së dytë në Olimpiadën e Londrës, ku u fituan të tjera medalje dhe u regjistruan rekorde të reja botërore dhe olimpikë. Kinezët dhe amerikanët e vazhduan shkëputjen ndaj skuadrave tjera, ndërsa ditë të mirë patën edhe italianët e koreanët. Kina ka grumbulluar 2 medalje, prej tyre 6 të arta, 4 të argjendta e 2 të bronzta, kurse SH A-të kanë medalje (3:5:3).

### Not

Përfaqësuesja e Francës e ka fituar medaljen e artë në garën 400 metra me stafetë, stil i lirë. Katërshja franceze është treguar e shpejtë se ajo amerikane, e cila u desh të kënaqej me pozitën e dytë dhe medaljen e argjendit. Ndërkaq, rusët e fituan të bronztën.

Kurse, Cameron van der urgh e ka fituar medaljen e artë dhe ka thyer rekord botëror në garën 100 metra, stili bretkosë. Notari jug-afrikan e përfundoi garën për kohën 59.97, duke i lënë prapa australianin e argjendit Christian Sprenger dhe amerikanin e bronzit rendan Hansen. Në garën 400 metra stil i lirë tek femrat, francezja Camille Muffat e ka fituar medaljen e artë, pasi e mbylli garën për kohën 4:01.45. E argjenditë ishte amerikania Allison Schmitt, ndërsa medalja e bronzit i takoi britanikes Rebecca Adlington. Ndërkohë, Dana Volmer e ka fituar medaljet të artë dhe ka arritur rekord botëror në 100 metra, në stilin flutur. Amerikania e mbylli garën për kohën 55.98 sekonda, duke e lënë prapa kinezin e argjendit Lu ing (56.87) dhe australianen Alicia Coutts (56.94), e bronzitë.

### Çiklizëm

Holandezja Marianne Vos e ka fituar medaljen e artë në çiklizëm, pas garës që zgjati afro 6 orë. Ajo e ka lënë prapa britaniken Lizzie Armitstead, e cila e fitoi medaljen e argjendit. Kurse, e treta përfundoi rusja Olga Zabelinskaya, që e fitoi të bronztën.

### Xhudo

Lasha Shavdatuashvili e ka fituar medaljen e artë në kategorinë deri 66 kilogramë. Xhudisti gjorgjian ishte më i mirë se hungarezi Niklos Ungyari, të cilin e mposhti në finale. Kurse, medalja e bronzit i takoi japonezët Masashi Ebinuma, i cili në luftën për pozitën e tretë e mundi jug-koreanin Cho Jun-Ho. Ndërkohë, Kum Ae An e ka fituar medaljen e artë në konkurrencën e femrave, deri 52

## Di Matteo lavdëron Hazardin


Menaxheri i Chelsea, Roberto Di Matteo e ka lavdëruar përfërkimin e ri, Eden Hazard, për paraqitjen që e bëri në humbjen 1:0 nga Milani, në ndeshjen që u zhvillua të dielën në Miami të SHBA-së. Urby Emanuelson e realizoi të vetmin gol të ndeshjes, për t'ia siguruar fitoren ekipit italian. "Mendoja

se Hazard ishte i interesuar më shumë të luante në të majtë dhe bëri paraqitje impresionuese. Gjithmonë është më mirë të fitosh, të jep ndjenjë të mirë, kështu që jemi të zhgënjyer me rezultatin, por organizimi i lojës ishte mjaft i mirë. Kemi përmirësime nga ndeshja e kaluar", deklaroi trajneri italian.

## PSG, më i mirë se Milani

E ka vazhduar aty ku e kishte nisur, i njëjti kapacitet për të shënuar gol. Ky është Zlatan Ibrahimovic. Ai lojtari që ëndërronte që kur ishte fëmijë të luajë në Juventus, Inter, Milan, Barcelonë dhe Paris Saint-Germain. Deklaratat e tij kontroverze kanë vazhduar edhe të shtunën, kur debutoi me gol në fanellën e PSG-së. "Jam i lumtur,

kam hyrë në një grup të ri futbolli-stësh, me një projekt ambicioz. Po punoj shumë për t'i gjetur mekanizmat e duhur. Në Milan kam kaluar mirë, kam pasur momente të mira, por tash jam i koncentruar në aventurën time të re. PSG është më i mirë se Rossonerët, të cilët më kanë humbur mua dhe Thiago Silvan", tha sulmuesi suedez.



# E AMERIKANET



Jungbiao (289kg), kurse i treti, i bronzitë ishte sportisti nga Azerbajxhani, Valentin Hristov (286).

### Qitje me pushkë

Qitësja Kim Rhode e ka huqur vetëm një nga 100 gjuajtje, një rekord botëror, duke u bërë amerikania e parë që fiton medalje të artë individuale për të pestën herë radhazi në Olimpiadë. Rhode, e artë edhe në Olimpiadën e Atlantas, Sydneyt, Athinës e Pekinit, dominoi në London's Royal Artillery 'arracks'. Kinezja ei Ning e fitoi medaljen e argjendtë, kurse sllovakia Danka artekova u desh të kënaqej me të bronzitën. Ndërkohë, kinezja Guo enjun e ka fituar medaljen e artë në qitjen me pushkë nga 10 metra, duke arritur 488 pikë. E dyta, e argjendtë ishte francezja Celine Goberville (486.6), kurse medalja e bronzitë i takoi ukrainases Olena Kostevych (486.6).

### Shigjetari

Korea e Jugut e ka fituar medaljen e artë në konkurrencën e femrave në shigjetari për të shtatën herë radhazi, në finalen e mbajtur në Lord's cricket ground. Treshja Ki o-bae, Lee Sung-jin and Choi Hyeon-ju regjistruan 2 0 pikë nga 24 tentimet e tyre, duke e mposhtur treshen kineze (të argjendta) dhe treshen japoneze (të bronzta).

### Zhytje në ujë

Dyshja kineze u Minxia e He Zi e kanë fituar medaljen e artë në zhytje në ujë nga 3 metra lartësi, në sinkronizim. Kjo ishte hera e tretë rresht që 26 vjeçarja u e fiton të artën në Olimpiadë. Ato realizuan 346.20 pikë, duke i lënë prapa amerikanet e argjendta Kelci ryant e Abigail Johnston (32 .90) dhe kanadezet e bronzta Jennifer Abele e Emilie Heymans (3 6.80).

### Luftë me shpata

Aron Szilagyi nga Hungaria e ka fituar medaljen e artë në luftën individuale me shpata, pasi e mposhti në finale italianin Diego Occhiuzzi (i argjendte) me rezultat 5-8. Ndërkaq, rusi Nikolay Kovalev e mundi rumunin Rares Dumitrescu (5-0), për ta fituar medaljen e bronzitë.

kilogramë, ku mori pjesë edhe Majlinda Kelmendi. Në meçin vendimtar, veri-koreania ishte më e mirë se kubania anet ermom e cila e fitoi medaljen e bronzitë. Ndërkaq, pozita e tretë dhe medalja e bronzitë i ka takuar italianes Rosalba Forciniti, e cila e mposhti luksemburgasen Marie Muller.

### Peshëngritje

Zulfiya Chinschanlo e ka thyer rekordin e saj botëror, duke e fituar njëkohësisht medaljen e artë në peshëngritje, kategoria deri në 53 kilogramë, konkurrenca e femrave. Sportistja nga Kazakistani, me një total prej 226 kilogramësh, e ka lënë prapa garuesen nga Tajvani, Hsu Shu-Ching (2 9kg), që e fitoi të argjendtën dhe Cristina Iovu nga Moldavia, që ishte e bronzitë (2 9kg).

Ndërkohë, veri-koreani un Chol Om arriti 293 kilogramë, duke e fituar medaljen e artë në kategorinë deri në 56 kilogramë, në peshëngritje. Medalja e argjendte i takoi kinezit u



# Eliminim i hershëm

Aventura e Majlinda Kelmendit në Olimpiadë ishte më e shkurtër sesa që është pritur. Një pakujdesi e vogël i ka kushtuar xhudistes kosovare me eliminim nga 'Londra 2012'. Repreruesja shqiptare është mposhtur papritur në rrethin e dytë të garave nga Christianne Legentil, duke i zhgënjyer kështu gjithë shqiptarët, të cilët shpresat më të mëdha i kishin te Majlinda, për t'u sjellë medalje.

### Valon Konushevci

valon.konushevci@gazetaexpress.com

Aventura e Majlinda Kelmendit në Lojërat Olimpike Londra 2012 ka marrë fund më herët se që është pritur. Një pakujdesi e vogël të dielën i ka kushtuar xhudistes kosovare me eliminim nga Olimpiada, qysh në rrethin e dytë të garave të xhudës, në kategorinë deri në 52 kg, të konkurrencës së femrave. Xhudistja Christianne Legentil nga Mauritania ishte pengesa e pakaluar e Majlinda Kelmendit. Në fakt, repreruesja e Shqipërisë e nisi mirë aventurën e saj në Londra 2012. Në Olimpiadë ajo debutoi me fitore, pasi në rrethin e parë e mposhti Jaana Sundberg. 2 vjeçarja nga Peja ishte bindshëm më e mirë sesa 29-vjeçarja nga Finlanda, të cilën e eliminoi nga Londra 2012 pas dy hedhjeve azari. Majlinda Kelmendi e nisi mirë edhe betejën e dytë përballë xhudistes nga Mauritania, Christianne Legentil, por që humbi krejtësisht papritur. Kelmendi avancoi e para përballë Legentil me një hedhje vazari. Kur dukej se Majlinda po ecte më sigurt drejt fitores së radhës, ndodhi e kundërta. Kosovaren e befasoi Legentil, e cila e fitoi duelin me Ippon.

Me këtë rast, Majlinda Kel-

mendi u zhgënjye jashtëzakonisht shumë, sikurse trajneri i saj Driton Kuka. "Ka qenë dita më dëshpëruese e jetës sime. Po ashtu, edhe Majlinda është shumë e zhgënjyer pas disfatës. Pas një fillimi të mirë, nuk e kemi pritur të përfundojmë në këtë mënyrë. Mirëpo, ajo e ka përpara vetes një karrierë të gjatë", ka thënë pas meçit i dëshpëruar trajneri Kuka. Eliminimi i Majlindës i ka prekur gjithë shqiptarët, ngase ajo konsiderohej si shpresa më e madhe e Shqipërisë për të fituar medalje në këtë Olimpiadë. Sidoqoftë, Majlinda Kelmendi mbetet krenari e sportit të Kosovës. Moshë e saj ende e re mund t'i mbajë gjallë shpresat e saj që në Olimpiadën e ardhshme të mund të fitojë medalje, mbase atëherë si repreruese e Kosovës.

### Krasniqi: Majlinda do t'i prijë ekipit olimpike të Kosovës në 'Rio2016'

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Memli Krasniqi, beson se xhudistja kosovare Majlinda Kelmendi, do t'i prijë ekipit olimpike të Kosovës në Olimpiadën e ralizit, në vitin 2016. Këtë bindje ministri Krasniqi e ka shprehur në rrjetin social Twitter, kur Majlinda Kelmendi është eliminuar në të tetën e finales pasi që në luftën e dytë



### e iat an e: aj in a et të tojë ër njo je

Derisa Majlinda Kelmendi u eliminua herët nga Olimpiada, mediat britanike kanë filluar të shkruajnë për të ardhmen e xhudistes kosovare. Tabloidi The Guardian ka shkruar se lufta e 2 vje ares nuk mbaron këtu, pasi që ajo tash e tutje duhet të luftojë, por kësaj radhe për njohje dhe praninë të vendit të saj. Pejanës iu mohua pjesëmarrja me flamurin e Kosovës, por edhe si sportiste e pavarur, ndërsa asaj iu desh ta përfaqësojë Shqipërinë në Londra 2012. Prandaj, ky tabloid shpreson që Italia i lejoi Majlindës dhe sportistëve tjerë kosovare që në Olimpiadën e ardhshme të marrin pjesë duke e përfaqësuar vendin e tyre Kosovën.

në kategorinë deri në 52 kilogramë është mposhtur nga Christianne Legentil nga Mauritania. "Majlinda do të ngritet edhe më e fortë pas kësaj përvojë olimpike. Jam i bindur që ajo do t'i prijë ekipit olimpike të Kosovës në Rio2016", është shprehur Krasniqi.



## Mourinho e lë jashtë Carvalhon

Ditët e Ricardo Carvalhos në Real Madrid duket të jenë të numëruara, pasi që mbrojtësi portugez nuk ka udhëtuar fare me pjesën tjetër të ekipit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. 34-vjeçari ka zhvilluar vetëm 10 ndeshje nga fillimi në ekipin e Jose Mourinhos, sezonin që shkoi, prandaj largimi i tij në

Santiago Bernabeu duket të jetë i pashmangshëm. Për ish-futbollistin e Chelsea, interesim ka shfaqur Milani, i cili e do atë përkrah Leite Kakas dhe Lassana Diarres. Reali do ta nisë aventurën amerikane me një ndeshje ndaj Los Angeles Galaxy në stadiumin 'The Home Depot Center' në Kaliforni, më 3 gusht.

## Messi e bën diferencën

Trajneri i Barcelonës, Tito Vilanova ka mbetur i impresionuar me paraqitjen e Lionel Messit ndaj ekipit Raja Casablanca, i cili shënoi tre gola, në fitoren bindëse 8:0. "Kur ta kesh në ekip lojtarin më të mirë në botë, me këtë kapacitet golash, ai zakonisht e bën diferencën dhe edhe një herë e bëri atë", theksoi trajneri spanjoll në

konferencë për shtyp. - "Kjo ndeshje ishte e mirë për ne, sepse luajtëm me një ekip që na bëri të vrapojmë me shumë. Edhe lojtarët e rinj luajtën mirë, të gjithë luajtën në nivele të larta sonte", shtoi ai. Vilanova megjithatë nuk e di ende se kur do të rikthehet në fushën e blertë sulmuesi David Villa.

## Mysafirja e paftuar



India ka kërkuar hetim nga sigurimi i Olimpiadës së Londrës, pasi një mashtruese ishte futur në kontingjentin e ekipit, në paradën e ceremonisë hapëse. Gruaja e paidentifikuar i ishte bashkuar ekipit në stadiumin olimpiq të Londrës, e veshur me të kuqe lart dhe të kaltër poshtë, derisa sportistët kishin kryesisht veshje të verdha.

Indianët çuditën se si ka mundur të ndodhë kjo, në njërin prej evenimeve më të sigurta sportive të mbajtura ndonjëherë. Zyrtarët indianë kanë kërkuar shpjegim nga organizatorët e Olimpiadës për incidentin, në të cilin gruaja e panjohur po ecte në të djathtë të mbajtësit të flamurit, Sushil Kumar. Gruaja nuk e kishte me vete as kartën e identifikimit dhe ekipi kërkon mbrojtje.

"Ajo nuk kishte arsye të ishte atje. Ishte e qartë se ishte futur vetë. Ne do të flasin për këtë rast me organizatorët. Nuk e dimë se kush ishte ajo dhe përse eci me sportistët tanë. Është turp që ndodh kjo", ka thënë zyrtari i kontingjentit olimpiq indian, Muralidharan Raja. - "Nuk mund të them nëse ishte në zonën normale, por kjo ishte e çuditshme. Ne do të kërkojmë sqarime", vazhdoi ai.

I pyetur nëse gruaja ishte indiane, Raja thotë se ajo mund të ketë qenë aziatike, amerikanolatinë, apo diçka tjetër. India e pati kontingjentin olimpiq prej 81 sportistësh dhe shpreson ta fitojë ndonjë medalje të artë, të argjendtë apo të bronzit në Olimpiadë.

## Hamilton, i paarritshëm në Hungari



Lewis Hamilton ka qenë i paarritshëm në garën për Shpërblimin e Madh të Hungarisë. Ngasësi britanik e ka mbyllur garën i pari, për kohën 1:41:05.503, përpara pilotit të Lotusit, Kimi Raikkonen. Ish-kampioni i botës udhëhoqi që nga 'pole-position' dhe ishte i aftë ta menaxhonte diferencën ndaj kundërshtarëve, në garën prej 69 xhirosh. Kjo ishte fitorja e 19-të e ngasësit të McLarenit, e treta në Hungari, derisa pozita e tretë i takoi ngasësit tjetër të Lotusit, Romain Grosjean.

### Gara e Hungarisë

1. Hamilton (McLaren)	1:41:05.503
2. Raikkonen (Lotus)	+1.032
3. Grosjean (Lotus)	+10.518
4. Vettel (Red Bull)	+11.614
5. Alonso (Ferrari)	+26.653

### Renditja e pilotëve

1. Fernando Alonso	164 pikë
2. Mark Webber	124
3. Sebastian Vettel	122
4. Lewis Hamilton	117
5. Kimi Raikkonen	116

## Top University Education for Top Students



10 vite Lider i Arsimit të Lartë  
I certifikuar sipas Standardit ISO 9001 për cilësi  
Përfitues nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS  
Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore  
Kampion Evropian në Robotikë 2011

Zgjedh më të mirin ...  
... që të bëhesh më i miri!

Në bazë të Statutit dhe Vendimit të Këshillit Drejtues nr.835/45-12 të datës 12/06/2012 UBT shpall:

### KONKURS

Për vitin akademik 2012/ 2013 në këto programe studimi:

#### - MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (BA, MA)

- Me mundësi specializimi:
- Financa, Banka dhe Kontabiliteti,
  - Marketing dhe Shitje,
  - Manaxhment dhe Ndërmarrësi (MA)

#### - SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHIERI (BSc, MSc)

- Me mundësi specializimi:
- Rrjeta dhe Telekomunikacion
  - Softuer dhe Sisteme Inxhinierie,
  - Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
  - Dizajn dhe Multimedia
  - Mekatronikë dhe Robotikë

#### - MENAXHMENT I MEKATRONIKËS (BSc, MSc) (Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit, Prodhimtaria Industriale, Dizajni Industrial, Ndërmarrësi dhe Menaxhment)

#### - ARKITEKTURË (BSc)

#### - JURIDIK (LLB)

#### - SISTEMET INFORMATIVE (BSc)

Përmes UBT-së ju mund të studioni dhe të përfitonit bursa studimi në Universitet partnerë si:



City University London, Angli



Danube University Krems, Austri  
Master in Business Administration (MBA)



CIFE (Centre International de Formation Europ.), Francë  
Master in European Integration and Law (MA)



WIT (Waterford Institute of Technology), Irlandë  
Master in Information Systems (MSc.)

#### Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi 4X6

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze

#### Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta gjatë ditës. Për të punësuarit ofrohen ligjërata pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

**Që suksesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:**

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe certifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë
- Trajneri: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Project, etc.

#### Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik është **1200 €**, me mundësi pagese deri në **12 këste**.

Për të gjithë nxënësit e dalluar UBT ofron zbritje 20-50%

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguanë në fillim të vitit akademik



## Reali, marrëveshje për Modricin

Duket se telenovela Luka Modric është duke kaluar episodet e fundit. E përditshmja spanjolle AS shkruan se Real Madridi dhe Tottenhami kanë arritur marrëveshje për transferimin e mesfushorit ofanziv, Modric. Gjithnjë sipas kësaj të përditshmeje, madrilënët do të paguajnë 45 milionë euro për ta bindur klubin anglez

që ta lëshojë yllin e kësaj skuadere. Ndërkohë, përfaqësuesi kroat pritet të nënshkruajë kontratë afatgjatë me ekipin e Jose Mourinhos, ndërsa pritet të paguhet pothuajse dyfish, në krahasim sa merrte në ekipin londinez. Madrilënët e kanë përshkruar kroatin si lojtarin ideal për të luajtur në Santiago Bernabeu.

## Ranocchia beson në Interin e ri

Andrea Ranocchia shpreson të jetë i aftë ta japë kontributin e tij në formacionin bazë, sezonin e ardhshëm për Interin. Qendërmbrojtësi iu bashkua ekipit Nerazzurri nga Genoa, duke u konsideruar si perspektivë për ekipin italian. Sidoqoftë, një seri gabimesh dhe përvoja e veteranëve Lucio e Walter Samuel, bëri që 24-vjeçari të

mbetej në bankinë. Sidoqoftë, ai beson në aftësitë e tij dhe në Interin e ri. "Ndihem mirë, kam punuar shumë këtë verë që të rikthehem në formën më të mirë dhe sigurisht të luaj më shumë. Duhet të përgatitemi sa më mirë në aspektin fizik dhe mental, për sezonin e ri, duke filluar nga ndeshja në Split", theksoi Ranocchia.



# XHAKA IA THOTE SHQIPES

Me shkuarjen e Granit Xhakës në Borussia Monchengladbach, aty është dëgjuar edhe himni kombëtar shqiptar, të cilin e ka kënduar vetë mesfushori kosovar. Kjo ka bërë që zvicëranëve t'u mbetet hatri në 19-vjeçarin që e ka zgjedhur himnin e Shqipërisë para atij të Zvicrës. Por, Xhaka thotë se helvetikët nuk kanë arsye që t'ia zënë për të madhe, ngase tekstin e himnit zvicëran nuk e di, e në fund të fundit rrënjët i ka nga Kosova, dhe për këtë ndihet krenar.

Në skuadrën e undesligës gjermane, orussia Monchengladbach – në të cilën gjatë kësaj vere kaloi edhe Granit Xhaka nga aseli – praktikohet një ritual i zakonshëm, sipas të cilit çdo futbollist i ri që i bashkohet skuadrës, duhet ta këndojë para shokëve të rinj një këngë, ç'fare të dojë vet. Ndërsa, mesfushori kosovar, i cili luan për Përfaqësuesen e Zvicrës, ishte përcaktuar që ta këndojë himnin kombëtar shqiptar. E ky veprim i Xhakës i ka habitur zvicëranët, të cilëve u ka mbetur hatri në 9-vjeçarin që e ka zgjedhur himnin shqiptar para atij zvicëran.

E për këtë, Xhaka është marrë në pyetje nga tabloidit i njohur zvicëran, lick. "Si fëmijë i mësojmë disa këngë të caktuara. Dhe, sinçerisht, është kënga e vetme që mundem ta këndoja edhe pse, vetëm strofat e para. Shokët e ekipit u befasuan, sepse ata nuk e dinin se prindërit e mi janë nga Kosova", ka deklaruar Xhaka për lick.

Kur është pyetur pse ka vendosur

sur ta zgjedhë himnin shqiptar para atij zvicëran, Xhaka është përgjigjur se nuk e dinte tekstin. "Si fëmijë nuk e kam mësuar tekstin, pasi që prindërit e mi nuk janë rritur në Zvicër, por në Kosovë", ka thënë prishinasi. Madje, Xhaka është nervozuar me faktin kur ka kuptuar se zvicëranëve u ka mbetur hatri që ai ka zgjedh për ta kënduar himnin shqiptar, para atij zvicëran. "Unë them gjithmonë: Ndjehem 80 për qind zvicëran dhe 20 për qind kosovar. Unë jam zvicëran, por rrënjët e mia janë pjesë të mia dhe ashtu do të mbesin përgjithmonë", ka thënë ai. "Mua më duhet të jetoj me këtë. Unë e kam prejardhjen që e kam dhe i qëndroj asaj. I dua të dy vendet me gjithë zemër. Nëse dikush mendon me një shpirtngushtësi të tillë, unë nuk kam çfarë të bëj. Dhe, ka edhe zvicëranë të qindpërqindtë që nuk dinë ta këndojnë himnin zvicëran. Mua, thjesht, më duket e vështirë për ta mësuar. Por, të jem i qartë: unë dua dhe do ta mësoj atë", ka shtuar Xhaka.

### Xhaka: S'do ta këndoj asnjërin himn në ndeshjen Zvicër-Shqipëri

Në shtator, Zvicra e Granit Xhakës, Xherdan Shaqirit, Valon Behramit, Ilerim Xhemajlit e Admir Mehemedit, do ta presë Kombëtaren e Shqipërisë – në kuadër të kualifikimeve për otëtorin razili 20 4. Para ndeshjes do të interpretohen himnet e të dyja vendeve, por Xhaka ka paralajmëruar se do të hesht, dhe aty nuk do ta këndojë asnjërin himn.

I pyetur se a do të luajë në atë takim, Xhaka ka thënë: "Qind për qind po. Përgjegjësit e Federatës Shqiptare e dinë përse unë jam përcaktuar për Zvicrën dhe jo për Shqipërinë", ka pohuar ai. Por, lick menjëherë ka reaguar duke e pyetur se a mund ta lë në të ardhmen Zvicrën për Përfaqësuesen e Kosovës.

"Ndërkombëtarizimi i përfaqësueses së Kosovës është shumë larg dhe unë nuk merrem fare me këtë gjë", ka përfunduar Xhaka.

## Ta i ia mësyn Malagës



Biznesmeni shqiptar, Rezart Taçi është shumë i lidhur shpirtërisht me futbollin. Këtë e konfirmon fakti se pas Italisë, presidenti i kompanisë së naftës "Taçi Oil" ka filluar t'i futë hundët edhe në futbollin spanjoll. Mediat e njohura spanjolle kanë raportuar se biznesmeni i njohur shqiptar ia ka mësyre shumë seriozisht Malagës. Madje, jo vetëm për ta sponsoruar klubin e njohur spanjoll, por për ta blerë tërësisht atë. "Pronarët e Malagës janë duke negociuar shitjen e skuadrës biznesmenit shqiptar, Rezart Taçi, pronarit të kompanisë së naftës "Taçi Oil" dhe aksionar në kompaninë shqiptare të naftës, Armo", ka raportuar e

përditshmja e njohur spanjolle, Marca. Sipas këtij mediumi, negociatat është duke i ndërmjetësuar dhe duke i avancuar avokatit nga Spanja, Roberto Rodriguez Casas. Sipas kësaj gazete, ende askush nga zyrtarët e Malagës nuk janë deklaruar rreth kësaj çështjeje, derisa Marca, duke u bazuar në burimet e saj, thekson se tashmë kanë filluar kontaktet me pronarin aktual të Malagës, sheikun nga Katar, Abdullah Al-Thani. Në fund, Marca kujton se "Taçi Oil" i Rezart Taçit është njëri prej sponsorëve shqiptar, Rezart Taçi, pronarit të kompanisë së naftës "Taçi Oil" dhe aksionar në kompaninë shqiptare të naftës, Armo", ka raportuar e


## Vëllaznimi rikthen Shengylin



Vëllaznimi gradualisht po këndellet për edicionin e ri, i cili do të fillojë më 18 gusht. Gjakovarët po i "blindojnë" disa futbollistë të rëndësishëm, të cilët ende nuk u kanë ikur, derisa të dielën, më në fund, e kanë zgjedhur edhe trajnerin e ri.

Në fakt, kuqezinjët ia kanë dalë ta bindin Skënder Shengylin që ta pranojë ofertën e tyre për ta udhëhequr skuadrën gjakovare, të cilën trajneri prizenas me sukses

e pati drejtuar gati gjatë gjithë pjesës së parë të kampionatit të kaluar, por që më pas që ndarë me gjakovarët, edhe atë jo fort mirë. "Bordi i klubit, i mbështetur nga kryetari i Komunes së Gjakovës, shef të shtabit teknik e ka emëruar Skënder Shengylin. Trajneri prizenas të hënën do ta nisë punën në Gjakovë", ka deklaruar për Express zyrtari i lartë i Vëllaznimit, Ahmet Morina. Ai paralajmëroi edhe përformime të reja në Gjakovë.



errni pakon më të shpejtë  
të internetit në **oso** ë

ër shpejtësi marramendëse prej 80 Mbps dhe  
o erta të tjera të internetit **oso** ë u përshtaten  
ne oja e tuaja të komunikimit, gjedh **oso** !



**NË SHTËPI**